



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

PAVARËSIA, EFIKASITETI, LLOGARIDHËNIA DHE INTEGRITETI I SISTEMIT GJYQËSOR DHE PROKURORIAL



(RAPORT I MONITORIMIT SISTEMATIK TË KËSHILLIT GJYQËSOR DHE
KËSHILLIT PROKURORIAL NË VITIN 2018)

Prishtinë, janar 2019

Autor: Gzim Shala

Redaktuan: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Projekti “Fuqizimi i sundimit të ligjit”, përkrahet financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës së saj në Prishtinë dhe NED.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës së saj në Prishtinë dhe NED-it.

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



British Embassy
Pristina



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Janar 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	6
2.	Metodologjia	8
3.	Miratimi i legjislacionit sekondar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës	9
3.1.	Rregullorja Nr.01/2018 për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës	10
3.2.	Rregullorja për shfrytëzimin e Teknologjisë Informativë në Sistemin Gjyqësor	14
4.	Llogaridhënia në sistemin gjyqësor dhe mekanizmat e kontrollit	14
4.1.	Raporti Vjetor i Punës së KGJK-së për vitin 2017	15
4.2.	Raporti i punës së gjykatave për vitin 2017	17
4.3.	Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe masat disiplinore	18
4.4.	Raportimi i Kryetarëve të Gjykatave para Këshillit Gjyqësor të Kosovës	20
4.5.	Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor	20
4.6.	Avancimi dhe transferimi i Gjykatësve	22
4.7.	Monitorimi i takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës	24
4.8.	Diskutimet e anëtarëve të KGJK-së gjatë miratimit të politikave/publikimi i vendimeve ...	24
5.	Miratimi i legjislacionit sekondar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës	29
5.1.	Rregullore për Shfrytëzimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në KPK ..	30
6.	Llogaridhënia dhe integriteti në sistemin prokurorial dhe mekanizmat e kontrollit	31
6.1.	Raporti vjetor i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2017	32
6.2.	Raporti Vjetor i Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2017	32
6.3.	Vlerësimi i performancës së prokurorëve dhe masat disiplinore	33
6.4.	Raportimi i Kryeprokurorëve para KPK-së	35
6.5.	Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit prokurorial	36
6.6.	Avancimi dhe transferimi i Prokurorëve	37
6.7.	Monitorimi i takimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës	39
6.8.	Diskutimet e anëtarëve të KPK-së gjatë miratimit të politikave/publikimi i vendimeve	39
7.	Gjetjet e veçanta të monitorimit të IKD-së për KGJK dhe KPK	44
7.1.	Ndikimet politike në sistemin prokurorial	44
7.1.1.	Ndërhyrjet politike dhe të Kryeprokurorit në rastin e veteranëve dhe prontos	44
7.1.2.	Trajtimi i KGJK-së dhe KPK-së si “departamente” të MD-së	47
7.2.	Lufta e Këshillave për shfajësim në publik rreth dështimeve në luftimin e korrupsionit	49
7.2.1.	Konflikti KGJK-KPK lidhur me dështimet në luftimin e korrupsionit	49
7.2.2.	Tendenca e Këshillave që me rekomandime ta luftojë korrupsionin	52
7.3.	Keqadministrimi nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial	52
7.3.1.	Anëtarët e KGJK-së vendosin të kompensohen retroaktivisht	52
7.3.2.	Parregullësitë në KGJK dhe KPK të evidentuara nga Auditori i Përgjithshëm	56

7.3.3.	Greva e punëtorëve të administratës së gjykatave dhe prokurorive	60
7.3.4.	Dështimi i KPK-së për zgjedhjen e anëtarit nga shoqëria civile	61
7.3.5.	Rezistenca e Gjyqtarit Veli Kryeziu që ta zbatojë vendimin e KGJK-së	62
7.3.6.	16 muaj përpjekje për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan.....	65
7.3.7.	Tensionet në KGJK lidhur me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme	66
7.3.8.	Sfidat e KGJK-së me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë	67
7.3.9.	KGJK voton pro raportit inekzistent të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.....	69
8.	Rekomandime	70

Shkurtesat

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
BE	Bashkimi Evropian
GJTh	Gjykatë Themelore
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës
LV	Lëndët e Shënjestëruara për Liberalizim të Vizave
MD	Ministria e Drejtësisë
NjShPGj	Njësi për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore
NjShPP	Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve
OJQ	Organizata jo Qeveritare
PA	Prokuroria e Apelit
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PTh	Prokuroria Themelore
PSH	Prokurori i Shtetit
RTV 21	Radio Televizioni 21
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SKGJK	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
SKPK	Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës
SQEPK	Sistemi Qendror i Evidencës Penale
SEMV	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Veturave
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TIK/Smil	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit/Sistemi për Menaxhimin Informativ të lëndëve
U.D.	Ushtrues Detyre
UA	Udhëzime Administrative
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtarë
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor
ZKPSH	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZQEP	Zyra Qendrore për Evidencën Penale

1. Përmbledhje ekzekutive

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial edhe gjatë vitit 2018 janë përballur me mungesë efikasiteti, llogaridhënie dhe integriteti në ushtrimin e përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) si rezultat i monitorimit sistematik që u bënë dy këshillave, vlerëson se këto institucione, kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj, nuk kanë qenë në gjendje që t'i zbatojnë në praktikë.

Kushtetuta dhe ligji i aplikueshëm përcaktojnë se KGJK dhe KPK, autoritetin e tyre në raport me gjykatat dhe prokuroritë e ushtrojnë përmes mekanizmave të kontrollit siç janë vlerësimi i performancës së gjykatësve dhe prokurorëve, kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve si dhe përmes mekanizmit të disiplinimit të tyre në rastet kur ata shkelin Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale. Viti 2018, sikurse edhe vitet e mëhershme nuk ka shënuar progres në drejtim të shtimit të efikasitetit të këtyre mekanizmave të kontrollit. Në anën tjetër, gjatë vitit 2018, janë shënuar shumë raste kur gjykatës, prokuror, kryetar të gjykatave dhe kryeprokuror të caktuar kanë rënë në kundërshtim me parimet dhe Kodin e Etikës, por asnjë prej tyre nuk është shkarkuar për shkak të performancës së dobët apo për shkak të masave disiplinore. Përrjashtim bën KPK, e cila gjatë këtij viti, përmes masës disiplinore ka degraduar një prokuror nga Departamenti për Krime të Rënda në atë të Përgjithshëm.

Ligjet për KGJK dhe KPK përcaktojnë se këshillat çdo tre vite duhet të realizojnë vlerësimin e performancës së tërë gjykatësve dhe prokurorëve në sistem. Derisa KPK e ka përmbushur këtë obligim, duke përfunduar vlerësimin e performancës së 67 prokurorëve apo të 1/3 së tyre që janë në sistem, KGJK ende as në vitin 2018 nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e 1/3 të të gjithë gjykatësve aktual. KGJK gjatë këtij viti në bazë të obligimeve ligjore është dashur të bëjë vlerësimin e së paku 100 gjykatësve, ndërsa ka rritur që gjatë vitit 2018 të vlerësojë performancën e vetëm 64 gjykatësve.

Viti 2018, nuk ka shënuar efikasitet sa i përket miratimit të legjislacionit sekondar në KGJK dhe KPK. Përkundrazi, për këtë vit evidentohen vetëm dy rregullore të miratuara nga KGJK, ndërsa vetëm një rregullore e miratuar nga KPK. Të dy Këshillat, ende nuk kanë arritur as në vitin 2018, të përmbyllin miratimin e legjislacionit sekondar lidhur me zbatimin e ligjeve bazike të miratuara qysh në vitin 2011, e të cilat ligje tanimë janë shfuqizuar me miratimin e ligjeve të reja të pakos së gjyqësorit.

Kosova si rezultat i kërkesave të Bashkimit Evropian (BE) lidhur me plotësimin e kriterëve për liberalizim të vizave gjatë vitit 2015, kishte plotësuar dhe ndryshuar pakon e ligjeve të gjyqësorit. Ndër kërkesat e BE-së ishte që gjatë miratimit të këtyre ligjeve, t'i kushtohet rëndësi harmonizimit të dispozitave të ligjeve për KGJK, Gjykatat me ligjet për KPK dhe Prokurorin e Shtetit.

Derisa BE-ja kishte kërkuar harmonizim, bashkëpunim dhe koordinim në mes të Këshillave, viti 2018 ka shënuar përplasjet më të mëdha në mes tyre. Mungesa e rezultateve konkrete në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë dhe krimit të organizuar ka shërbyer si temë për të ngritur akuza të ndërsjella për ta gjetur fajtorin e dështimeve.

Në njërën anë, KPK dhe Kryeprokurori i Shtetit, të gjitha dështimet në përfaqësimin dhe mbrojtjen e aktakuzave të profilit të lartë i kanë adresuar tek gjyqësori, duke theksuar se vetëm aktakuzat e profilit të lartë për korrupsion po rrëzohen nga gjykatësit. Në anën tjetër, KGJK ka reaguar publikisht, duke akuzuar Prokurorin e Shtetit se po tenton që dështimet t'ia atribuojë gjyqësorit, tentime këto, të cilat sipas tyre ndërhyjnë në pavarësinë e punës së tyre.

Nga monitorimi sistematik, IKD ka gjetur se mungon debati mes anëtarëve të Këshillave, sidomos debati dhe kontributi përmbajtësor i tyre gjatë takimeve ku trajtohen politikat, strategjitë, dhe dokumentet relevante për miratim. Në këtë aspekt, KGJK është një hap më e avansuar. Derisa, në mbledhjet e KGJK-së vërehet një debat më i shpërndarë në mes të anëtarëve, në mbledhjet e KPK-së edhe gjatë vitit 2018, ka anëtarë që asnjëherë nuk i'u është dëgjuar zëri. Kontributi i tyre i vetëm në këto mbledhje, është ngritja e dorës për të votuar për pika të ndryshme të propozuara në Këshill. Karakteristikë e mbledhjeve në KPK, është fakti se shumica dërrmuese e vendimeve merren në mënyrë unanime. IKD vlerëson se fakti që shumë anëtarë asnjëherë nuk flasin dhe vendimet merren me vota unanime, dëshmon se anëtarët e këshillave, veçanërisht KPK-së, janë shëndruar në makina votimi.

IKD gjatë monitorimit të KGJK-së ka gjetur se nuk është përmbushur obligimi ligjor për themelimin e degëve të reja të Gjykatës Themelore të Prishtinës në Komunën e Fushë Kosovës dhe Obiliqit. Sikurse përcaktohet në ligj, themelimi i tyre do të ndikonte në shkarkimin e Gjykatës më të ngarkuar me lëndë në vend, asaj në Prishtinë si dhe do të rriste qasjen në drejtësi për qytetarët e këtyre komunave.

Transparenca me publikun dhe shoqërinë civile, mbetet ende sfidë për KGJK-në dhe KPK-në. Në mbi 50% të kërkesave për qasje në dokumentet publike, IKD nuk ka marrë përgjigje nga sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial gjatë vitit 2018. Një numër i caktuar i rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga KGJK dhe KPK ende nuk janë bërë publike në uebfaqe as gjatë këtij viti. Në këtë drejtim KPK mbi 85 % të vendimeve të miratuara nuk i ka publikuar në uebfaqe të Këshillit.

IKD ka gjetur se Këshillat vazhdojnë me qasjen e njëjtë në raport me marrjen e vendimeve si dhe miratimin e legjislacionit sekondar, duke bërë shkelje të vazhdueshme të ligjit. Këto veprime të Këshillave, cenojnë rëndë ligjshmërinë dhe legjitimitetin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Për me tepër, IKD vlerëson se legjislacioni pozitiv në Kosovë, iu ka siguruar pavarësi të plotë dy Këshillave në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të tyre. Kjo pavarësi ka filluar të keqpërdoret nga dy Këshillat, duke zbatuar ligjin sipas interesave individuale të personave të caktuar brenda sistemit, ku për shumë raste konkrete, IKD vazhdimisht ka ngritur shqetësime publikisht.

Mungesa e vullnetit dhe integritet të të dy këshillave për të përmbushur me efikasitet, integritet dhe profesionalizëm obligimet e tyre kushtetuese dhe ligjore është mesazhi më i keq që këta dy këshilla mund të përçojnë tek gjykatësit dhe prokurorët, si dhe tek publiku i gjerë. Kjo qasje e shndërron në parim të punës joefikasitetin, mungesën e llogaridhënies dhe pandëshkueshmërinë.

2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpiloj një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me zbatimin e pakos së ligjeve të gjyqësorit, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit. Në fokus të monitorimit kanë qenë takimet publike dhe aktivitetet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK). Gjithashtu, IKD ka monitorues në të gjitha Gjykatat, degët e Gjykatave dhe Prokuroritë e Republikës së Kosovës, të cilët monitorojnë me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të korrupsionit, rastet e tjera penale, rastet civile, administrative dhe ekonomike. Krahas këtij obligimi monitoruesit e IKD-së janë të fokusuar në zbatimin e obligimeve ligjore nga ana e bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale si dhe stafit mbështetës. Monitorimi fokusohet në baza ditore tek performanca e Gjykatave dhe Prokurorive në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit të cilat miratohen nga KGJK dhe KPK. Të gjitha gjetjet e monitorimit, grumbullohen në Qendrën e IKD-së në Prishtinë, në të cilën analistët juridikë të Institutit, zhvillojnë hulumtim ligjor dhe praktik me të dhënat e terrenit. Kjo metodologji e hulumtimit ofron mundësi praktike që të bëhet identifikimi i problemeve dhe të analizohen të gjitha çështjet që janë me interes në shërbim të zbatimit të ligjit.

Pas identifikimit dhe analizimit të gjetjeve dhe çështjeve problematike karshi ligjit, standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, IKD ka zhvilluar intervista të thella me të gjithë hisedarët e bërjes së politikave dhe ligjeve për institucionet e drejtësisë dhe zbatuesit e këtyre politikave dhe ligjeve. Intervistat janë zhvilluar në bazë të indikatorëve të vendosur si rezultat i monitorimit, gjetjeve dhe vlerësimeve nga ana e analistëve juridikë të IKD-së, të cilat kanë shërbyer për të nxjerrë në pah problemet reale në fushën e legjislacionit primar dhe sekondar si dhe në zbatimin e tyre në praktikë. Intervistat e zhvilluara janë kodifikuara ashtu që çështjet dhe informatat e dala nga to janë përfshirë në raport.

Poashtu, për të qenë sa më të saktë në identifikimin e problemeve si dhe propozimin e rekomandimeve për zgjidhje të problemeve në zbatimin e drejtë të ligjit dhe funksionimin e mirëfilltë nga KGJK dhe KPK, IKD ka analizuar bazën ligjore dhe dokumente relevante vendore dhe ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me pavarësinë dhe funksionimin e Këshillave Gjyqësor dhe Prokurorial.

3. Miratimi i legjislacionit sekondar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

KGJK gjatë vitit 2018, nuk ka treguar efikasitet lidhur me hartimin e legjislacionit sekondar dhe përmbushjen e obligimeve që dalin nga legjislacioni i aplikueshëm për sistemin gjyqësor në Kosovë. Gjatë vitit 2018, KGJK ka miratuar dy rregullore ndërsa nuk ka miratuar asnjë udhëzim administrativ. Prej këtyre dy rregulloreve, KGJK ka publikuar vetëm një prej tyre.¹

Ligji për KGJK dhe Ligji për Gjykata nuk janë përmbushur në tërësi. Më poshtë janë radhitur lista e 7 rregulloreve, të cilat nuk janë miratuar deri në fund të vitit 2018, në bazë të obligimeve të dy ligjeve të lartpërmendura:

1. Rregulloren për Komunikim me Publikun dhe Mediat.
2. Rregulloren për Publikimin e Aktgjykimeve.
3. Rregulloren për Gjykatën Supreme rreth menaxhimit, caktimit të gjykatësve dhe caktimit të kolegjeve dhe kryesuesve të kolegjeve.
4. Rregulloren për Gjykatën e Apelit rreth caktimit të gjykatësve në departamente për të siguruar efikasitet në trajtimin e lëndëve, caktimin e udhëheqësve të departamenteve sipas nevojës dhe që siguron se secila lëndë i caktohet kolegjeve.
5. Rregulloren për Gjykatësit Porotë.
6. Rregulloren për Bashkëpunëtorët Profesional.

Po ashtu, në bazë të rregullores nr. 03/2017 për Procedurën e Përzgjedhjes dhe emërimit të Drejtorit të SKGJK-së, KGJK obligohet edhe në nxjerrjen e rregullores për vlerësimin, disiplinimin dhe shkarkimin e drejtorit të SKGJK-së, rregullore e cila ende nuk është nxjerrë nga KGJK.

Sipas KGJK-së, ka qenë e pamundur që të miratohen rregulloret, për faktin se Pakoja e Ligjeve për Gjyqësorin deri në fund të vitit 2018 nuk ka kaluar për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.²

¹ KGJK nuk ka publikuar rregulloren për Shfrytëzimin e Teknologjisë Informative në Sistemin Gjyqësor, ndërsa ka publikuar Rregulloren (nr.01/2018) për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës (Shih linkun <http://gjyqesori-rks.org/GetDocument/9974>)

² “Siç jeni në dijeni edhe ju, gjatë vitit 2018 pakoja e ligjeve për gjyqësorin ka qenë në procedurë në Komisionin Legjislativ të Kuvendit të Kosovës dhe pas përfundimit të procedurës në fund të vitit ka kaluar për miratim në Kuvend. Kështu që KGJK e ka pasur të pamundur që t’i miratojë rregulloret pa u miratuar legjislacioni i ri. Ju informojmë se KGJK ka formuar grupet punuese për hartimin e akteve sekondare që dalin nga legjislacioni. Këto grupe tash veç kanë filluar draftimin e udhëzuesve dhe akteve të tjera”, ka thënë Servane Hoti, Zyrtare e Lartë Ligjore në KGJK në një intervistë për IKD, të zhvilluar përmes postës elektronike me znj. Servane Hoti, Zyrtare e Lartë në KGJK. 25 janar 2019.

3.1. Rregullorja Nr.01/2018 për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës

Më 15 korrik 2015, hyri në fuqi Ligji 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për KGJK. Ndryshimet në ligjin për KGJK-në kanë inkorporuar përgjegjësi të reja për Këshillin në mënyrë të veçantë sa i përket **menaxhimit të sistemit qendror të evidencës penale**, ku në lidhje me këtë, është përcaktuar edhe obligimi që KGJK të nxjerrë rregullore mbi procedurat dhe rregullat e tjera në lidhje me evidencën penale.

KGJK në takimin e 203-të të mbajtur më 2 maj 2018 ka miratuar Rregulloren nr.01/2018 për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës. Njëherësh, kjo rregullore pason Rregulloren për Mbajtjen e Evidencës për Personat e Dënuar, e cila ishte në fuqi që nga 10 prilli i vitit 2015.

IKD vlerëson se e arritura kryesore e kësaj rregulloreje është fakti se e njëjta ka fuqizuar mjaftueshëm respektimit e **prezumimit të pafajësisë**, i cili në bazë të nenit 31 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është edhe parim kushtetues.

Deri më tani, në certifikat e dosjes penale të lëshuara nga Gjykatat, kanë figuruar edhe procedurat penale që janë në zhvillim e sipër, qoftë edhe në fazë hetimore. Kjo rregullore, sa i përket dënimeve, përcakton se **“në certifikatën e gjendjes penale shënohen vetëm dënimet e formës së prerë të cilat nuk janë shlyer”**, dhe se në këtë certifikatë **“nuk duhet të shënohet asnjë informacion për asnjë lëndë apo procedurë penale që është në zhvillim e sipër pranë ndonjë gjykate në Kosovë”**.

a) Vonesa në nxjerrjen e Rregullores për Sistemin Qendror të Evidencës Penale

IKD, gjatë monitorimit sistematik të punës së KGJK-së, ka gjetur se Këshillit iu deshën më shumë se tridhjetë e tre (33) muaj për nxjerrjen e Rregullores nr. 01/2018 për Sistemin Qendror të Evidencës Penale, ndërsa sipas obligimit ligjor, ajo është dashur të miratohet brenda gjashtë (6) muajve.

Sipas Ligji nr. 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për KGJK, Këshilli ishte obliguar që në afat prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerr të gjitha Rregulloret e përcaktuara në ligj. Ky obligim rrjedh nga neni 17 i ligjit të lartpërmendur ku thuhet:

“Rregulloret e përcaktuara në këtë ligj, do të nxirren në afat prej gjashtë (6) muajsh, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Përkundër kësaj, IKD gjeti se pati vonesë në nxjerrjen e akteve nënligjore në përgjithësi, e të kësaj Rregullore në veçanti. Sipas afatit ligjor, kjo Rregullore është dashur të miratohet nga KGJK deri më **15 janar 2016**, kurse u miratua më 2 maj 2018, pra mbi tridhjetë e tre (33) muaj nga hyrja në fuqi e ligjit dhe mbi njëzetë e shtatë (27) muaj pas afatit të paraparë në nenin 17, siç u theksua më lartë.

IKD shpreh shqetësim në lidhje me vonesa të tilla nga ana e KGJK-së. Miratimi i kësaj rregullore nuk ka pasur kurrfarë pengese, qoftë procedurale apo materiale. Nuk është asses i

pranueshme që një rregullore të zgjasë mbi 34 muaj apo afër 3 vite, përderisa ishte obligim ligjor që e njëjta të miratohej brenda 6 muajve. Është e qartë që ndryshimet e reja kërkonin një angazhim shtesë të KGJK-së, për ushtrimin e këtyre përgjegjësive të reja. Prandaj, ishte e pritshme nga KGJK që të plotësonte legjislacion sekondar bazuar në afatin ligjor, të paktën pritej që mos t'i kalonte afër 3 vite për një rregullore me 24 nene.

b) Baza ligjore për nxjerrjen e rregullores dhe terminologjitë juridike të përdorura

IKD vëren se KGJK i është referuar disa dispozitave kushtetuese me rastin e miratimit të kësaj rregullore, të cilat fare nuk kanë të bëjnë me çështjen e evidencave penale. KGJK tanimë e ka ndërtuar një praktikë të tillë, ndonëse lidhur me të njëjtën çështje IKD kishte reaguar në raportin e saj të monitorimit për KGJK-në të vitit 2016.³

KGJK në këtë rregullore ka bërë një lëshim tjetër sa i përket referimit në bazë ligjore, si dhe ka shtuar terme, të cilat nuk janë të parapara në ligjin bazë, në pajtim me të cilin duhet të jetë edhe kjo rregullore.

- Rregullorja u nxjerrë në bazë të nenit 108 të Kushtetutës. IKD-ja vëren se neni 108 i Kushtetutës përcakton autoritetin e KGJK-së për menaxhimin e sistemit gjyqësor, duke bërë të qartë parimin e ndarjes së pushteteve. Sidoqoftë, ky nen nuk parasheh autoritet legjislativ për KGJK-në. E drejta e KGJK-së për të nxjerr akte nënligjore, nuk buron nga Kushtetuta, por nga ligji, saktësisht nga neni 4 i Ligjit për KGJK-në.
- Si bazë ligjore për nxjerrjen e kësaj rregulloreje është përdorur edhe neni 105 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe neni 491 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Referimi në KPPRK është në rregull pasi përcakton se mbajtjen e evidencës penale e mban organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore (KGJK). Por, fakti se neni 105 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës flet për përmbajtjen dhe zbulimin e të dhënave nga dosja penale, ajo nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për nxjerrjen e kësaj rregulloreje, por rregullorja duhet të jetë në përputhje me të.
- Neni 12.3 i kësaj rregullore përcakton se “në rastet kur një dënim është shlyer, të dhënat mbi dënimin mund t'i zbulohen vetëm gjykatës, prokurorit, policisë **apo organeve të tjera** siç përcaktohet me ligj”. Si bazë kryesore për të dhënat e evidencës penale është Kodi Penal i Republikës së Kosovës, i cili përpos gjykatës, prokurorisë dhe policisë, nuk lejon qasje nga asnjë organ tjetër në këto të dhëna. Përkatësisht, ky nen thotë se “në rastet kur është shlyer dënimi, të dhënat lidhur me atë dënim mund t'i zbulohen vetëm gjykatës, prokurorisë dhe policisë lidhur me procedurën penale, e cila zhvillohet kundër personit të cilit i është shlyer dënimi i mëparshëm”. Pra, në këtë rast termi “**organeve të tjera**” është i pavend në këtë pjesë.
- KGJK po ashtu në këtë rregullore ka përcaktuar se certifikata mbi evidencën penale lëshohet në tri (3) gjuhë, përkatësisht në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Në këtë

³ “Efikasiteti, Llogaridhënia dhe Integriteti i Sistemit Gjyqësor dhe Sistemit Prokurorial: Analizë e zbatimit të obligimeve ligjore nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial” IKD. 26 Dhjetor 2016. Faqe 11 dhe 45 (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2017/01/9.-Efikasiteti-Llogaridhenia-dhe-Integriteti-i-KGJK-dhe-KPK-26.12.2016.pdf>)

rast, na bazë të nenit pesë (5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, gjuha angleze nuk njihet si gjuhë zyrtare. Po ashtu, janë edhe 3 gjuhë të tjera, të cilat kanë statusin e gjuhëve në përdorim, ku asnjërën prej tyre nuk e ka pasur KGJK parasysh, por ka vendosur gjuhën angleze pa asnjë bazë dhe referencë ligjore.

Gjithashtu, në nenin 23.1 të kësaj rregullore përcaktohet se “tre muaj nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, Koordinatori i SQEPK-së (Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës) paraqet në KGJK për aprovim planin për implementimin e kësaj rregulloreje”.

KGJK nuk ka arritur që ta vendosë këtë çështje si pikë të rendit të ditës dhe ta aprovojë këtë plan, edhe shtatë (7) muaj pas miratimit të kësaj rregullore. Pra, i bie që vetëm deri më 31 dhjetor 2018, KGJK është vonuar katër (4) muaj në zbatimin e këtij obligimi që parasheh rregullorja e miratuar nga vetë anëtarët e KGJK-së.

c) Kufizimet e kundërligjshme rreth qasjes në statistikat e Evidencës Penale

Për qëllime të hulumtimit ose të punës statistikore, kjo rregullore përmban një nen të veçantë, sipas të cilit rregullohet qasje në këto të dhëna, procedura si dhe afati ligjor për sigurimin e tyre nga ana e institucioneve gjyqësore.

KGJK gjatë hartimit të kësaj rregullore, si duket kanë ngatërruar ligjet, respektivisht, në vend që në nenin 14 të këtij rregulloreje, ti referohen Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, i janë referuar Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 14 i kësaj rregullore përcakton:

“1. Të dhënat statistikore nga SQEPK-ja mund të ofrohen për qëllime të hulumtimit ose të punës statistikore në përputhje me kushtet e parashikuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni ofrohen në bazë të një kërkesë me shkrim, e cila duhet të përfshijë: **qëllimin e punës dhe natyrën e të dhënave që synojnë të përdoren**, të dhënat e kerkuara nga personi nga baza e të dhënave, **qëllimin dhe bazën ligjore për kërkimin e të dhënave, të dhënat personale të kërkuesit dhe nënshkrimin e kërkuesit.**

3. Të dhënat e kerkuara ofrohen nga koordinatori i ZQPE-së, **brenda një afati kohor të arsyeshëm**, siç parashihet me **Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**”.

Përrjashtimisht kushtit që në kërkesë duhet të ceken “të dhënat e kerkuara nga personi nga baza e të dhënave”, të gjitha kushtet dhe përcaktimet e tjera janë të kundërligjshme.

E drejta e qasjës në dokumente publike është e drejtë Kushtetuese. Neni 41 i Kushtetutës, përcakton së secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.

Po ashtu, në bazë të nenit 6 të Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike, kërkuesi i të dhënave mund ta bëjë kërkesën në çfarëdo mënyre e cila i'a mundëson institucionit publik ta identifikojë dokumentin, dhe se kërkuesi nuk obligohet që të japë arsye për të pasur qasje në dokumente. “Kërkuesi i ndonjë dokumenti ka të drejtë për të mbetur anonim ndaj palëve të treta”, ndërsa “formalitetet për kërkesa nuk tejkalojnë atë që është kyçe për të përpunuar kërkesën”, thuhet në paragrafin 4 dhe 6 të nenit 6 të Ligjit për Qasjen në Dokumentet Publike, i cili nuk përcakton kesi lloj kriteresh, të cilat kjo rregullore i arsyeton pikërisht nëpërmjet këtij ligji. Ky ligj, në nenin 9 përcakton se të dhënat personale të mbledhura mund të përdoren si të anonimizuara edhe për qëllime historike, statistikore dhe shkencore.

Po ashtu, IKD vlerëson se terminologjia “**brenda një afati të arsyeshëm kohor siç parashihet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**” nuk do të duhej të kishte vend këtu për dy arsye. Arsyeja e parë është se Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk përcakton fare ndonjë afat kohor lidhur me sigurimin e të dhënave zyrtare të kërkuara.

Arsyeja e dytë është se ky ligj ka specifikuar afatin kohor dhe nuk ka lënë mundësi për arbitraritet, ku ka përcaktuar se afati i institucionit për përgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike është 7 ditë, me mundësi zgjatje në kushte të veçanta edhe 15 të tjera.

IKD e vlerëson si shumë shqetësuese faktin se KGJK me anë të një akti nënligjor ka cenuar dispozitat e një ligji me rëndësi siç është Ligji për Qasjen në Dokumentet Publike. Po ashtu, ky cenim është arsyetuar me dispozita inekzistente në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Qëllimi i këtij ligji ka qenë vendosja e standardit lidhur me të drejtën për qasje në dokumente publike, që në rastin konkret, të dhënat statistikore dhe anonime nga SQEPRK-u janë plotësisht dokumente publike, në kuptim të nenit 1.2 dhe 1.3 të Ligjit për Qasjen në Dokumentet Publike. Vendosja e rregullave të tilla me akte nën ligjore pa konsultuar limitet ligjore, përpos që prish parimin e hierarkisë juridike, e njëjta krijon edhe praktikë të mbrapshtë si dhe pasiguri të madhe tek hulumtuesit, të cilëve u hynë në punë këto të dhëna.

3.2. Rregullorja për shfrytëzimin e Teknologjisë Informative në Sistemin Gjyqësor

KGJK takimin e 208-të të mbajtur me 30 nëntor 2018 ka miratuar Rregulloren për Shfrytëzimin e Teknologjisë Informative në Sistemin Gjyqësor, të cilën ende nuk e ka publikuar në uebfaqe, siç e obligon legjislacioni pozitiv.⁴

Në këtë takim të Këshillit, Fatmir Rexhepi nga SKGJK, ka thënë se kjo rregullore është bazë që rregullon përdorimin e teknologjisë informative, të drejtat e të punësuarve, nivelin e qasjes, ndryshimet në qasje si dhe të gjitha çështjet e tjera deri në momentin kur përfundon marrëdhënia e punës. Rexhepi ka thënë se kjo rregullore obligon KGJK-në të ndërmarrë masa për sigurimin e sigurisë si dhe të organizojë trajnime për të punësuarit.

IKD vlerëson se praktika e mospublikimit të dokumenteve të miratuara nga KGJK, e aq më tepër legjislacionit sekondar, është një praktikë e keqe e këtij institucioni, i cili vazhdimisht ka proklamuar se parim bazë në punën e vet e ka transparencën para publikut.

4. Llogaridhënia në sistemin gjyqësor dhe mekanizmat e kontrollit

IKD gjatë procesit të monitorimit të punës së KGJK-së, ka gjetur se Këshilli ka miratuar Raportin Vjetor të Gjykatave, ka miratuar Raportin Vjetor të KGJK-së, ka bërë vlerësimin e performancës së Gjyqtarëve si dhe ka kryer procesin e rekrutimit të Gjyqtarëve të rinj.

Obligimet ligjore të sistemit gjyqësor	Përbushur	Pa përbushur
Raporti vjetor i Punës së Gjykatave	X	
Raporti vjetor i Punës së KGJK-së	X	
Vlerësimi i Performancës së Gjykatësve	X	
Raportimi i Kryetarëve të Gjykatave para KGJK		X
Rekrutimi i Gjykatësve të rinj	X	
Transparenca		X
Themelimi i degëve të Gjykatës në Fushë Kosovë për Komunën e Fushë Kosovës dhe Komunën e Obiliqit; dega në Junik për Komunën e Junikut; dhe dega në Shtime për Komunën e Shtimes		X

Sidoqoftë, KGJK ende nuk ka përbushur obligimin e saj ligjor që Kryetarët e Gjykatave të raportojnë çdo tre muaj para anëtarëve të Këshillit lidhur me menaxhimin dhe administrimin e tyre në praktikë. Mungesa e kontrollit dhe mbikëqyrjes në praktikë, po ndikon që edhe në

⁴ Rregullorja mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e KGJK-së në nenin 31 paragrafi 2 përcakton se “Rregulloret dhe ndryshimet e aprovuara nga Këshilli do të publikohen në ueb faqen e Këshillit”.

sistemin gjyqësor të mungoi llogaridhënia, efikasiteti dhe përgjegjshmëria, të cilat janë duke ndikuar në instalimin e pandëshkueshmërisë në praktikë.

Për më tepër edhe përkundër faktit se me ligj, KGJK ka qenë i obliguar në themelimin e degëve të reja në Fushë Kosovë për Komunën e Fushë Kosovës dhe Komunën e Obiliqit, dega në Junik për Komunën e Junikut; dhe dega në Shtime për Komunën e Shtimes, një obligim të tillë ende nuk e ka përmbushur.

Transparenca, siç do të analizohet më poshtë, mbetet një obligim ligjor ende i papërmbushur sa duhet nga ana e sistemit gjyqësor.

IKD në vazhdim ka analizuar zbatimin e obligimeve ligjore bazuar në indikatorët e vendosur në përputhje me detyrimet ligjore të sistemit gjyqësor.

4.1. Raporti Vjetor i Punës së KGJK-së për vitin 2017

Në bazë të nenit 4, paragrafi 1.26, të Ligjit nr.03/L-223, KGJK më 28 mars 2018, miratoi Raportin Vjetor të Punës së KGJK-së për vitin 2017. Ky raport është një nga dokumentet më të rëndësishme, sepse përveç që pasqyron punën një vjeçare të KGJK-së dhe Gjykatave, duke e përmbushur një obligim kushtetues dhe ligjor, njëkohësisht e informon publikun mbi punën dhe aktivitetet e zhvilluara me qëllim të forcimit të sistemit të gjyqësisë në vend.

IKD-ja vlerëson se Raporti Vjetor i Punës së KGJK-së për vitin 2017, është relativisht i paqartë dhe i pamjaftueshëm për shkak se nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për aktivitetet e zhvilluara nga ana e Këshillit, aq më tepër që të dhënat e prezantuara më shumë janë sipërfaqësore-statistikore se sa përmbajtësore. IKD vlerëson se përmbajtja e raportit duhet të jetë e plotë, si për nga struktura ashtu edhe për nga përmbajtja, në mënyrë që publiku të informohet përmbajtësisht për punën e sistemit gjyqësor në Kosovë.

Në raport më shumë pasqyrohet puna e Komisioneve të Këshillit, ndërsa kanë mbetur shumë aspekte të pa prezantuara të vetë punës së KGJK-së. Në pjesën e raportit ku pasqyrohet puna e Këshillit theksohet se janë mbajtur 26 mbledhje, janë nxjerr 379 vendime dhe janë miratuar 10 rregullore, 3 udhëzime administrative, 1 matricë dhe një udhëzues. Sidoqoftë, përveç këtyre të dhënave statistikore asgjë më shumë nuk sqarohet se çfarë vendimesh janë nxjerr dhe se si ato vendime kanë ndikuar në përmirësimin e funksionimit ditor të sistemit gjyqësor. Për më tepër, është evidente mungesa e një analize të punës së Këshillit për vitin 2017, sidomos për çështjet, si në vijim:

- Cila është analiza lidhur me faktorët dhe indikatorët që patën ndikim (pozitiv/negativ) në punën e sistemit gjyqësor gjatë vitit 2017?
- Cilat ishin sfidat e sistemit gjatë vitit raportues dhe si u trajtuan nga ana e Këshillit?
- Cilat ishin kufizimet (psh. buxhetore) dhe çfarë ndikimi patën në punën e Këshillit?
- Si u tejkaluan pengesat dhe çfarë synohet që në të ardhmen të mos përsëriten?
- Cilat ishin rezultatet dhe arritjet kryesore?

IKD gjatë analizimit të raportit nuk ka vërejtur ndonjë analizë konkrete në lidhje me punën e sistemit gjyqësor gjatë vitit 2017. Raporti rezulton të jetë përshkrues, rreth kompetencave dhe aktiviteve të KGJK-së. Në raste të ndryshme, të dhëna të caktuara janë paraqitur si të vetëkuptueshme, si është fjala tek pjesa ku flet për Planin Strategjik 2014-2019, ku thuhet se mbi gjysma e objektiva janë arritur dhe mbetet të punohet për të tjerat, pa dhënë asnjë sqarim shtesë se për çfarë bëhet fjalë, në mënyrë që lexuesit/publiku të informohet saktë.

Për më tepër, raporti nuk ofron informata të mjaftueshme përkitazi me sfidat e ngritura nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare rreth sistemit gjyqësor me fokus të veçantë në:

- a) Pengesat që sistemi gjyqësor ballafaqohet,
- b) vjetërsimi i madh i lëndëve,
- c) trajtimi joefektiv dhe joefikas i lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar etj.

Tutje, një varg autorizimesh ligjore të listuara më poshtë nuk janë pasqyruar në raport. IKD vlerëson se Këshilli nuk e ka ushtruar autoritetin në mënyrë të plotë, në çështjet si:

- Sipas nenit 49 të ligjit për KGJK-në, drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinore (ZPD) është i obliguar të raportojë para Këshillit për punën e ZPD-së. Sidoqoftë, raporti nuk paraqet asnjë informatë nëse një raportim i tillë ka ndodhur. Mungesa e pasqyrimin të këtij aktiviteti në raport krijon përshtypjen se Këshilli nuk e ka përmbushur këtë obligim ligjor. Për më tepër, sa i përket çështjeve disiplinore, Këshilli në bazë të nenit 39 të Ligjit për KGJK-në, vepron si shkallë e dytë dhe për këtë aktivitet të këshillit, raporti nuk ofron të dhëna.

- Sipas nenit 26 të ligjit për KGJK-në, Këshilli themelon Asamblenë e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, si një organ këshillë-dhënës i këshillit. Sidoqoftë, raporti nuk ofron asnjë informatë rreth punës dhe aktiviteve të këtij organi.

- Një herë në vit kryetarët e gjykatave ftohen nga Këshilli për të raportuar për gjykatën respektive. Në raport nuk është pasqyruar ky aktivitet.

- Raporti pasqyron aktivitetet e Njesisë për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore, por vetëm evidenton një numër të raporteve që kjo Njësi i ka dërguar në Këshill për shqyrtim dhe aprovim. Megjithatë, raporti nuk pasqyron aktivitetin e Këshillit përkitazi me këto raporte.

Arsyetimi i KGJK-së lidhur me këto të gjetura është se raporti vjetor pasqyron punën dhe rezultatet e KGJK-së, dhe nuk është analizë, e cila merret me adresimin e çështjeve. Sa i

përket çështjeve të patrajuara në raport, KGJK ka dhënë këto informata, por nuk ka dhënë arsytet se pse këto çështje nuk janë cekur në Raportin Vjetor të Punës së KGJK-së për vitin 2017.

“Ky është raport i cili pasqyron punën dhe rezultatet e KGJK-se, nuk është analize e cila merret me adresimin e çështjeve. Me këtë çështje merret Komisioni për Vlerësimin e Performances se gjyqtarëve dhe Njësia për Shqyrtimin e Performances tani Njësia për inspektim gjyqësor. KGJK-ja ka nxjerr vendim për funksionalizimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve mbikëqyrës në fund të dhjetorit të vitit 2017. Asambleja ka mbajtur menjëherë takimin e parë, inauguroes në të cilin ka zgjedhur kryetarin. Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave gjatë vitit 2018 ka mbajtur dy takime nga të cilat janë nxjerr disa rekomandime, të cilat janë përcjell për shqyrtim në KGJK”.⁵

4.2. Raporti i punës së gjykatave për vitin 2017

Sekretariati i KGJK-së gjatë vitit 2018, ka publikuar Raportin Statistikor të Gjykatave për vitin 2017⁶, i cili raport pasqyron punën e gjykatave në Kosovë, përveç Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Leposaviq dhe Zupin Potok, për shkak të mos funksionimit të tyre.

Raporti i publikuar pasqyron lëndët sipas llojeve në çdo gjykatë respektive, si dhe një analizë lidhur me ngarkesën e gjykatësve me lëndë, duke përfshirë efikasitetin e gjykatësve në zgjidhjen e lëndëve të rënda dhe të lehta, si dhe mesataren më lëndë të ngarkuara në nivel vendi.

Sipas raportit të publikuar nga Sekretariati i KGJK-së, del që Gjykatat Themelore dhe Degët e tyre në të gjitha lëmitë penale, civile, administrative dhe ekonomike kanë pasur 317 gjykatës në tërë vendin dhe 1441 personel mbështetës, gjatë vitit 2017.

Të gjitha Gjykatat Themelore në Kosovë kanë pasur në punë gjatë vitit 2017, 618.991 lëndë të të gjitha natyrave, prej tyre kanë trashëguar nga vitet paraprake 399.127 lëndë, kurse vetëm në vitin 2017, gjykatat kanë pranuar në punë 219.864 lëndë të reja. Gjykatat Themelore gjatë vitit 2017, kanë zgjidhur gjithsej 310.880 lëndë, dhe kanë mbetur të pazgjidhura 307.984 lëndë.

Raporti në fjalë tregon se mesatarisht një gjykatës i Gjykatës Themelore është ngarkuar më 104.2 lëndë në muaj, përderisa gjykatësit mesatarisht kanë zgjidhur 115.6 lëndë në muaj, respektivisht 111 përqind të normës orientuese.

Raporti i publikuar nga Sekretariati i Këshillit është publik dhe në të kanë qasje të gjitha palët e interesuara.

⁵ IKD intervistë përmes postës elektronike me znj. Servane Hoti, Zyrtare e Lartë në KGJK. 25 janar 2019.

⁶Raporti Statistikor i Gjykatave-Vjetori 2017. (Shih linkun <http://www.gjyqesori-rks.org/GetDocument/7786>). (Qasur për herë të fundit me 29 janar 2018).

4.3. Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe masat disiplinore

Ligji i aplikueshëm që rregullon kontrollin dhe ngritjen e llogaridhënies në sistemin gjyqësor për gjykatës ka paraparë mekanizmin e vlerësimit të performancës për gjykatës dhe mekanizmin e disiplinimit të gjykatësve në rastet kur të njëjtit veprojnë në kundërshtim me Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjykatës.

Neni 11 i Ligjit për plotësim ndryshimin e ligjit për KGJK-në, ka përcaktuar themelimin e Komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, i cili përbëhet nga gjyqtarë me përvojë në sistemin gjyqësor të Kosovës.

KGJK më 30 gusht 2016 ka miratuar Rregulloren Nr. 11/2016 për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve. Kjo rregullore përcakton procedurat dhe kriteret e vlerësimit të performancës së gjykatësve të të gjitha niveleve në Kosovë. Kjo Rregullore është plotësuar me Rregulloren 02/2017, ku është përcaktuar që ky Komision të ketë edhe 3 anëtarë rezervë, në rast se anëtarët për shkaqe objektive ose për shkak të konfliktit të interesit, nuk mund të marrin pjesë në punën e Komisionit.

KGJK po ashtu më 6 tetor 2016, kishte themeluar edhe Komisionin për Vlerësimin e Performancës për Gjykatës, i cili përbëhet nga 14 gjykatës prej të gjitha niveleve të gjykatave.

Për vitin 2018, KGJK ka planifikuar që të bëjë vlerësimin e performancës për 64 Gjyqtarë.

Ky proces ka përfunduar në KGJK, ndërsa në takimin e 27 dhjetorit 2018, KGJK ka nxjerrë vendimin për caktimin sipas metodës së rastit të 1/3 së gjyqtarëve, të cilët gjatë vitit 2019 do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit të performancës.

Po ashtu, Komisioni për Vlerësimin e Performancës në KGJK, gjatë vitit 2018 ka bërë vlerësimin 30 Gjyqtarëve që kanë aplikuar për ngritje në detyrë.

Lidhur me procedurat disiplinore për gjykatës gjatë vitit 2018, Komisioni Disiplinor i KGJK-së ka trashëguar 2 lëndë nga viti 2017, derisa ka pranuar vetëm 2 raporte përfundimtare nga Zyra e Prokurorit Disiplinor.

Në vitin 2018, Komisioni Disiplinor i KGJK-së dhe KGJK, ka shqiptuar masat e mëposhtme disiplinore kundër gjykatësve:

Ulje e pagës për 6 muaj 50% nga paga mujore	2 vendime
Ulje e pagës për 3 muaj 20% nga paga mujore	1 vendim
Lirim nga përgjegjësia disiplinore	1 vendim
Totali i masave disiplinore	3 vendime

KGJK nuk ka komentuar të gjeturën e IKD-së lidhur me numrin shumë të vogël të raporteve përfundimtare që ZPD dërgon në KGJK, duke thënë se kjo nuk është në kompetencën e tyre.

“Sa i përket dorëzimit të rasteve disiplinore nga ZPD në KGJK, Ju njoftojmë se kjo nuk është në mandatin e KGJK-së për të komentuar sepse ZPD është organ ndarë dhe i pavarur që i shërben KGJK-së. Është përgjegjësi e ZPD-së për të vlerësuar nëse duhet rekomanduar një gjyqtar në procedurë disiplinore, varësisht nga të nga hetimi disiplinor. KGJK, akoma nuk e ka pranuar raportin përfundimtar të punës së ZPD-së për vitin 2018 dhe se tani për tani, nuk jemi në dijeni sa ka qenë numri i përgjithshëm i parashtresave të pranuar në ZPD. Nga praktika e deritanishme disiplinore dhe në bazë të ligjit, Ju njoftojmë se ZPD rekomandon iniciimin e procedurës disiplinore vetëm në ato raste kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se një gjyqtar ka kryer sjellje të pahijshme. Çështja e hetimit disiplinor është në mandatin e ZPD-së dhe se personat fizik dhe juridik, kanë pasur mundësi të paraqesin parashtresa në ZPD, e cila pas zhvillimit të procedurave konform ligjit në fuqi, vlerëson nëse një parashtresë duhet refuzuar apo hapur hetim disiplinor. Po ashtu, Ju njoftojmë se KGJK brenda afatit ligjor, i ka trajtuar këto lëndë dhe se për çdo gjyqtar që është konstatuar se ka kryer sjellje të pahijshme, të njëjtit janë shpallë përgjegjës dhe në këtë mënyrë ka funksionuar llogaridhënia gjyqësore” ka thënë Hoti nga KGJK⁷.

Në anën tjetër, ZPD gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 30 nëntor 2018⁸ ka pranuar 205 lëndë ndaj bartësve të funksioneve gjyqësore. Po ashtu, ZPD ka zhvilluar hetim preliminar për 2 raporte të IKD-së. ZPD ka trajtuar 274 lëndë ndaj tyre. Pas zhvillimit të hetimeve disiplinore, ZPD ka dërguar 2 lëndë për procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor të KGJK-së, ndërsa janë mbyllur 8 lëndë-hetime disiplinore pa gjetje të sjelljes së pahijshme. Gjithashtu, 174 lëndë janë refuzuar pas hetimit preliminar disiplinor.

Lëndë të trajtuara nga ZPD	Lëndë të dërguara në KD të KGJK-së	Lëndë të mbyllura pas hetimeve disiplinore	Lëndë të refuzuara pas hetimit preliminar
274	2	8	174

IKD monitoron sistematikisht sistemin gjyqësor dhe prokurorial prej vitit 2013, dhe në kuadër të monitorimit vazhdimisht është adresuar edhe performanca e Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Kjo zyre asnjëherë nuk është përkrahur për rolin e vërtetë që ka pasur për ta rritur llogaridhënien e gjykatësve dhe prokurorëve. Sidoqoftë edhe në kuadër të punës që ka kryer, vazhdimisht ka pasur ankesa për zbatim të drejtësisë selektive, të cilat e kanë kompromituar në publik pavarësinë e funksionimit të kësaj zyre.

Gjatë kohës sa ka qenë në proces të hartimit Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, IKD ka kërkuar që të analizohen të gjitha modalitetet e funksionimit të kësaj ZPD-së për ta bërë zgjidhjen më të mirë për ta rritur llogaridhënien e gjykatësve dhe prokurorëve.

Përfundimisht, Kuvendi i Republikës së Kosovës me miratimin e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka vendosur ta shuajë ZPD-në. Tani sipas ligjit të

⁷ IKD intervistë përmes postës elektronike me znj. Servane Hoti, Zyrtare e Lartë në KGJK. 25 janar 2019.

⁸ IKD ka kërkuar qasje në statistika të ZPD-së edhe për muajin dhjetor të vitit 2018. ZPD nuk i ka dërguar të njëjtat, me arsyetimin se janë të zënë duke punuar në raportin vletor të ZPD-së për vitin 2018.

ri, vendimmarrja sa i përket disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk largohet nga kompetencat e KGJK-së dhe KPK-së, pasi rastet disiplinore do të fillohen në parim nga eprori i një gjyqtari, procedura për të cilat do të zhvillohet brenda KGJK-së për gjyqtarë dhe brenda KPK-së për prokurorë.

4.4. Raportimi i Kryetarëve të Gjykatave para Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Bazuar në Ligjin për KGJK, Kryetarët e Gjykatave Themelore në baza vjetore i dërgojnë Këshillit një raport mbi suksesin e zbatimit të planit të mëparshëm vjetor për menaxhimin e lëndëve. Po ashtu sipas ligjit, Kryetari i Gjykatës Themelore i dërgon Këshillit raport tremujor me shkrim që adreson punën e gjykatës, identifikon çfarëdo problemesh me të cilat ballafaqohet gjykata, si dhe propozon hapa për të adresuar problemet.

KGJK ka publikuar raportet statistikore të punës së Gjykatave për tremujorin e parë të vitit 2018, gjashtë mujorin e parë të vitit 2018 si dhe nëntëmujorin e vitit 2018.

Kryetarët e të gjitha Gjykatave Themelore dhe Kryetari i Gjykatës së Apelit më 1 mars 2018 kanë raportuar dhe mbrojtur raportin vjetor për vitin 2017 para KGJK-së. VERIFIKOJ.

Të gjithë Kryetarët e Gjykatave Themelore kanë paraqitur para anëtarëve të KGJK-së raportet 3 mujore të punës për tremujorin e parë të këtij viti. Kryetarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan kanë paraqitur këtë raport me 30 maj 2018, ndërsa kryetarët e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë⁹ më 20 korrik 2018.

Por, për tremujorin e dytë dhe të tretë, Kryetarët e Gjykatave Themelore nuk kanë raportuar dhe mbrojtur para KGJK-së raportet e tyre tremujore.

KGJK ka thënë se ajo në vazhdimësi ka përcjellë punën e gjykatave, pasi këto të fundit kanë dërguar raportet e tyre të punës me shkrim,¹⁰ por të cilat sipas monitorimit të IKD-së rezultojnë se nuk janë shpalosur dhe mbrojtur para Këshillit.

4.5. Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor

KGJK në vazhdimësi proklamon ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me publikun dhe mediat. KGJK ka miratuar rregullore dhe strategji për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien dhe për të lehtësuar bashkëpunimin me publikun dhe median.

IKD gjatë monitorimit të sistemit gjyqësor, gjatë vitit 2018, ka adresuar në sistemin gjyqësor 266 kërkesa për qasje në dokumente publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore, ofrimin të informacioneve, statistikave dhe të dhënave tjera të disponueshme dhe lejueshme sipas Ligjit mbi Qasje në Dokumente Publike.

⁹Shënim: Nënkryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ali Kutllovci, ka ardhë në KGJK për të paraqitur disa informata, pasi raport nuk kishte përpiluar fare. I njëjti ka deklaruar në mbledhje të KGJK-së se ai dhe Kryetari i kësaj Gjykate, Nikolla Kabashiq, nuk kanë qenë të informuar për afatin e përpilimit të këtij raporti. Mirëpo, prapë se prapë, KGJK ka vendosur në votim këtë “raport” dhe të njëjtin e ka miratuar.

¹⁰ IKD intervistë përmes postës elektronike me znj. Servane Hoti, Zyrtare e Lartë në KGJK. 25 janar 2019.

Prej këtyre 266 kërkesave, IKD ma marrë përgjigje pozitive në 146 prej tyre, apo 53.48 %, në 102 prej tyre, apo 41.08%, IKD nuk ka marrë fare përgjigje, kurse në 18 kërkesa institucionet gjyqësore kanë refuzuar të japin të dhënat e kërkuara, apo në 5.81%.

Përkundër kësaj, ka ende vendime dhe rregullore të vitit 2018 të miratuara nga ana e KGJK-së, të cilat nuk janë bërë publike në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.

Sa u përket vendimeve, shumica dërrmuese e tyre nuk janë të publikuara në gjuhën serbe, si gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës, të cilën si gjuhë amë e kanë një numër i gjyqtarëve në sistemin gjyqësor të Kosovës. Në uebfaqen zyrtare të KGJK-së është pjesa e caktuar për tu shkarkuar këto vendime, por ato nuk hapen. Pra, vendimet në gjuhën serbe figurojnë të listuara dhe të qasshme, por praktikisht nuk mund të hapen. Kjo qëndron edhe më keq sa i përket vendimeve që KGJK ka marrë gjatë vitit 2017, ku asnjëri prej tyre nuk është i publikuar në gjuhën serbe, përderisa ende ka vendime edhe nga viti 2016 që nuk janë të publikuara në gjuhën serbe.

Po ashtu, KGJK nuk fton rregullisht mediat dhe shoqërinë civile në takimet e tyre të hapura. Në këtë drejtim, KGJK nuk ka ftuar mediat dhe shoqërinë civile për takimin e 202-të të saj, ku si pikë e rendit të ditës ka qenë edhe zgjedhja e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, proces ky i stërzgatur në Këshill. Përkundër rëndësisë së kësaj pike dhe pikave të tjera për mediat dhe shoqërinë civile, KGJK ka përfunduar këtë proces larg syve të publikut.

KGJK në mënyrë të njëjtë kishte vepruar edhe sa i përket takimit të 198-të. Për këtë takim, mediat dhe shoqëria civile ishin ftuar për 15 shkurt, ku mbledhja parashihej të fillonte në ora 13:30. Në anën tjetër, KGJK pa asnjë paralajmërim kishte mbajtur këtë takim në ora 10:00, pa dhënë asnjë arsytim për publikun. Përpos kësaj, KGJK nga ky takim nuk kishte lëshuar fare komunikatë për media, në mënyrë që të njoftohet publike se çfarë kishte ndodhur në këtë takim. Mediat nuk janë ftuar as për takimin e 209-të të KGJK-së.

Mos zbatimi i obligimeve ligjore dhe politikave të miratuara nga KGJK, forcon gjetjet e IKD-së dhe vlerësimet e dala nga raporte ndërkombëtare dhe vendore lidhur me mungesën e vullnetit të sistemit gjyqësor për të qenë transparent dhe llogaridhënës para publikut.

Përkundër këtyre gjetjeve të IKD-së, të bazuara në monitorimin sistematik që i bënë KGJK-së, zyrtarët e kësaj kjo të fundit deklarojnë se qëllim kryesor i këtij institucioni është transparenca, dhe se të gjitha vendimet dhe rregulloret janë të publikuara në uebfaqe:

“KGJK si qëllim kryesor ka që të rritet transparencë dhe normalisht përgjigjet për të gjitha kërkesat dhe pyetjet e parashtruara nga të gjithë qytetarët dhe OJQ të ndryshme. Me rastin e caktimit të mbledhjes, KGJK publikon në ueb faqe rendin e ditës dhe ftohet të gjitha mediat për pjesëmarrje, vetëm në raste të caktuara kur takimet janë të mbyllur. Momentalisht të gjitha vendimet dhe rregulloret e KGJK-së janë të publikuara në ueb faqe zyrtare”.¹¹

¹¹ IKD intervistë përmes postës elektronike znj. Servane Hoti, Zyrtare e Lartë në KGJK. 25 janar 2019.

4.6. Avancimi dhe transferimi i Gjykatësve

KGJK gjatë vitit 2018 me qëllim të forcimit të Gjykatës së Apelit, ka avansuar 15 Gjyqtarë në këtë Gjykatë.

Në takimin e 15 shkurtit 2018, KGJK kishte marrë vendim për avancimin e pesë (5) Gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit, përderisa më 27 dhjetor 2018 kishte marrë vendim për avancimin e 10 Gjyqtarëve në këtë gjykatë.

Sa i përket transferimit të Gjyqtarëve, KGJK gjatë takimit të 15 marsit 2018 ka transferuar në afat prej 12 muajve:

- Gjyqtaren Milena Tomoviq nga Gjykata Themelore e Prishtinës në Gjykatën Themelore të Pejës, Dega në Klinë;
- Gjyqtarin Boban Aleksiq nga Gjykata Themelore e Prishtinës në Gjykatën Themelore të Gjilanit, Dega në Novëbërdë;
- Gjyqtaren Servete Morina nga Gjykata Themelore e Ferizajit, Dega në Shtërpçë në Gjykatën Themelore të Prizrenit; si dhe
- Gjyqtaren Gordana Virijeviq nga Gjykata Themelore në Prishtinë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Në mënyrë që Gjykata Themelore e Prishtinës të forcohej me gjyqtarë, të cilët do të trajtonin rastet e korrupsionit, me theks të veçantë lëndët e shënjestëruara për liberalizim të vizave, KGJK në takimin e mbajtur më 2 maj 2018, ka marrë vendim me anë të së cilit ka transferuar pesë (5) Gjyqtarë në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Për dy (2) prej këtyre Gjyqtarëve, KGJK në takimin e mbajtur më 20 korrik 2018 ka revokuar vendimin, përderisa për tre (3) të tjerët në takimin e mbajtur më 24 tetor 2018 ka vendosur që t'ua vazhdojë transferin edhe për gjashtë (6) muaj.

IKD ka gjetur se KGJK ka ndjekur një praktikë të kundërligjshme të ngritur vazhdimisht nga IKD, me rastin e transferimit të disa gjyqtarëve, ku përkundër faktit se disa prej tyre kanë qenë duke punuar në Departamentin e Përgjithshëm në Gjykatën prej nga kanë ardhur, të njëjtit në Gjykatën ku janë transferuar kanë punuar në Departamentin për Krime të Rënda.

Kalimi i një Gjyqtari nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda nuk mund të konsiderohet transferim, por avancim. Ligji për Gjykatat përcakton se Departamenti për Krime të Rënda është i një niveli më të lartë se Departamenti i Përgjithshëm.

Në nenin 29.2.1 përcakton se “që të ushtroj funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, kandidati duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë si gjyqtarë në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore dhe së paku gjashtë (6) vite përvojë në fushën juridike duke përfshirë edhe përvojën në lëmin penal”, kusht i cili nuk përmendet për Gjyqtarët në Departamentin e Përgjithshëm.

Po ashtu, edhe sa i përket kompensimit, Ligji për Gjykatat në nenin 29.1.7 përcakton kompensim të veçantë për Gjyqtarët në Departamentin për Krime të Rënda për dallim prej

atyne në Departamentin e Përgjithshëm. Ky nen përcakton që “çdo gjyqtar i Gjykatës Themelore do të pranojë një pagë bazë jo më pak se shtatëdhjetë **(70)%** të pagës së Kryetarit të Gjykatës Themelore. KGJK do të shpallë një plan për kompensime shtesë të cilat njohin përgjegjësinë unike të gjyqtarëve, të cilët shërbejnë në Departamentet për **Krimet e Rënda**, Çështjet Ekonomike apo Administrative; por shumta e pagës bazë dhe kompensimeve shtesë në asnjë rast nuk do të tejkalojë nëntëdhjetë **(90) %** të pagës së Kryetarit të Gjykatës Themelore. “

Rregullorja për transferimin dhe caktimin e Gjyqtarëve përkufizon termin “transferim”, ku përcakton se “Transferi: nënkupton lëvizjen e gjyqtarëve ndërmjet gjykatave themelore, brenda gjykatës përkatëse dhe degëve të gjykatës **në vije horizontale te niveleve te barasvlefshme.**”

Po ashtu, neni 6.1 i kësaj rregulloreje përcakton se transferi i përhershëm mund të bëhet nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin e Përgjithshëm të një Gjykate tjetër, apo nga Departamenti për Krime të Rënda në Departamentin për Krime të Rënda apo Departamentin për të Mitur në një Gjykatë tjetër.

Ky nen përcakton shprehimisht se: “Transferimi i përhershëm nënkupton transferimin:

- 1) nga departamenti i përgjithshëm i gjykatës themelore ose një dege të gjykatës themelore në departamentin e përgjithshëm të një gjykate themelore tjetër apo dege të një gjykate themelore tjetër,
- 2) Nga departamenti për krime të rënda apo departamenti për të mitur të një gjykate themelore në një departament për krime të rënda apo departament për të mitur të një gjykate themelore tjetër.”

Në nenin 8.1.2 të kësaj rregullore përcaktohet se Gjyqtari, i cili është kandidat për transferim të përhershëm duhet të plotësoj kriteret si në vijim: 1.2. të permbush kërkesat për gjyqtar në nivel përkatës të gjykatës dhe departamentit sic parashihen në nenin 9 paragrafi 4 i Ligjit S/L-032 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat. Ky nen përcakton që “përveç kualifikimeve minimale, të gjithë kandidatët për emërim për gjyqtarë, me qëllim të emërimit apo avancimit në gjykata duhet të kenë kualifikimet si në vijim: 4.1. për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda apo për të Mitur në Gjykatën Themelore, kandidati duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë si gjyqtar në lëmin penal apo prokuror”.

Në bazë të këtyre gjetjeve, IKD konsideron se KGJK duhet të ndalojë praktikën e avancimit në emër të transferimit, dhe transferet ndërmjet gjykatave të realizohen në nivel të njëjtë të departamenteve, dhe jo nga një departament më i ulët në një departament më të lartë.

4.7. Monitorimi i takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovë

Prej periudhës 1 janar deri më 31 dhjetor 2018, KGJK ka mbajtur gjithsej 13 takime, që rezultojnë se përafërsisht ka mbajtur një (1) takim në muaj. Gjatë vitit 2018, ndonëse KGJK kishte nxjerrë vendimin për orarin e takimeve të KGJK-së, mbledhjet në KGJK nuk janë mbajtur sipas planifikimit të caktuar. Në bazë të këtij vendimi, KGJK ka përcaktuar se deri më 30 nëntor 2018, do të mbajë gjithsej 19 takime, që në praktikë del se ka mbajtur gjashtë (6) takime më pak. Në anën tjetër, raste përjashtuese janë kur KGJK ka respektuar datën e mbajtjes së takimit, siç është përcaktuar në vendimin për orarin e takimeve të KGJK-së, të cilin vetë KGJK e ka miratuar.

Gjatë muajve qershor dhe gusht, KGJK nuk ka mbajtur asnjë takim. Ky fakt paraqet shkelje të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e KGJK-së, përkatësisht nenit 38 ku thuhet se “*Kryesuesi do të përcaktojë planin vjetor për takimet e Këshillit. Këshilli zakonisht mban takime një herë në muaj...*”. Në bazë të planit vjetor për takimet e KGJK-së, për muajt qershor dhe gusht janë përcaktuar të mbahen nga 2 mbledhje, por që asnjëra prej tyre nuk është mbajtur.

4.8. Diskutimet e anëtarëve të KGJK-së gjatë miratimit të politikave/publikimi i vendimeve

IKD ka monitoruar në detaje të gjitha takimet e KGJK-së, përfshirë pjesëmarrjen në diskutim nga të gjithë anëtarët e Këshillit. Gjetjet tregojnë se në KGJK ka anëtarë të caktuar, të cilët asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në diskutim për çështjet me interes për sistemin gjyqësor. Për dallim nga KPK (*ku do të elaborohet më poshtë në raport*), në KGJK ka përfshirje shumë më të madhe të anëtarëve në diskutim dhe vendimmarrje. Megjithatë, IKD gjen se mungon debati përmbajtësor dhe profesional për të kontribuar në ngritjen e cilësisë në bërjen e politikave dhe miratimin e vendimeve në përputhje me ligjin, praktikën dhe standardet evropiane. Gjatë vitit 2018, KGJK ka nxjerrë 221 vendime, votimi i të cilave në shumë raste merret me vota unanime, megjithatë ka raste në të cilat votimi i anëtarëve është i ndryshëm, duke dëshmuar elemente të demokracisë së Këshillit.

Sa i përket mungesës së debatit në KGJK, zyrtarët e Këshillit deklarojnë se është në diskrecion të anëtarëve të Këshillit që ata të marrin fjalën dhe të diskutojnë për pikat e rendit të ditës:

“Është plotësisht në diskrecionin e anëtarëve të KGJK-së, që ata ta marrin fjalën dhe të diskutojnë për pikat e rendit të ditës, sikur se edhe mënyra e votimit është e drejtë e tyre dhe se kjo është plotësisht mënyrë demokratike e diskutimit në mbledhje dhe mënyrës se vendosjes”¹².

¹² IKD intervistë përmes postës elektronike me znj. Servane Hoti, Zyrtare e Lartë në KGJK. 25 janar 2019.

Monitorimi i diskutimeve të anëtarëve të KGJK-së në mbledhjet e KGJK-së në vitin 2018

Anëtarët e KGJK	Mbledhjet e monitoruara të Këshilli Gjyqësor të Kosovës në vitin 2018									
	19 janar	1 mars	15 mars	2 maj	30 maj	12 shtator	24 tetor	30nëntor	27 dhjetor	Tota l
1. Nehat Idrizi	15 min, 10 sek	34 min, 25 sek	14 min	21 min, 1 sek	15 min, 3 sek	19 min, 57 sek	31 min, 2 sek	21 min, 24 sek	22 min, 50 sek	3 orë, 14 min, 52 sek
2. Makifete Saliuka	Mungon	1 min, 59 sek	1 min, 50 sek	4 sek	5 min, 24 sek	10 min, 17 sek	4 min, 1 sek	5 min, 4 sek	3 min, 30 sek	32 min, 09 sek
3. Manushe Karaqi	40 sek	33 sek	Mungon	39 sek	Pasiv	2 e 15 sek	23 sek	48 sek	Mungon	5 min, 18 sek
4. Armend Berisha	2 min/50 sek	Pasiv	3 min, 45 sek	5 min, 42 sek	4 min, 54 sek	Mungon	Mungon	3 min, 57 sek	2 min, 39 sek	23 min, 47 sek
5. Skender Çoçaj	Pasiv	2 min, 56 sek	17 sek	1 min, 53 sek	50 sek	4 min, 22 sek	1 min, 50 sek	Pasiv	1 min, 26 sek	13 min. 34 sek
6. Muhamet Rexha	Mungon	Pasiv	Pasiv	1 min, 28 sek	12 sek	3 min, 14 sek	4 min, 47 sek	6 min, 45 sek	3 min, 59 sek	20 min, 25 sek
7. Anita Prenaj-Krasniqi	Pasiv	Mungon	Pasiv	Pasiv	1 min, 33 sek	2 min, 45 sek	1 min, 2 sek	Pasiv	28 sek	5 min, 48 sek
8. Gjimeshit Galushi	1 min, 20 sek	40 sek	3 sek	Pasiv	Pasiv	Pasiv	27 sek	1 sek	Pasiv	2 min, 31 sek
9. Nenad Laziq	1 min, 8 seko	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	50 sek	Mungon	Pasiv	1 min	2 min, 58 sek
10. Cerim Fazliji	Pasiv	1 min, 43 sek	Pasiv	Pasiv	Pasiv	13 sek	Pasiv	1 min, 53 sek	Pasiv	3 min, 49 sek
11. Radojka Trifunoviq	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	36 sek	Pasiv	Mungon	Pasiv	36 sek

Në vazhdim janë paraqitur të gjitha mbledhjet, në të cilët përfshihen vendimet e marra:

- **KGJK takimin e parë në vitin 2018, e ka mbajtur më 19 janar 2018 apo mbledhjen e 197-të.** Gjatë këtij takimi, KGJK i ka propozuar Presidentit të Republikës së Kosovës gjyqtarët Agim Maliqi, Rasim Rasimi dhe Ragip Namani për dekretim si Gjyqtar të Gjykatës Supreme, ka hapur konkurs të brendshëm për 10 Gjyqtarë në Gjykatën e Apelit, ka marrë vendim për rikonfirmim e vendimit për pagën e drejtorit të SKGJK-së dhe drejtorit të NJSHPGJ si dhe ka themeluar Komisionet përzgjedhëse për Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjilan si dhe Gjyqtarët Mbikëqyrës për Degën e Kamenicës, Novëbërdës, Leposaviqit dhe Zubin Potokut. Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.
- **KGJK takimin e dytë në vitin 2018, e ka mbajtur më 15 shkurt 2018 apo mbledhjen e 198-të. I njëjti takim, si i mbyllur është vazhduar edhe më 16 shkurt 2018.** Gjatë këtij takimi, KGJK ka avancuar në Gjykatën e Apelit Gjyqtarët Afrim Shala, Lumni Sallauka, Valon Totaj, Delushe Halimi dhe Burim Shala, ka caktuar për nënkryetar të Gjykatës Themelore në Ferizaj Gjyqtarin Sahit Krasniqi, ka miratuar raportin e punës së SKGJK-së për vitin 2017 si dhe ka themeluar Komisionin për rishqyrtimin e procesit të decentralizimit. Në vazhdimin e kësaj mbledhje më 16 shkurt 2018, KGJK nuk ka miratuar dorëheqjen e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Nikolla Kabashiq¹³. Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.
- **KGJK takimin e tretë në vitin 2018, e ka mbajtur më 1 mars 2018 apo mbledhjen e 199-të.** Gjatë këtij takimi, kryetari i Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe Kryetarët e Gjykatave Themelore kanë paraqitur raportet e Gjykatave të tyre për vitin 2017. Po ashtu, në këtë mbledhje janë shqyrtuar edhe dy (2) raporte të NJSHPGJ si dhe Gjyqtarja Mevlide Shabani është caktuar u.d. e Kryetares së Gjykatës Themelore në Gjilan. Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.
- **KGJK takimin e katërt në vitin 2018, e ka mbajtur më 15 mars 2018 apo mbledhjen e 200-të.** KGJK gjatë këtij takimi i ka propozuar Presidentit riemërimin e 41 Gjyqtarëve, ka transferuar Gjyqtaren Milena Tomoviq nga Gjykata Themelore e Prishtinës në Gjykatën Themelore të Pejës, Dega në Klinë, Gjyqtarin Boban Aleksiq nga Gjykata Themelore e Prishtinës në Gjykatën Themelore të Gjilanit, Dega në Novëbërdë, Gjyqtaren Servete Morina nga Gjykata Themelore e Ferizajit-Dega në Shtërpçë në Gjykatën Themelore të Prizrenit si dhe ka transferuar Gjyqtaren Gordana Virijejiq nga Gjykata Themelore në Prishtinë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.
- **KGJK takimin e pestë në vitin 2018, e ka mbajtur më 30 mars 2018 apo mbledhjen e 201-të.** KGJK në këtë mbledhje ka formuar Komisionin përzgjedhës për kandidatët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit, ka miratuar listën me shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve të gjyqësorit të Kosovës dhe

¹³KGJK ka ndryshuar pa paralajmërim orarin për mbajtjen e takimit së 15 shkurtit, dhe të njëjtit më pas nuk kanë dhënë ndonjë arsytim. Vazhdimi me 16 shkurt zyrtarisht ka qenë i mbyllur.

afatet e ruajtjes së tyre si dhe ka caktuar anëtarin Manushe Karaqi anëtare të Gjyqit të Nderit në Odën e Stomatologëve të Kosovës.

Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.

- **KGJK takimin e gjashtë për vitin 2018, e ka mbajtur më 17 prill 2018 apo mbledhjen e 202-të.** Gjatë këtij takimi, KGJK ka zgjedhur Ramiz Azizin për kryetar të Gjykatës Themelore në Gjilan, ka formuar Komisionin për rekrutim të Gjyqtarëve në Gjykata Themelore si dhe ka refuzuar kërkesën e kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit, z. Refki Suma, për themelimin e një Gjykate Themelore në komunën e Hanit të Elezit¹⁴.

Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.

- **KGJK takimin e shtatë për vitin 2018, e ka mbajtur më 2 maj 2018 apo mbledhjen e 203-të.** KGJK gjatë këtij takimi ka transferuar përkohësisht pesë (5) Gjyqtarë në Gjykatën Themelore të Prishtinës, ka miratuar rregulloren për Sistemin Qendror të Evidencës Penale, ka caktuar Gjyqtarin Aziz Shaqiri nënkryetar të Gjykatës Themelore në Gjilan si dhe ka hapur konkursin për shtatë (7) Gjyqtarë për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.

- **KGJK takimin e tetë për vitin 2018, e ka mbajtur më 30 maj 2018 apo mbledhjen e 204-të.** Gjatë këtij takimi, për tre mujorin e parë të vitit 2018 kanë raportuar Kryetarët e Gjykatës Themelore të Prishtinës, Prizrenit dhe Gjilanit. Gjatë këtij takimi, KGJK ka miratuar edhe Planin e Punës për vitin 2018, ka vendosur për ndërprerjen e kontratës sipas fuqisë ligjore për katër (4) gjyqtarë, si dhe ka zgjedhur Sadri Krasniqin për Gjyqtar Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore të Gjilanit – Dega në Kamenicë, Emine Salihun për Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Novëbërdë dhe Bojana Trboljevac në Gjykatën Themelore të Mitrovicës – Dega në Leposaviq.

Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.

- **KGJK takimin e nëntë për vitin 2018, e ka mbajtur më 20 korrik 2018 apo mbledhjen e 205-të.** Në këtë takim, para anëtarëve të KGJK-së ka raportuar Kryetari i Gjykatës Themelore të Ferizajit, asaj të Gjakovës, Pejës dhe Mitrovicës, është hapur konkursi për Gjyqtar Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore të Mitrovicës – Dega në Zubin Potok, ka vendosur që të anulohet vendimi për transferimin e dy (2) Gjyqtarëve në Gjykatën Themelore të Prishtinës si dhe ka vendosur që Gjyqtarët e pensionuar dhe ish-drejtori i ZPD-së të kenë të drejtë në marrjen e shumës retroaktive në raport me vendimin e Qeverisë për ngritjen e pagave.

Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.

- **KGJK takimin e dhjetë për vitin 2018, e ka mbajtur më 12 shtator 2018 apo mbledhjen e 206-të.** Ndër vendimet më të rëndësishme që KGJK ka nxjerrë gjatë këtij takimi është vendimi për kompensimin e anëtarëve të KGJK-së. Në bazë të këtij vendimi, anëtarët e KGJK-së për periudhën 1 janar 2018 deri më 31 gusht 2018 do të marrin në mënyrë retroaktive shumën prej 25% të pagës së tyre bazë, bazuar në vendimin e Qeverisë Haradinaj për ngritjen e pagave. Prej shtatorit, do të vazhdojnë të

¹⁴ KGJK këtë takim e ka mbajtur pa media, pasi askush nga mediat nuk ka qenë i njoftuar. IKD kur e ka pyetur KGJK- në se pse ka ndodhur një fakt i tillë, të njëjtit janë arsyetuar se në këtë rast ka ndodhur një gabim teknik.

marrin nga 262.75 euro në muaj. Gjatë këtij takimi është miratuar kërkesa e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi, që ai të kaloj nga Departamenti i Përgjithshëm në atë të Krimeve të Rënda si dhe është hapur konkursi për dy (2) Gjyqtarë të lamisë penale në Gjykatën Supreme dhe një (1) Gjyqtar për kolegjin e apelit për Agjencinë Kosovare të Pronave.

Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.

- **KGJK takimin e njëmbëdhjetë për vitin 2018, e ka mbajtur me 24 tetor 2018 apo mbledhjen e 207-të.** Gjatë këtij takimi, KGJK ka miratuar kërkesën buxhetore për vitin 2019, u'a ka vazhduar edhe për gjashtë (6) muaj transferin në Gjykatën Themelore të Prishtinës katër (4) gjyqtarëve, ka ndryshuar organogramin për gjyqtarë, ku 13 gjyqtarë janë larguar nga organogrami i Gjykatave Themelore, gjashtë (6) prej të cilëve kanë kaluar në Gjykatën e Apelit, ndërsa shtatë (7) në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ka diskutuar në lidhje me agjendën e Ministrisë së Drejtësisë “Drejtësia 2020” si ka ka themeluar grup punues për këtë agjendë.

Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.

- **KGJK takimin e dymbëdhjetë për vitin 2018, e ka mbajtur më 30 nëntor apo mbledhjen e 208-të:** Gjatë këtij takimi, KGJK ka miratuar listën prej 37 gjyqtarëve për dekretim tek Presidenti i Republikës së Kosovës si dhe ka hapur konkurs për 27 gjyqtarë të rinj. KGJK po ashtu ka miratuar planin operacional mbi krijimin dhe funksionalizimin e Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës si dhe ka miratuar Rregulloren për Shfrytëzimin e TIK-ut në Sistemin Gjyqësor. Gjatë këtij takimi, KGJK ka marrë vendim që të kërkojë nga kryetari, gjyqtarët dhe stafi administrativ i Gjykatës Themelore në Mitrovicë që mos të ndikohen nga veprimet politike, ka miratuar dorëheqjen e anëtarit të KGJK-së, Skender Çoçaj nga pozita e anëtarit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme që të themelore kolegjet gjyquese në dhomë të posaçme si dhe të kërkohej nga kryetari i kësaj dhome formimi i kolegjit për ankesa si dhe ka caktuar anëtarët e komisionit për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose të Arrestuar pa arsye.

Të gjitha vendimet nga ky takim janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.

- **KGJK takimin e trembëdhjetë për vitin 2018, e ka mbajtur më 27 dhjetor, apo mbledhjen e 209-të:** Gjatë këtij takimi, KGJK ka avansuar 10 gjyqtarë në Gjykatën e Apelit, ka marrë vendim për caktimin me short të gjyqtarëve që në vitin 2019 do t'i nënshtrohen vlerësimit të performancës si dhe ka caktuar anëtarët e asamblesë së kryetarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës nga radhët e gjyqtarëve mbikëqyrës. Vendimet nga ky takim nuk janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KGJK-së.

5. Miratimi i legjislacionit sekondar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPK gjatë vitit 2018, nuk ka treguar efikasitet lidhur me hartimin e legjislacionit sekondar dhe përmbushjen e obligimeve që dalin nga legjislacioni i aplikueshëm për sistemin prokurorial në Kosovë. KPK gjatë kësaj periudhe kohore ka miratuar vetëm një rregullore:

1. Rregullore për Shfrytëzimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Sistemin Prokurorial.

KPK gjatë vitit 2018 ka miratuar udhëzimet administrative për:

1. Menaxhimin e pasurisë jo financiare të KPK-së;
2. Përdorimin e autormjeteve zyrtare të Sistemit Prokurorial;
3. Caktimin e normës orientuese për Prokurorët e Shtetit.

Janë edhe një numër i rregulloreve që dalin si obligime nga Ligji për KPK dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit, të cilat KPK ende nuk i ka miratuar. KPK nuk ka miratuar ende këto rregullore:

1. Rregulloren për Standardizim lidhur me Ligjërimin e Prokurorëve;
2. Procedurat Standarde të Veprimit lidhur me Evitimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funkcionit nga Anëtarët e KPK-së;
3. Rregulloren për Rregullat dhe Procedurat që Qeverisin Ankesat ndaj vendimeve të KPK-së rreth zhvendosjes së përhershme apo transferimit kundër vullnetit të Prokurorëve që tejkalojnë periudhën gjashtë (6) mujore.

Kryesuesi i ri i KPK-së, Bahri Hyseni, ka thënë se mosmiratimi i legjislacionit sekondar nga ana e KPK-së nuk ka të bëjë me mosefikasitetin e këtij institucioni, por se pengesë ka qenë fakti që Ligji për KPK nuk është miratuar ende:

“Hartimi i akteve nënligjore të Këshillit Prokurorial të Kosovës është një proces, i cili ndërlidhet me miratimin e ligjeve në Kuvendin e Kosovës, në rastin konkret, Këshilli gjatë vitit 2018 me Planin e Punës ka pasur në agjendë plotësimin dhe ndryshimin e 8 rregulloreve. Të gjitha këto rregullore kanë qenë të bazuara në ndryshimet ligjore të sistemit prokurorial, përkatësisht, Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Siç e dini, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës ende nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Kjo nënkupton se mosmiratimi i këtyre rregulloreve nuk ka të bëjë me mosefikasitetin e Këshillit, mirëpo me mosmiratimin e ligjeve nga ana e Kuvendit. Disa nga këto draftrregullore janë hartuar në Komisionin për Çështje Normative, duke u bazuar në Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili ende nuk është miratuar dhe ne po presim draftin final të ligjit, në mënyrë që këto rregullore pastaj të miratohen në afatin më të shpejtë të mundshëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për informatën tuaj, sa i përket akteve nënligjore, Këshilli ka miratuar 28 rregullore që nga viti 2015, të cilat i ka pasur për obligim nga ligjet e miratuara në Kuvend. Po ashtu sa i përket miratimit të akteve nënligjore jemi vlerësuar edhe nga partnerët ndërkombëtar” ka theksuar kryesuesi Hyseni¹⁵.

¹⁵ IKD intervistë përmes postës elektronike me z. Bahri Hyseni, Kryesues i KPK-së. 24 janar 2019.

Hyseni ka konfirmuar gjetjet e IKD-së lidhur me numrin e rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që KPK ka miratuar gjatë vitit 2018¹⁶.

Përderisa, miratimi i rregulloreve të lartpërmendura është kërkesë ligjore që nga viti 2011, kur kishte hyrë në fuqi Ligji mbi KPK-në, edhe në vitin 2018, KPK nuk ka arritur ti përmbush këto obligime ligjore.

5.1. Rregullore për Shfrytëzimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në KPK

KPK në takimin e 150-të të mbajtur më 30 prill 2018 ka miratuar Rregulloren për Shfrytëzimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Sistemin Prokurorial. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave për shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në sistemin prokurorial.

Kjo rregullore vendos rregulla të detajuara lidhur me përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përdorimit të softuerëve të teknologjisë së informacionit, përdorimit të shërbimeve të internetit, përdorimit të shërbimeve të postës elektronike dhe menaxhimin e sigorisë së informacionit.

Kjo rregullore ndonëse është e një rëndësie mjaft të madhe, IKD gjen se kanë mbetur shumë çështje të patrajuara.

IKD e vlerëson mjaft shqetësuese trajtimin e përgjithësuar të sigorisë së informacionit në KPK si dhe faktin e mos përcaktimit të rregullave lidhur me disiplinimin e punonjësve në sistemin prokurorial, të cilët e shkelin këtë rregullore.

Fillimisht, në lidhje me menaxhimin e sigorisë së informacionit, kjo rregullore nuk përmban detaje dhe masa konkrete në lidhje me sigurinë e informatave brenda sistemit prokurorial. Kërkesa ndaj të punësuarve për kujdes maksimal si dhe asgjësimi i diskut në aparaturat e dëmtuara nuk janë standarde të mjaftueshme për rritjen e sigorisë. Aq më pak kur në sistemin prokurorial pritet që e gjithë punë të bëhet elektronike, me anë të implementimit të projektit TIK/SMIL.¹⁷

Në anën tjetër, IKD e vlerëson mjaft shqetësuese faktin se kjo rregullore nuk e ka rregulluar si duhet çështjen e disiplinimit të punonjësve në sistemin prokurorial, të cilët nuk i përmbahen detyrimeve që përcakton kjo rregullore. Masa më e rëndë që kjo rregullore ka përcaktuar ndaj personave, të cilët nuk i përmbahen kësaj rregullore është ndalimi i pjesshëm dhe ndalimi i plotë i përdorimit të pajisjeve dhe sistemit kompjuterik. IKD vlerëson se duhet pasur parasysh fakti se me anë të keqpërdorimit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit brenda sistemit prokurorial mund të ketë dëme jashtëzakonisht të mëdha, ndërsa sanksioni i ndalimit të përdorimit të pajisjeve dhe kompjuterit nuk është sanksion, i cili do të mund të

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Projekti TIK/SMIL (Teknologjia Informativ e Komunikimit)/SMIL (Sistemi për Menaxhim Informativ të Lëndëve) është projekt i përbashkët në mes KGJK-së dhe KPK-së, që mbështetet nga Ambasada Norvegjeze në Kosovë. Ky projekt ka për qëllim digjitalizimin e punës në të gjitha Gjykatat dhe Prokuroritë e Republikës së Kosovës.

parandalonte veprimet e tilla. Po ashtu, në drejtim të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, mund të ketë shkelje të natyrave prej më të ndryshmeve dhe për këtë arsye, IKD vlerëson se duhet të ketë llojllojshmëri të masave disiplinore dhe të precizohet se cila masë për secilin rast. Kjo situatë është shqetësuese për faktin se përkundër rregullimit preciz të shfrytëzimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në sistemin prokurorial, është vështirë që të pritët zbatim në praktik pa pasur llogaridhënie përmes disiplinimit adekuat të punonjësve brenda sistemit prokurorial.

6. Llogaridhënia dhe integriteti në sistemin prokurorial dhe mekanizmat e kontrollit

IKD gjatë monitorimit sistematik të punës së KPK-së, ka gjetur se Këshilli nuk ka arritur të përmbush obligimet bazë lidhur me zbatimin e ligjeve bazike dhe rregulloreve bazë të miratuara nga vet Këshilli. IKD ka gjetur se mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjës brenda KPK-së edhe pse janë të themeluar në letër, në praktikë nuk janë efikas.

Mungesa e kontrollit dhe mbikëqyrjës në praktikë, po ndikojnë që në sistemin prokurorial të mungoi llogaridhënia, efikasiteti dhe përgjegjshmëria, të cilat janë duke ndikuar në instalimin e kulturës së pandëshmueshmërisë.

Obligimet ligjore të sistemit prokurorial	Përmbushur	Nuk janë përmbushur	Afati
Raporti vjetor i Punës së PSh-së		X	Muaji mars i vitit respektiv
Raporti vjetor i Punës së KPK-së	X		Muaji mars i vitit respektiv
Vlerësimi i Përformancës së Prokurorëve	X		1/3 e prokurorëve brenda vitit
Emërimi i Drejtorit të Njësitit për Vlerësimin e Përformancës së Prokurorëve	X		
Emërimi i anëtarit të KPK-së nga shoqëria civile		X	1 janar 2016
Raportimi i Kryeprokurorëve para KPK		X	Çdo tre muaj
Miratimi i Planit të Punës së PSh-së për vitin 2019		X	Muaji tetor i vitit respektiv
Raportimi para publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikator të matshëm çdo gjashtë (6) muaj.		X	Çdo gjashtë muaj brenda vitit kalendarik

IKD në vazhdim ka analizuar zbatimin e obligimeve ligjore bazuar në indikatorët e vendosur në përputhje me detyrimet ligjore të sistemit prokurorial.

6.1. Raporti vjetor i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2017

Neni 4 paragrafi 1 pika 12 e Ligjit për KPK-në përcakton se KPK është i obliguar në përgatitjen e një raporti vjetor mbi veprimtarinë e Prokurorit të Shtetit.

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, në takimin e KPK-së të mbajtur më 30 maj 2018, ka paraqitur Raportin Vjetor të Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2017.

Në raport thuhet se Prokurori i Shtetit (PSh) gjatë vitit 2017 ka pasur në punë gjithsej 185,772 kallëzime – lëndë penale (*lëndë nga regjistrat: PP, PPM, PPN, NJN, PPP, lëndët e PA-së dhe ZKPSH-së*) nga të cilat 129,531 janë trashëguar si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake. Në periudhën raportuese, PSh ka pranuar në punë gjithsejtë 56,241 kallëzime – lëndë penale nga të cilat prokurorët kanë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente 71,230 prej tyre³ ose 26.65% përkatësisht 14,989 kallëzime – lëndë penale më shumë se që kanë pranuar.

Në fund të periudhës raportuese, të pazgjidhura kanë mbetur 114,542 kallëzime – lëndë penale.

6.2. Raporti Vjetor i Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2017

Neni 4 paragrafi 1 pika 12 e Ligjit për KPK-në përcakton se KPK është i obliguar në përgatitjen e një raporti vjetor mbi veprimtarinë e Prokurorit të Shtetit dhe shpenzimeve të Këshillit.

KPK më 29 dhjetor 2015, kishte miratuar Rregulloren Nr. 10/2015, për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së. Në nenin 41 të kësaj rregullore, KPK ka përcaktuar obligimin e miratimit dhe publikimit të Raportit vjetor të punës së KPK-së deri më 31 mars të vitit pasues. Ky nen ka obliguar Sekretariatit të mbështet Këshillin në përgatitjen me kohë të projekt raportit për shqyrtim dhe miratim në Këshill.

KPK në takimin e 149-të, të mbajtur më 27 mars 2018, kishte miratuar raportin vjetor për KPK-në.

Ky raport, krahas informatave të përgjithshme rreth KPK-së, përmban të dhëna lidhur me aktivitetet e KPK-së, SKPK-së, NjShPP si dhe të dhëna lidhur me buxhetin e sistemit prokurorial.

Raporti i KPK-së është përshkrues, jo analitik dhe nuk i adreson problemet dhe sfidat me të cilat përballet sistemi prokurorial.

Në raport nuk shqyrtohen sfidat që kanë përcjellur sistemin prokurorial, e aq më pak adresimi i tyre. Përmenden raportet e NjShPP, por nuk tregohet se cilat kanë qenë sfidat e tyre në raporte dhe a janë adresuar ato problem nga KPK.

Sa i përket mos plotësimit të përbërjes së KPK-së me anëtarët jo-prokurorë, raporti i KPK-së mjaftohet duke treguar hapat procedural që janë ndërmarrë në këtë drejtim, duke mos dhënë një analizë të qartë se çfarë e ka penguar këtë proces, ku ka mbetur e papërfaqësuar në këtë institucion të rëndësishëm shoqëria civile.

IKD vlerëson se një raport i tillë, është i karakterit formal, dhe përmes tij nuk arrihet qëllimi i obligimit ligjor për të informuar publikun lidhur me veprimtarinë, efikasitetin, efektivitetin e sistemit prokurorial gjatë vitit 2018.

KPK sipas Ligjit për plotësim ndryshimin e Ligjit për KPK-në, ka përcaktuar obligimin e Këshillit për të raportuar para publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikator të matshëm çdo gjashtë (6) muaj. Një obligim i tillë nuk është përmbushur nga KPK.

Mungesa e përmbushjes së obligimeve të KPK-së, dëshmon mungesën e vullnetit në praktikë të Këshillit dhe Sekretariatit për të zbatuar ligjin, dhe për të gjenë llogaridhënës në raport me publikun. Mungesa e përmbushjes së obligimeve ligjore, forcon praktikën e instaluar të pandëshkueshmërisë së vet krerëve të KPK-së dhe personave përgjegjës në Sekretariat.

Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, as nuk i ka mohuar dhe as nuk i ka vërtetuar gjetjet e IKD-së lidhur me raportin vjetor të KPK-së. Në një intervistë përmes postës elektronike, Hyseni ka theksuar se në bazë të raporteve që miraton KPK, janë miratuar 9 rekomandime:

“Këshilli harton dhe miraton disa lloje të raporteve që rrjedhin nga fushë veprimtaria e tij. Këto raporte janë objekti i trajtimit nga komisionet e përhershme dhe të përkohshme të Këshillit, mirëpo siç edhe e dini, këto raporte miratohen në Këshill. Për njoftimin tuaj, si rezultat i analizës së këtyre raporteve, ka rezultuar miratimi i 9 rekomandimeve nga Këshilli me qëllim të ngritjes së efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e veprave penale, në veçanti, 9 grupeve të veprave penale karakteristike”¹⁸.

6.3. Vlerësimi i performancës së prokurorëve dhe masat disiplinore

Ligji për plotësim ndryshimin e Ligjit për KPK-në, në nenin 14/B, ka përcaktuar themelimin e Komisionit për vlerësimin e performancës së prokurorëve. KPK kishte planifikuar që gjatë vitit 2018 të bëjë vlerësimin e performancës për 67 prokurorë, të ndarë në pesë (5) grupe në kuadër të proceseve vlerësuese.

Gjatë vitit 2018 janë kryer tri (3) procese me nga 11 prokurorë (dmth. 33 prokurorë me mandat të përhershëm), një proces me 12 prokurorë si dhe një proces tjetër me 21 prokurorë me mandat fillestar. Sa i përket procesit të fundit, planifikimi ishte bërë që vlerësimi i performancës të bëhej për 22 prokurorë. Por, KPK në takimin e mbajtur më 24 dhjetor 2018, ka miratuar pjesërisht raportin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës. Sipas këtij vendimi, KPK ka miratuar raportin e këtij komisioni sa i përket 21 prokurorëve, përderisa e ka obliguar komisionin që të bëjë rivlerësimin e performancës për prokurorin Atnor Skoro¹⁹.

¹⁸ IKD intervistë përmes postës elektronike me z. Bahri Hyseni, Kryesuesi i KPK-së. 24 janar 2019.

¹⁹ Vendimi 2064/2018. Këshilli Prokurorial i Kosovës. 24 dhjetor 2018. (Shih linkun <http://kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/Vendimet%202018/Vendim%20Nr.2064.2018%20-%20Miratohet%20pjes%C3%ABrisht%20Raporti%20i%20Komisionit%20p%C3%ABr%20Vler%C3%ABsimin%20e%20Performanc%C3%ABs%20p%C3%ABr%20nj%C3%ABzet%20e%20nj%C3%AB%20prokuror%C3%AB%20t%C3%AB%20shtetit%20me%20mandat%20fillestar.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 25 janar 2019).

Pra, në total, vlerësimi i performancës është bërë për 67 prokurorë, për aq sa edhe ishte planifikuar të bëhet.

Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, deklaroi se KPK i ka dhënë prioritet këtij procesi. Sa i përket mungesës së procedurave disiplinore, Hyseni ka thënë se kjo nuk ka ndodhur për arsye se KPK nuk ka gjetur shkelje të asaj natyre për të inicuar procedurë disiplinore²⁰.

Lidhur me procedurat disiplinore për prokurorë gjatë vitit 2018, Komisioni Disiplinor i KPK-së ka pranuar gjashtë (6) raporte përfundimtare nga ZPD dhe një kërkesë për suspendim, ndërsa tri (3) raporte përfundimtare të ZPD-së kanë qenë të trashëguara nga viti 2017.

Gjatë vitit 2018, Komisioni Disiplinor i KPK-së ka shqiptuar masat e mëposhtme disiplinore:

Pushim i procedurave	2 vendime
Supendim pa pagesë	1 vendim
Ulje në detyrë mbrenda sistemit prokurorial	1 vendim
Qortim me urdhër për ndërrmarrje të veprimeve korigjuese	1 vendim
Qortim	1 vendim
Refuzim i Raportit Përfundimtar	1 vendim
Totali i vendimeve disiplinore	7 vendime

Sa i përket rasteve disiplinore, KPK si shkallë e dytë gjatë vitit 2018 ka pranuar tri (3) lëndë të reja, derisa ka zgjidhur 4 lëndë, në të cilat ka marrë këto vendime:

Pushim i procedurave	1 vendim
Aprovim i masës së qortimit	1 vendim
Refuzim i ankesës së ZPD-së	2 vendime ²¹
Totali i masave disiplinore	4 vendime

Në anën tjetër, ZPD për periudhën kohore nga data 1 janar deri më 30 nëntor 2018²², ndaj bartësve të funksioneve prokuroriale, ka pranuar 82 lëndë. ZPD, gjatë kësaj periudhe kohore, ka trajtuar 92 lëndë ndaj bartësve të funksioneve prokuroriale, ndërsa 57 lëndë janë refuzuar pas hetimit preliminar disiplinor. Pas zhvillimit të hetimeve disiplinore, ZPD ka dërguar gjashtë (6) lëndë për procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor të KPK-së.

Lëndë të trajtuara nga ZPD	Lëndë të dërguara në KD të KGJK-së	Lëndë të mbyllura pas hetimeve disiplinore	Lëndë të refuzuara pas hetimit preliminar
92	6	29	57

²⁰ IKD intervistë përmes postës elektronike me z. Bahri Hyseni, Kryesues i KPK-së. 24 janar 2019.

²¹ Në njërin nga këto dy raste, KPK si shkallë e dytë ka lënë në fuqi vendimin mbi refuzimin e raportit përfundimtar, ndërsa në rastin e dytë KPK si shkallë e dytë ka lënë në fuqi vendimin mbi shqiptimin e masës disiplinore "qortim".

²² IKD ka kërkuar qasje në statistika të ZPD-së edhe për muajin dhjetor të vitit 2018. ZPD nuk i ka dërguar të njëjtat, me arsyetimin se janë të zënë duke punuar në raportin vletor të ZPD-së për vitin 2018.

6.4. Raportimi i Kryeprokurorëve para KPK-së

KPK më 29 dhjetor 2015, ka miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Funksionimin e Prokurorit të Shtetit. Neni 9 i kësaj rregullore përcakton përgjegjësitë e Kryeprokurorëve në raport me KPK-në. Neni 9 pika 1.4 e kësaj rregullore obligon Kryeprokurorët që në baza tre mujore t'i dorëzojnë KPK-së raport me shkrim lidhur me punën e prokurorisë, vështirësitë dhe propozimin e masave lidhur me përmirësimin e performancës së prokurorisë.

IKD gjatë monitorimit të takimeve të KPK-së në vitin 2018, ka gjetur se në asnjë takim të KPK-së, nuk janë shqyrtuar apo diskutuar raportet e punës apo obligimet e Kryeprokurorëve para KPK-së.

Po ashtu ka munguar iniciativa e KPK-së, për të kërkuar apo ftuar Kryeprokurorët e Prokurorive për të raportuar para KPK-së, duke dështuar në përmbushjen e obligimeve ligjore për të siguruar llogaridhënie.

Mungesa e raportimit të kryeprokurorëve dhe mospërmbushja e obligimeve ligjore dëshmojnë në praktikë dështimin e plotë të Këshillit Prokurorial të Kosovës për të ushtruar kontroll dhe mbikqyrje në raport me Kryeprokurorët e Prokurorive përkatëse në menaxhimin dhe administrimin efikas të prokurorive, që në praktikë ndikon edhe në mungesën e rezultateve dhe në performance të dobët.

Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, deklaroi se ky obligim ligjor është përmbushur, pasi që kryeprokurorët kanë dërguar raportet e tyre periodike me shkrim.

“Në bazë të nenit 9, paragrafi 1.4 të Rregullores nr.11/2015 për organizimin e brendshëm dhe funksionin e Prokurorit të Shtetit, kryeprokurorët e prokurorive të Kosovës janë të obliguar që Këshillit t'i dorëzojnë raport me shkrim në baza tremujore. Ky raportim është realizuar në përputhje me këtë dispozitë të rregullores dhe çdo tre muaj të gjithë kryeprokurorët e prokurorive kanë dërguar në Këshillin Prokurorial të Kosovës raportet e tyre me shkrim për aktivitetet e tyre”²³.

IKD poashtu ka gjetur se KPK nuk e ka përmbushur obligimin e saj që të raportojë çdo gjashtë (6) muaj para publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuara në indikatorë të matshëm.

Sa i përket obligimit të KPK-së, Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, nuk ka dhënë një përgjigje konkrete. “Aktiviteti i Këshillit shtrihet jo vetëm në takimet e mbajtura para publikut, por edhe në komisionet e përhershme dhe të përkohshme të Këshilli dhe trupat e tjerë ndihmës, andaj zbatimi i objektivave të përcaktuara nga Këshilli është trajtuar në këto trupa, për më tepër në takimet e Këshilli ka raportuar Grupi Punues për monitorim dhe vlerësimin e zbatimit të Planit strategjik”.²⁴

²³ IKD intervistë përmes postës elektronike me z. Bahri Hyseni, Kryesues i KPK-së. 24 janar 2019.

²⁴ Po aty.

6.5. Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit prokurorial

KPK në vazhdimësi proklamoi ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me publikun dhe mediat. KPK ka miratuar rregullore dhe strategji për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien dhe për të lehtësuar bashkëpunimin me publikun dhe median.

IKD gjatë monitorimit të sistemit prokurorial, gjatë vitit 2018, ka adresuar në sistemin prokurorial 108 kërkesa për qasje në dokumente publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore, ofrimin të informacioneve, statistikave dhe të dhënave tjera të disponueshme dhe lejueshme sipas Ligjit mbi Qasje në Dokumente Publike.

Prej këtyre 108 kërkesave, IKD ma marrë përgjigje pozitive në 42 prej tyre, apo 37.86 %, në 55 prej tyre, apo 51.45%, IKD nuk ka marrë fare përgjigje, kurse në 11 kërkesa institucionet prokuroriale kanë refuzuar të japin të dhënat e kërkuara, apo në 10.67%.

Përkundër kësaj, përballë 128 vendimeve që KPK ka nxjerrë gjatë periudhë 1 janar 2018 – 30 nëntor 2018, KPK ka publikuar vetëm 23 prej apo 14.87%, përderisa numri i vendimeve të papublikuara në gjuhën serbe është ende më i madh.

Po ashtu, KPK nuk fton rregullisht mediat dhe shoqërinë civile në takimet e tyre të hapura. Në këtë drejtim, KPK nuk ka ftuar mediat dhe shoqërinë civile për takimin e 154-të të saj. Përkundër rëndësisë së pikave që janë shqyrtuar në këtë takim, KPK i ka mbajtur ato larg syve të publikut. Lidhur me këtë mosnjohim, KPK ishte arsyetuar se bëhej fjalë vetëm për një keqkuptim teknik. Pas takimit, KPK kishte lëshuar komunikatë për media nga ky takim.

Gjendja është edhe më shqetësuese sa i përket takimit 147 dhe 155. Për këto takime, KPK nuk i ka njoftuar as mediat dhe as shoqërinë civile, nuk e ka publikuar agjendën si dhe nuk ka lëshuar komunikatë për media nga këto takime. Për të gjitha këto, KPK nuk ka dhënë kurrfarë arsytimi për publikun.

Ngjarja më e diskutuar gjatë vitit 2018 sa i përket sistemit prokurorial ka qenë dorëheqja e ish-prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), Elez Blakaj. Përkundër rëndësisë që kishte kjo çështje për publikun, KPK në mbledhjen e 156-të të 7 shtatorit 2018 kishte vendosur që dorëheqjen e tij ta trajtojë me dyer të mbyllura, duke larguar mediat dhe shoqërinë civile nga mbledhja e KPK-së me rastin e diskutimit për dorëheqjen e Blakaj. Pas mbledhjes me dyer të mbyllura për këtë pikë, KPK nuk kishte treguar se cili ka qenë vendimi i KPK-së lidhur me dorëheqjen e Blakaj. Kryesuesi i KPK-së, Blerim Isufaj, kishte deklaruar se gjatë këtij takimi KPK vetëm ishte njoftuar për dorëheqjen e Blakaj, derisa në komunikatën për media të KPK-së nuk përmendej fare të jetë shqyrtuar kjo pikë. Pas kësaj, në një përgjigje zyrtare të KPK-së për IKD-në, është konfirmuar se gjatë kësaj mbledhjeje KPK kishte miratuar dorëheqjen e ish-prokurorit special Elez Blakaj, dhe se i ka propozuar Presidentit të Republikës së Kosovës nxjerrjen e dekretit për lirimin e tij nga detyra.

Më 14 qershor të këtij viti, KPK ka caktuar prokurorët kujdestar për komunikim me media. Në këtë drejtim, për secilën prokurori, është caktuar një prokuror përgjegjës për komunikim me media. IKD vlerëson se ky vendim është një hap pozitiv drejt rritjes së transparencës, për

shkak se një praktikë e tillë ka rezultuar e suksesshme, por prapë se prapë, ky vendim si i vetëm nuk është i mjaftueshëm për arritjen e transparencës së sistemit prokurorial.

Mos zbatimi i obligimeve ligjore dhe politikave të miratuara nga KPK, forcon gjetjet e IKD-së dhe vlerësimet e dala nga raporte ndërkombëtare dhe vendore lidhur me mungesën e vullnetit të sistemit prokurorial për të qenë transparent dhe llogaridhënës para publikut. Mos përmbushja e obligimeve dëshmon se ligji në Kosovë nuk zbatohet njëjtë ndaj të gjithëve. IKD vlerëson se në rastet kur zyrtarët e lartë nuk përmbushin obligimet dhe përgjegjësitë e tyre, kultura pandëshkueshmërisë vazhdon të kultivohet.

Përkundër faktit se në rastet kur IKD nuk ka marrë përgjigje apo nuk ka pasur qasje në dokumente publike të sistemit prokurorial, kërkesat për qasje në dokumente publike dhe informata i ka bërë në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike si dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, në një përgjigje përmes postës elektronike, ka thënë se mungesa e përgjigjeve nuk ka të bëjë me mostransparencë, por me kujdes ndaj mosdikimit në proceset hetimore. IKD sqaron nuk bëhet fjalë për kërkesa të IKD-së për raste të hetimeve konfidenciale, por për dokumente dhe informata që janë të qasshme sipas ligjit, por të cilat nuk janë ofruar nga KPK. Sa i përket mospublikimit të vendimeve të KPK-së, Kryesuesi i Këshillit Bahri Hyseni ka thënë se të gjitha vendimet që merren në takimet e KPK-së, janë publike:

“...Sa i përket mospublikimit të vendimeve të Këshillit, Këshilli në vazhdimësi kujdeset për publikimin e akteve të miratuara dhe nuk ka të bëjë me mostransparencë pasi siç e dini të gjitha vendimet e Këshillit merren në takimet publike ku të pranishëm janë përfaqësuesit e mediave dhe të shoqërisë civile, të cilët janë të interesuar t’i ndjekin takimet e Këshillit, për të cilat për çdo takim ju njoftojmë për kohën e mbajtjes së takimit”.²⁵

6.6. Avancimi dhe transferimi i Prokurorëve

KPK gjatë vitit 2018 ka avancuar në detyrë gjithsej 13 prokurorë:

1. Në PSRK janë avancuar 5 (pesë) prokuror dhe që të gjithë nga PTH Prishtinë;
2. Në PTH Mitrovicë janë avancuar 2 (dy) prokuror nga po kjo prokurori;
3. Në PTH Ferizaj janë avancuar 2 (dy) prokuror nga po kjo prokurori;
4. Në PTH Prishtinë është avancuar 1 (një) prokuror nga po kjo prokurori;
5. Në ZKPSH janë avancuar 3 (tre) prokuror, njëri nga Prokuroria e Apelit, njëri nga PTH Ferizaj dhe një nga PTH Gjilan.

Sa i përket transferimeve, KPK gjatë takimit të mbajtur më 23 shkurt 2018 ka marrë vendim që prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Burim Qerkini, të kalojë nga Departamenti për të Mitur në Departamentin për Krime të Rënda, Prokurorit Agron Qalaj t’i vazhdohet mandati edhe për gjashtë (6) muaj si prokuror në ZKPSH, prokurorja Habibe Salihu të transferohet në PSRK, Prokurori Veton Shabani nga Prokuroria Themelore në Ferizaj nga

²⁵ Po aty.

Departamenti i Përgjithshëm të transferohet në Departamentin e Krimeve të Rënda si dhe Prokurori Agim Kuka nga Departamenti i Përgjithshëm të transferohet në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore të Ferizajit. Të gjitha këto transferime janë bërë për periudhën kohore prej gjashtë (6) muajve.

Në takimin e 30 prillit 2018, KPK ka marrë vendim me anë të së cilit ka transferuar prokurorin Naim Abazi nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në Departamentin për Krime të Rënda të kësaj prokurorie.

Në takimin e mbajtur më 31 tetor 2018, KPK po ashtu ka transferuar prokurorët Shkelzen Ibrahimimi dhe Rafet Halimi nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Prishtinë në Departamentin e Krimeve të Rënda të kësaj prokurorie.

Si në rastin e KGJK-së, IKD vlerëson se kalimi i një prokurori nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda nuk mund të konsiderohet transferim, por avancim.

Ligji për Prokurorin e Shtetit përcakton kritere dhe kompensim të vecantë për Prokurorët e Krimeve të Rënda, për dallim nga Prokurorët e Departamentit të Përgjithshëm.

Për dallim nga Prokurorët e Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorive Themelore, Ligji për Prokurorin e Shtetit përcakton se për ta ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore, kandidati duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë juridike si prokuror apo gjyqtar, cka nuk thuhet për Prokurorët e Departamentit të Përgjithshëm.

Po ashtu, sa i përket kompensimi, Ligji për Prokurorin e Shtetit përcakton se secili prokuror me mandat të përhershëm në Prokurorinë Themelore pranon pagë jo më pak se shtatedhjetë përqind (70%) e pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore. Këshilli do të nxjerr skemën për **kompensime shitesë** që pasqyron përgjegjësitë e veçanta të prokurorit që paraqitet para Departamentit të Krimeve të Rënda pranë Gjykatës Themelore.

Për më tepër, avancimi i prokurorëve nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin e Krimeve të Rënda, bie në kundërshtim edhe me nenin 3 të Rregullores për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, e cila i përcakton parimet themelore mbi të cilat duhet të udhëhiqet KPK gjatë procesit të transferimit dhe avancimit të prokurorëve.

Ky nen përcakton se zhvillimi në karrierë i prokurorëve, avancimi dhe transferimi i tyre duhet të bazohet në kritere objektive siç janë: aftësitë profesionale, merita dhe përvoja profesionale, si dhe zhvillimi në karrierë, avancimi dhe transferimi duhet të bazohen vetëm sipas ligjit dhe kësaj rregullore dhe me pëlqimin e prokurorëve.

IKD në dhjetor të vitit 2016 kishte publikuar analizën “Vendimet e kundërligjshme të KPK-së dhe praktikat e këqija të ndryshimit të Rregulloreve nga KGJK”²⁶, përmes së cilës

²⁶ “Vendimet e kundërligjshme të KPK-së dhe praktikat e këqija të ndryshimit të rregulloreve nga KGJK”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 12 dhjetor 2016. (Shih linkun <https://kli-ks.org/vendimet-e-kunderligjshme-te-kpk-se-dhe-praktikat-e-keqija-te-ndryshimit-te-rregulloreve-nga-kgjk/>)

dëshmohej se KPK ka shkelur Ligjin dhe Rregulloret e miratuara nga vetë KPK me rastin e avancimit të Prokurorit Abdurrahim Islami nga Prokuroria Themelore e Prishtinës në PSRK.

Mbi bazën e këtyre të gjeturave, IKD konsideron se KPK duhet ta ketë parasysh që mos të ngatërrohen “avancimi” me “transferimin”, për faktin e vetëm se ky i fundit është me afat të caktuar kohor. KPK duhet të sigurohet që transferimi të bëhet brenda nivelit të njëjtë të prokurorisë, dhe ta kuptojë qartë se për të kaluar nga një departament më i ulët në një departament më të lartë, duhet të respektohet instituti i konkursit.

Poashtu, IKD në shkurt të vitit 2017 kishte publikuar analizën “Vendimet e kundërligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK-së për transferimin e prokurorëve në PSRK”, ku ishte vënë në pah se KPK edhe në rastin e Prokurorit Sylë Hoxha, vkishte vepruar sikurse në rastin e Prokurorit Abdurrahim Islami²⁷.

6.7. Monitorimi i takimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës

KPK nga 1 janar 2018 deri më 30 nëntor 2018 ka mbajtur gjithsej 14 takime, që në përgjithësi rezultojnë se ka mbajtur afërsisht 1.2 takime në muaj.

6.8. Diskutimet e anëtarëve të KPK-së gjatë miratimit të politikave/publikimi i vendimeve

IKD ka monitoruar në detaje të gjitha takimet e KPK-së, përfshirë pjesëmarrjen në diskutim nga të gjithë anëtarët e Këshillit. Gjetjet tregojnë se mungesa e demokracisë është ende e pranishme në KPK. Nga 128 vendimet e KPK-së që janë marrë gjatë periudhës 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2018, shumica dërrmuese e tyre janë marrë në mënyrë unanime. Sa i përket diskutimit të anëtarëve të KPK-së, gjetjet janë të njëjta si në raportet paraprake. Siç do të shihet më poshtë, në mesin e anëtarëve të KPK-së, ka anëtarë kontributi i të cilëve në diskutim në KPK gjatë marrjes së vendimeve të rëndësishme ka qenë zero. Më konkretisht, në takimet e KPK-së, publiku asnjëherë nuk e ka dëgjuar zërin e tyre. IKD shpreh shqetësim të thellë me këtë qasje dhe mungesë kontributi nga anëtarët e Këshillit, të cilët po dëshmojnë si mekanizëm që ngajnë në makina të votimit, të cilat drejtohen nga Kryesuesi i KPK-së dhe Kryeprokurori i Shtetit. Në tabelën në vazhdim është paraqitur kontributi apo moskontributi i diskutimit të secilit anëtar në secilën mbledhje të monitoruar nga IKD.

Sidoqoftë, Kryesuesi i KPK-së, vlerëson se anëtarët që nuk diskutojnë në takimet e KPK-së, kontributin e tyre e japin në komisionet e KPK-së.

“Edhe një herë po ritheksoj se kontributi i anëtarëve të Këshillit nuk është në takimet e Këshillit, por në komisionet dhe trupat ndihmës. Andaj për anëtarët që ju keni përmendur iu njoftoj se prokurori Haxhi Sinanaj është anëtar i Komisionit Disiplinor dhe anëtar në disa komisione të përkohshme. Në këto komisione angazhimi i prokurorit Sinanaj është shumë i rëndësishëm. Prokurorja Dëshirë Jusaj është anëtare e Komisionit për Çështje Normative dhe po ashtu angazhohet në komisionet e tjera të Këshillit, ndërsa prokurorja Bedrije Alshiqi

²⁷ “Vendimet e kundërligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK-së për transferimin e prokurorëve në PSRK”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 07 shkurt 2016. (shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/1.-Analize-e-shkurte-Vendimet-e-kunderligjshme-te-KPSH-dhe-KPK-07.02.2017-2.pdf>)

është anëtare e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, komision ky, që ka aktivitet pothuajse çdo ditë. Sa i përket mënyrës së marrjes së vendimeve, ju njoftoj se çdo pikë e rendit trajtohet në komisionet e Këshillit, me ç’rast anëtarët e Këshillit japin kontributin e tyre”.²⁸

Monitorimi i diskutimeve të anëtarëve të KPK-së në mbledhjet e KPK-së në vitin 2018

Anëtarët e KPK	Mbledhjet e monitoruara të Këshilli Prokurorial të Kosovës në vitin 2018									
	23 shkurt	27 mars	30 prill	30 maj	14 qershor	7 shtator	31 tetor	27 nëntor	24 dhjetor	Total
1.Blerim Isufaj	6 min, 1 sek	7 min, 7 sek	4 min, 56 sek	7 min, 54 sek	8 min, 58 sek	12 min, 19 sek	7 min, 41 sek	10 min, 49 sek	8 min, 5 sek	1 orë, 14 min, 34 sek
2.Aleksandër Lumezi	3 min, 42 sek	Pasiv	Pasiv	25 min, 15 sek	Pasiv	10 min, 15 sek	7 min, 9 sek	Pasiv	10 min, 1 sek	56 min, 22 sek
3.Bahri Hyseni	13 min, 6 sek	5 min, 18 sek	10 min, 9 sek	15 min, 15 sek	15 min, 7 sek	11 min, 30 sek	9 min, 52 sek	4 min, 29 sek	13 min, 35 sek	1 orë, 38 min, 21 sek
4.Bedrije Alshiqi	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	3 min, 47 sek	Pasiv	Pasiv	Pasiv	3 min
5.Haxhi Sinanaj	Mungon	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv
6.Dëshirë Jusaj	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv
7.Arben Ismajli	3 min, 30 sek	Mungon	Pasiv	55 sek	Pasiv	3 min, 16 sek	1 min, 54 sek	Pasiv	Pasiv	9 min, 35 sek
8.Zejnullah Gashi	1 min, 10 sek	4 min, 40 sek	Pasiv	17 sek	9 min, 20 sek	3 min, 20 sek	Pasiv	Pasiv	38 sek	19 min, 25 sek
9.Ikramije Bojaxhiu	7 min, 7 sek	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Pasiv	Mungon	3 min, 59 sek	Pasiv	Pasiv	11 min, 6 sek
10.Radica Miliq	14 min, 11 sek	Pasiv	Pasiv	12 sek	2 min	6 min	Pasiv	1 min	Pasiv	23 min, 23 sek

Në vazhdim janë paraqitur të gjitha mbledhjet, në të cilët përfshihen vendimet e marra:

- **KPK takimin e parë në vitin 2018, e ka mbajtur më 29 janar 2018 apo mbledhjen e 146-të.** Në fillim të këtij takimi anëtarja e re e KPK-së nga radhët e Prokurorisë së Apelit, Bedrije Alshiqi, ka dhënë betimin si anëtare e KPK-së. Po ashtu, KPK gjatë kësaj mbledhje ka shpallur konkurs për pesë (5) pozita në PSRK si dhe ka miratuar udhëzimin administrativ për caktimin e normës orientuese për Prokurorët e Shtetit. Asnjë vendim nga kjo mbledhje nuk është publikuar.
- **KPK takimin e dytë në vitin 2018 apo mbledhjen e 147-të, e ka mbajtur me dyer të mbyllura, dhe për këtë takim nuk është bërë publike agenda.** Asnjë vendim nga kjo mbledhje nuk është publikuar.

²⁸ IKD intervistë përmes postës elektronike me z. Bahri Hyseni, Kryesues i KPK-së. 24 janar 2019.

- KPK takimin e tretë në vitin 2018, e ka mbajtur më 23 shkurt 2018 apo mbledhjen e 148-të.** KPK gjatë këtij takimi ka miratuar raportet e Komisioneve të Përhershme të KPK-së, raportin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike për periudhën shtator-dhjetor 2017, raportin vjetor për vitin 2017 të Komisionit mbikëqyrës për zbatimin e planit strategjik dhe të veprimit në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike si dhe raportin për vitin 2017 të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për harmonizimin e statistikave për veprat penale karakteristike. KPK gjatë këtij takimi ka marrë vendim që prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Burim Qerkini, të kaloj nga Departamenti për të Mitur në Departamentin për Krime të Rënda, Prokurorit Agron Qalaj t'i vazhdohet mandati edhe për gjashtë (6) muaj si prokuror në ZKPSH, prokurorja Habibe Salihu të transferohet në PSRK, Prokurori Veton Shabani nga Prokuroria Themelore në Ferizaj nga Departamenti i Përgjithshëm të transferohet në Departamentin e Krimeve të Rënda si dhe Prokurori Agim Kuka nga Departamenti i Përgjithshëm të transferohet në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore të Ferizajit. Të gjitha këto transferime janë bërë për periudhën kohore prej gjashtë (6) muajve. KPK në këtë takim ka shpallur konkurs për avancim në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, për Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Prishtinë dhe Ferizaj. Po ashtu, KPK gjatë këtij takimi ka miratuar propozimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Imer Beka, për caktimin e udhëheqësve të departamenteve, ku si udhëheqës i Departamentit për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore të Prishtinës është caktuar prokurori Kujtim Munishi, Prokurori Ruhan Salihu është caktuar udhëheqës i Departamentit për të Mitur, ndërsa prokurori Fatmir Behrami është caktuar udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm.

Asnjë vendim nga kjo mbledhje nuk është publikuar.
- KPK takimin e katërt në vitin 2018, e ka mbajtur më 27 mars 2018 apo mbledhjen e 149-të.** Gjatë këtij takimi, raportet për vitin 2017 i kanë paraqitur Drejtori i SKPK-së, Lavdim Krasniqi, dhe kryesuesi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Zejnullah Gashi. Po ashtu, në këtë takim KPK ka hapur edhe konkurs për përzgjedhjen e drejtorit të NjShPP.

Asnjë vendim nga kjo mbledhje nuk është publikuar.
- KPK takimin e gjashtë në vitin 2018, e ka mbajtur më 30 prill 2018 apo mbledhjen e 150-të.** Gjatë këtij takimi KPK ka miratuar rregulloren për shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në sistemin prokurorial si dhe ka transferuar për afat gjashtë (6) muaj prokurorin Naim Abazi nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore të Prishtinës.

Nga ky takim, janë publikuar vetëm katër (4) vendime.
- KPK takimin e shtatë në vitin 2018, e ka mbajtur më 4 maj 2018 apo mbledhjen e 151-të.** Në këtë mbledhje si pikë e rendit të ditës ka qenë vetëm shqyrtimi i një rasti nga Komisioni Disiplinor, si dhe mbledhja është mbajtur e mbyllur.

Asnjë vendim nga kjo mbledhje nuk është publikuar.

- **KPK takimin e shtatë në vitin 2018, e ka mbajtur më 30 maj 2018 apo mbledhjen e 152-të.** Gjatë këtij takimi, para anëtarëve të KPK-së është prezantuar raporti i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike për periudhën janar-mars 2018, raporti lidhur me mbikëqyrjen e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike si dhe raporti i mekanizmit përcjellës ndër-institucional për harmonizimin e statistikave për veprat penale karakteristike, raporte të cilat janë miratuar nga anëtarët e KPK-së. Gjatë këtij takimi, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka prezantuar raportin e Prokurorit të Shtetit për vitin 2017. Në këtë takim KPK ka marrë vendim për shpalljen e konkursit për 5 pozita në PSRK.
Nga ky takim, janë publikuar vetëm katër (4) vendime.
- **KPK takimin e tetë në vitin 2018, e ka mbajtur më 14 qershor 2018 apo mbledhjen e 153-të.** KPK gjatë këtij takimi ka caktuar prokurorët përgjegjës për komunikim me media, ka zgjedhur Valon Jupën drejtor të NjShPP si dhe ka miratuar kërkesën buxhetore për vitin 2019, të cilën kërkesë paraprakisht e ka prezantuar kryesuesi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Zejnullah Gashi.
Nga ky takim, janë publikuar vetëm katër (4) vendime.
- **KPK takimin e nëntë në vitin 2018, e ka mbajtur më 26 korrik 2018, apo mbledhjen e 154-të.** KPK e ka mbajtur me dyer të mbyllura këtë takim, si dhe nuk është bërë publike agjenda. Në një përgjigje për IKD nga KPK është thënë se arsyeja pse nuk janë ftuar mediat në këtë takim ka qenë për shkak të një keqkuptimi dhe gabimi teknik. Gjatë këtij takimi KPK ka miratuar udhëzimin administrativ për menaxhimin e pasurisë jo financiare të KPK-së si udhëzimin administrativ për përdorimin e automjeteve zyrtare të sistemit prokurorial. Në këtë takim është miratuar edhe raporti i komisionit për vlerësimin e performancës, sipas të cilit, 11 prokurorëve i është bërë vlerësimi i performancës. Në fund të këtij takimi ka raportuar edhe grupi për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të planit strategjik për periudhën janar-qershor 2018.
Nga ky takim, janë publikuar vetëm dy (2) vendime.
- **KPK takimin e dhjetë në vitin 2018 apo mbledhjen e 155-të, e ka mbajtur me dyer të mbyllura, dhe për këtë takim nuk është bërë publike agjenda.**
Asnjë vendim nga kjo mbledhje nuk është publikuar
- **KPK takimin e njëmbëdhjetë në vitin 2018, e ka mbajtur më 7 shtator 2018 apo mbledhjen e 156-të.** KPK gjatë këtij takimi ka miratuar dorëheqjen e ish-prokurorit të PSRK, Elez Blakaj, për të cilën pikë diskutimet janë mbajtur me dyer të mbyllura. KPK gjatë këtij takimi ka bërë shqyrtimin dhe miratimin i Raportit të Komisionit Mbikëqyrës për zbatimin e Planit strategjik për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike për periudhën janar-qershor 2018, ka miratuar raportet nga komisionet e përhershme të Këshillit për periudhën janar – qershor 2018, si dhe ka bërë shqyrtimin e Raportit për vlerësimin e dytë të performancës së 12 prokurorëve me mandat fillestar. Po ashtu, gjatë këtij takimi KPK ka shpallur konkurs për rekrutimin e 10 prokurorëve të rinjë si dhe ka shpallur konkurs për përzgjedhjen e anëtarit të KPK-së nga radhët e shoqërisë civile.

Asnjë vendim nga kjo mbledhje nuk është publikuar

- **KPK takimin e dymbëdhjetë në vitin 2018, e ka mbajtur më 31 tetor 2018, apo takimin e 157-të.** Gjatë këtij takimi, para anëtarëve të KPK-së ka raportuar Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike për periudhën Prill-Qershor 2018. KPK këtë takim ka transferuar dy (2) prokurorë nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore të Prishtinës si dhe ka miratuar raportin e komisionit për vlerësimin e performancës për vlerësimin e performancës së 12 prokurorëve. Në këtë takim, është shqyrtuar raporti i komisionit për shqyrtimin e përshtatshmërisë së kandidatëve që janë nominuar nga radhët e shoqërisë civile për anëtarë të KPK-së. Nga raporti u bë e ditur se nga tre (3) kandidatët që kanë aplikuar, vetëm dy (2) prej tyre plotësojnë kriteret, dhe për këtë arsye konkursi për zgjedhjen e anëtarit të KPK-së nga radhët e shoqërisë civile ka dështuar për herë të tretë.

Nga ky takim, janë publikuar vetëm katër (4) vendime.

- **KPK takimin e trembëdhjetë në vitin 2018, e ka mbajtur më 27 nëntor 2018, apo takimin e 158-të.** Gjatë këtij takimi, drejtori i SKPK-së, Lavdim Krasniqi, para anëtarëve të KPK ka paraqitur raportin e mekanizmit përcjellës ndër-institucional për harmonizimin e statistikave për veprat penale karakteristike, për periudhën janar-shtator 2018. KPK gjatë këtij takimi ka shpallur konkurs të brendshëm për një prokurorë në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore të Pejës, ndërsa kryesuesi Blerim Isufaj ka njoftuar anëtarët e KPK-së lidhur me memorandumet e nënshkruara si dhe ka njoftuar rreth rrjedhave të zbatimit të sistemit elektronik për menaxhimin e lëndëve.

Asnjë vendim nga kjo mbledhje nuk është publikuar.

- **KPK takimin e katërbëdhjetë në vitin 2018, e ka mbajtur më 24 dhjetor 2018, apo takimin e 159-të.** Gjatë këtij takimi është hapur thirrja për nominime për kryesues të ri të KPK-së, ka raportuar Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu, për periudhën korrik-shtator 2018, është miratuar Kodi i Etikës për prokurorë si dhe nga Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, Haxhi Dërguti, është prezantuar raporti i Komisionit Mbikëqyrës për Zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike për periudhën janar-shtator 2018.

Nga shtatë (7) vendimet e marra në këtë takim, pesë (5) prej tyre janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KPK-së.

7. Gjetjet e veçanta të monitorimit të IKD-së për KGJK dhe KPK

IKD në këtë pjesë të raportit paraqet gjetjet e veçanta të monitorimit sistematik për KGJK-në dhe KPK-në, të cilat janë përshkruar gjatë vitit 2018. Për të gjitha këto gjetje të veçanta, IKD ka raportuar në baza të rregullta për publikun përmes portalit “Betimi për Drejtësi” si dhe përmes publikimit të reagimeve të shpejta në formë të komunikatave për media.²⁹ Në vazhdim gjetjet e veçanta janë ndarë në çështje, brenda të cilave janë elaboruar raste specifike të cilat përbëjnë shqetësim për transparencën, menaxhimin joadekuat, shkeljet ligjore dhe llogaridhënien brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

7.1. Ndikimet politike në sistemin prokurorial

Një prej problemeve më shqetësuese në sistemin e drejtësisë në Kosovë vazhdon të mbetet ndërhyrja politike dhe ndikimet e grupeve të interesit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. IKD tashmë një dekadë, vazhdimisht ngritë zërin për pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe prokurorial, për të cilat ka ofruar gjetje, vlerësime dhe rekomandime se si të adresohet zgjidhja e këtij problem. Në vazhdim janë ngritur disa prej çështjeve problematike që ndërlikohen drejtpërdrejtë me ndërhyrjet politike, ndërhyrjet e ekzekutivit si dhe ndërhyrjet e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, në pavarësinë individuale të prokurorëve dhe sistemit prokurorial e gjyqësor.

7.1.1. Ndërhyrjet politike dhe të Kryeprokurorit në rastin e veteranëve dhe prontos

Prokurori i Shtetit, sipas Kushtetutës ka përgjegjësi ligjore për ndjekjen e personave që dyshohen se kanë kryer vepra penale. Ky është organi që ka mandatin kryesor në luftimin e kriminalitetit, në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të drejtë³⁰.

Elez Blakaj, prokuror në PSRK, më 13 gusht 2018 kishte ofruar dorëheqje nga pozita³¹. Ndërsa, më 16 gusht 2018, përmes një letre të postuar në rrjetin social “Facebook”, kishte informuar opinionin publik se më 11 korrik 2018, kishte dorëzuar aktakuzën për rastin e njohur si “Veteranët”, në zyrën e Kryeprokurorit të PSRK-së, Reshat Millaku³².

Pas letrës së parë, pati reagime të shumta, nga të cilat edhe akuza kundrejt personalitetit dhe profesionalizmit të prokurorit Blakaj, të cilat e shtynë atë që të paraqesë edhe një letër tjetër, më 20 gusht 2018, duke u paraqitur edhe në rolin e sinjalizuesit. Prokurori Blakaj, kësaj

²⁹ *Shënim*: IKD si rezultat i monitorimit sistematik të KGJK-së dhe KPK-së dhe në përgjithësi të sistemit të drejtësisë, institucioneve dhe agjencioneve që e zbatojnë ligjin, përgatitë raporte ditore, të cilat i publikon në portalin e specializuar për fushën e sundimit të ligjit “Betimi për Drejtësi” (www.betimiperdrejtesi.com) si dhe në uebfaqen e organizatës publikon reagime të shpejta përmes formës së komunikatave për media (www.kli-ks.org). Të gjitha raportimet për KGJK dhe KPK janë të qasshme në këto dy dritare të informimit për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

³⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 109

³¹ “Për shkak të kërcënimeve jep dorëheqje prokurori special, Elez Blakaj”. Koha.net. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/111200/per-shkak-te-kercenimeve-jep-doreheqje-prokurori-special-elez-blakaj/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

³² “Prokurori special Elez Blakaj, në dorëheqjen e tij, konfirmon se nga 11 korriku aktakuzën e ngritur ia ka dorëzuar Kryeprokurorit special, Reshat Millaku”. Betimi për Drejtësi. 16 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-special-elez-blakaj-ne-doreheqjen-e-tij-konfirmon-se-nga-11-korrikuaktakuzen-e-ngritur-ia-ka-dorezuar-kryeprokurorit-special-reshat-millaku/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

radhe, në publik paraqiti kërcënimet dhe presionet që kishte pasur që nga koha kur kishte filluar trajtimin e rastit të “Veteranëve”³³.

Blakaj, në një intervistë për “Betimi për Drejtësi”, kishte deklaruar se në çdo hetim të profilit të lartë, Kryeprokurori Aleksandër Lumezi, kërkonte sqarime, madje edhe kur personat e profilit të lartë ftoheshin thjesht në cilësi të dëshmitarëve³⁴. Dorëheqja e Blakajt dhe arsyet e kësaj dorëheqjeje shkaktuan reagime të shumta në publik, përfshirë reagime nga shoqëria civile, institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare.

IKD konsideron se dorëheqja e prokurorit Blakaj, ka dëshmuar për gjendjen e sigurisë dhe të funksionimit të sistemit prokurorial, në të cilin ndikojnë politika dhe grupet e interesit, që pamundësojnë hetime të pavarura³⁵.

Ambasada Amerikane në Kosovë, e kishte vlerësuar si dekurajuese dorëheqjen e Blakajt³⁶. Ambasadori Amerikan në Kosovë, Greg Delaëie, e kishte quajtur të trishtë ditën kur prokurori Blakaj kishte dhënë dorëheqje³⁷. Njëkohësisht, Delaëie, në një ligjëratë para studentëve të Fakultetit Juridik, kishte thënë se në rastin e “Veteranëve”, të cilin e kishte hetuar Blakaj, kishte pasur kërcënime si nga brenda sistemit të drejtësisë, ashtu edhe jashtë tij³⁸.

Edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, kishte shprehur shqetësimin e saj për ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë pas dorëheqjes së Blakajt. “Deklaratat e disa politikanëve dhe prokurorëve në Kosovë rrezikojnë parimet kryesore të sundimit të ligjit. Për më tepër, ato dërgojnë sinjale dekurajuese tek të gjithë zyrtarët ligjorë që trajtojnë lëndë të ndjeshme dhe të rëndësishme”³⁹.

³³ “Flet Elez Blakaj, thotë se kishte kërcënime nga veteranët, përmend presionin e Kryeprokurori Aleksandër Lumezi për veteranët e UÇK-së dhe rastin “Pronto”. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2018. <https://betimiperdrejtesi.com/fletelez-blakaj-thote-se-kishte-kercenime-nga-veteranet-permend-presionin-e-kryeprokurori-aleksander-lumezi-perveteranet-e-uck-se-dhe-rastin-pronto/> . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

³⁴ “Çfarë thotë Blakaj për kërcënimet nga Kryeprokurori Lumezi, Kryeministri Haradinaj dhe të tjerët? (Video)”. Betimi për Drejtësi. 12 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/cfare-thote-blakaj-per-kercenimetnga-kryeprokurori-lumezi-kryeministri-haradinaj-dhe-te-tjere-video/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

³⁵ “Ndërhyrjet politike në sistemin e politizuar prokurorial, alarm për nevojën e vetingut në polici, prokurori dhe gjykata”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 30 gusht 2018. Faqe 4 (Shih linkun <http://kli-ks.org/nderhyrjet-politike-nesistemin-e-politizuar-prokurorial-alarm-per-nevojen-e-vetingut-ne-polici-prokurori-dhe-gjykata/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

³⁶ “Ambasada amerikane për dorëheqjen e Prokurorit Special: Rast shumë dekurajues”. KlanKosova.tv. 15 gusht 2018. (Shih linkun <http://klankosova.tv/ambasada-amerikane-per-doreheqjen-e-prokurorit-special-rast-shumedekurajues/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

³⁷ “Reagimi i Ambasadorit Amerikan Greg Delaëie në rrjetin social Facebook”. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.facebook.com/kosovo.usembassy/posts/2663396183686520>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

³⁸ “Ambasadori amerikan thotë se UÇK-ja s’kishte më shumë se 15 mijë ushtarë, thotë se pati presion dhe frikësim ndaj prokurorit Blakaj”. Betimi për Drejtësi. 31 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ambasadoriamerikan-thote-se-uck-ja-skishte-me-shume-se-15-mije-usthare-thote-se-pati-presion-dhe-frikesim-ndaj-prokuroritblakaj/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

³⁹ “Reagimi i Zyrës së BE-së në Prishtinë për rastin Blakaj”. 22 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.facebook.com/610960288923231/posts/statement-by-the-eu-office-in-kosovoeu-specialrepresentativethe-eu-is-closely-f/2059258884093357/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

KPK më 22 gusht 2018, përmes një komunikate për media kishte deklaruar se ky institucion është duke u angazhuar që Prokurori i Shtetit të veprojë si i pavarur dhe i paanshëm. Në këtë komunikatë KPK, edhe pse i thirrur për të mbrojtur dhe siguruar pavarësinë e sistemit prokurorial, kishte thënë po ashtu se ky organ nuk do të ketë kompromise për asnjë prokuror në rast të dështimit të kryerjes së detyrave të tyre⁴⁰.

Shoqata e prokurorëve, e udhëhequr nga Kryeprokurori i PA, Haxhi Dërguti, e cila është e thirrur që të mbrojë interesat e prokurorëve, nuk i doli në mbrojtje prokurorit Blakaj, përkundrazi. “Deri më tani, asnjë prokuror i sistemit prokurorial të Kosovës, duke përfshirë dhe ish-prokurorin Blakaj, nuk ka shprehur asnjë shqetësim, qoftë si kërcënim apo si ndikim në punën e tij të pavarur dhe të paanshme nga kushdo qoftë. Andaj, deklaratimet publike për kinse kërcënime dhe ndikime brenda sistemit prokurorial, janë për të mbuluar interesat e tij personale apo të kujtdo tjetër”, thuhej në këtë reagim⁴¹.

Edhe ZKPSH, kishte theksuar se kjo Zyrë, asnjëherë nuk kishte marrë informacione se prokurori Blakaj, ishte kërcënuar ndonjëherë lidhur me rastin e “Veteranëve”⁴². Për më tepër, Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi, në një intervistë për portalin “Gazeta Express”, e kishte quajtur Blakajn, prokuror joprofesional, frikacak, të dështuar dhe prokuror të profileve të ulëta⁴³. Deklarata e tillë, e Kryeprokurorit Lumezi, ishte kontradiktore, për faktin se disa ditë më herët i njëjti kishte dhënë vlerësime pozitive për Prokurorin Blakaj, duke thënë se ai “nuk është tërhequr për shkak të kanosjes, sepse ka qenë prokuror i vendosur dhe i pa korruptuar dhe i guximshëm.”⁴⁴ Pra, pasi Blakaj tregoi arsyet e dorëheqjes, ndryshoi edhe qëndrimi i Lumezit.

Gjuhë ofenduese përdori edhe Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj. Ai në një intervistë për emisionin “Interaktiv”, ish-Prokurorin Blakaj, e ka quajtur “hajn të pulave dhe pishpirik”. Po ashtu, kishte thënë se “një i ikur në Bllacë e Stankovec, nuk mund të vlerësojë numrin e saktë të veteranëve”, për të cilin Blakaj, kishte zhvilluar hetime intensive për disa muaj⁴⁵.

Në intervistën e Blakajt dhënë për “Betimi për Drejtësi”, përpos tjerash, ai kishte thënë se mënyra e bashkëpunimit të Haradinajt me prokurorinë ka qenë e papranueshme, pasi sipas tij,

⁴⁰ “KPK e diskuton me dyer të mbyllura dorëheqjen e ish-prokurorit të PSRK-së, Elez Blakaj”. Betimi për Drejtësi. 7 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kpk-e-diskuton-me-dyer-te-mbyllura-doreheqjen-e-ishprokurorit-te-psrk-se-elez-blakaj/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁴¹ “Shoqata e Prokurorëve: Blakaj s’ka shprehur asnjë kërcënim”. Evropaelire.org. 23 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.evropaelire.org/a/29449560.html>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁴² “Kryeprokurori i Shtetit tregon për kërcënime ndaj prokurorit të dorëhequr, Elez Blakaj”. Koha.net. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/111282/kryeprokurori-i-shtetit-tregon-per-kercenimet-ndajprokurorit-te-dorehequr-elez-blakaj/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁴³ “Ekskluzive, flet Aleksandër Lumezi: Elez Blakaj është frikacak, prokuror i dështuar dhe joprofesional”. Gazetaexpress.com. 20 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/ekskluzive-flet-aleksanderlumezi-elez-blakaj-eshte-frikacak-prokuror-i-deshtuar-dhe-joprofesional-568679/?archive=1>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁴⁴ “Ende pa nisur hetimet, Lumezi thotë se Blakaj nuk iku nga kërcënime”. Gazetaexpress.com. 16 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/ende-pa-nisur-hetimet-lumezi-thote-se-blakaj-nuk-iku-ngakercenimet-567639/?archive=1>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁴⁵ “Haradinaj e quan Blakajn hajn e pishpirik - “s’mund të vlerësojë veteranët i ikuri në Bllacë”. Koha.net. 21 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/video/112385/haradinaj-e-quan-blakajn-hajn-e-pishpirik-smund-tevleresoje-veteranet-i-ikuri-ne-bllace/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

kërkesa që prokurori t'i raportojë kryeministrit lidhur me hetimet, është në kundërshtim me rregullimin kushtetues të Kosovës, që bën ndarjen e pushteteve⁴⁶.

Fryma e kërcënimeve ndaj Blakajt kishte shkuar shumë larg. Kështu, deputeti i AAK-së, Shkumbin Demalijaj, në një intervistë në televizion publik RTK, e kishte quajtur Blakajn “kriminel”, “dezertor”, “hajn”, “idiot” e “rrugaç”. Ai kishte thënë se nëse shteti nuk e ndjek Blakajn në Kosovë për ta gjykuar, sipas tij për “shantazhin” që i ka bërë opinionit, atëherë ai do ta ndjek privatisht⁴⁷.

Edhe përkundër deklaratave të tilla, Prokurori i Shtetit nuk e kishte parë të arsyeshme t'i hetojë akuzat publike të deputetit Demaliaj ndaj prokurorit Blakaj. Vetëm pas reagimit të shoqërisë civile dhe me 11 ditë vonesë, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte vendosur të reagojë. Sipas kërkesës së kësaj prokurorie, pas seancës dëgjimore të 28 shtatorit 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë i kishte caktuar 30 ditë paraburgim Demalijajt⁴⁸. Pas ankesës ndaj këtij vendimi, Gjykata e Apelit, më 4 tetor 2018, masën e paraburgimit ia kishte zëvendësuar me arrest shtëpiak⁴⁹. Aktakuza e veteranëve më pas është ngritur edhe formalisht në Gjykatë nga Prokurori Special Afrim Shefkriu.

Më pas, kjo aktakuzë i ishte kthyer PSRK-së për përmirësim dhe qartësim⁵⁰. Aktakuzën e plotësuar, PSRK e kishte dërguar në Gjykatë me 7 dhjetor 2018⁵¹.

7.1.2. Trajtimi i KGJK-së dhe KPK-së si “departamente” të MD-së

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, në emër të bashkëpunimit që ka me KGJK dhe KPK, ka tejkalluar autorizimet e tij në takimet që ka zhvilluar me të dy këshillat. Për më tepër, Ministri Tahiri ka prezantuar edhe në një takim të mbyllur mes KGJK-së dhe KPK-së, trajtim i cili tanimë është sqaruar në faqet e mëposhtme të këtij raporti.

Në takimet me punëtorët e administratës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial, kur këta të fundit kishin hyrë në grevë, kishte qenë prezent Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, se

⁴⁶ “Si ndërhyri Kryeministri Haradinaj në hetimet e prokurorit Elez Blakaj? (Video)”. Betimi për Drejtësi. 12 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/si-nderhyri-kryeministri-haradinaj-ne-hetimet-e-prokuroritelez-blakaj-video/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁴⁷ “Demaliaj kërcënon Elez Blakajn: Ai është dezertor, hajn, idiot, rrugaç..., do të merrem privatisht me të”. Telegrafi.com. 17 shtator 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/demaliaj-sulmon-rende-elez-blakajn-ai-eshtedezertor-hajn-idiot-rrugac-do-te-merrem-privatisht-me-te/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁴⁸ “Një muaj paraburgim edhe ndaj deputetit Shkumbin Demalijaj”. Betimi për Drejtësi. 28 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nje-muaj-paraburgim-edhe-ndaj-deputetit-shkumbin-demalijaj/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁴⁹ “Deputeti Shkumbin Demalijaj lirohet nga paraburgimi, i caktohet masa e arrestit shtëpiak”. Betimi për Drejtësi. 4 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-shkumbin-demalijaj-lirohet-nga-paraburgimi-icaktohet-masa-e-arrestit-shtepiak/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁵⁰ “Aktakuza e veteranëve i kthehet Prokurorisë Speciale për përmirësim dhe qartësim”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktakuza-e-veteraneve-i-kthehet-prokurorise-speciale-per-pemiresim-dhe-qartesim/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁵¹ “Prokuroria Speciale e dorëzon në Gjykatë aktakuzën e plotësuar në rastin e “Veteranëve””. Betimi për Drejtësi. 07 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-speciale-e-dorezon-ne-gjykatë-aktakuzen-e-plotësuar-ne-rastin-e-veteraneve/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

bashku me kryesuesin e KGJK-së, Nehat Idrizi⁵². Me të dy kryesuesit, Tahiri kishte zhvilluar takim edhe në Gjykatën Themelore të Prishtinës⁵³, kishin pritur në takim Prokurorin e Specializuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, Jack Smith⁵⁴, kishin qenë bashkë në përrurimin e vënies në zbatim të projektit TIK/SMIL⁵⁵ si dhe në shumë takime të tjera, për çfarë ishte krijuar përpjesion sikur Ministria e Drejtësisë të jetë pjesë e sistemit gjyqësor dhe jo atij ekzekutiv, apo e kundërta, që KGJK dhe KPK janë pjesë e MD-së.

Madje, në rastin e debatit mbi aktakuzën e veteranëve, Ministri Tahiri kishte premtuar se kjo aktakuzë nuk do të mbetet në sirtarët e prokurorisë. Ai kishte thënë se këtë do ta bëjë për aq sa ja lejojnë kompetencat e tij⁵⁶.

Në një intervistë televizive në Radio Televizionin e Kosovës, Tahiri i kishte cilësuar shumë normale këto takime, për faktin se ai është Ministër i Drejtësisë⁵⁷.

IKD e sheh si shumë shqetësuese këtë “bashkëpunim”. Bashkëpunimi në mes KGJK-së dhe KPK-së në njërin anë, dhe MD-së në anën tjetër, duhet të jetë në fushat në të cilat këto institucione duhet të bashkërendojnë agjendën, siq janë nismat legjislative, grupet punuese apo në fushat që kanë të bëjnë me hartimin e politikave në sektorin e drejtësisë, ku kompetente është Ministria e Drejtësisë.

Kushtetuta e Kosovës, e bën në mënyrë të qartë ndarjen e pushteteve, në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pushteti gjyqësor është i pavarur nga dy pushtetet tjera dhe kjo pavarësi duhet mbrojtur.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, Qeveria apo edhe vet Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, duhet ti ketë parasysh kompetencat që kanë dhe nuk duhet të ndërmarrin veprime që cenojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Për më tepër, si legjislativi ashtu dhe ekzekutivi duhet të shmangin situatat që në publik mund të përceptohen si ndërhyrje në pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Në anën tjetër, edhe vet KGJK dhe KPK

⁵² “Ministri i Drejtësisë dhe kryesuesi i KGJK-së kërkojnë ndërprerjen e grevës, sindikalistët thonë se ajo do të vazhdojë (Video)”. Betimi për Drejtësi. 10 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ministri-i-drejtësisë-dhe-kryesuesi-i-kgjk-se-kerkojne-nderprerjen-e-greves-sindikalistet-thone-se-ajo-do-te-vazhdoje/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁵³ “Tahiri: Pavarësia e gjyqësorit, shtyllë e shtetndërtimit demokratik”. Telegrafi.com. 3 nëntor 2017. (shih linkun <https://telegrafi.com/tahiri-pavaresia-e-gjyqësorit-shtyllë-e-shtetndërtimit-demokratik/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁵⁴ “Ministri Tahiri takoi Prokurorin e Specializuar, Jack Smith”. Indeksonline.com. 30 tetor 2018. (shih linkun <https://indiksonline.net/ministri-tahiri-takoi-prokurorin-e-specializuar-jack-smith/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁵⁵ “Komunikatë e përbashkët e KGJK-së, KPK-së dhe ambasadës së norvegjisë në prishtinë”. KGJK. 21 nëntor 2018. (shih linkun <http://www.gjyqësori-rks.org/sq/kjc/event/index/1755>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁵⁶ “Tahiri premtonte se aktakuza për veteranët s’do të mbetet në sirtar, vettingun e quan të domosdoshëm”. Koha.net. 21 gusht 2018. (shih linkun <https://www.koha.net/arberi/112483/tahiri-premtonte-se-aktakuza-per-veteranet-sdo-te-mbetet-ne-sirtar-vettingun-e-quan-te-domosdoshem/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁵⁷ “10 minuta”. RTK. 28 mars 2018. (Shih linkun https://web.facebook.com/rklivecom/videos/10155952694023859/UzpfSTExODY4MzMTA6MTAyMTU4ODE3NzgZMzU4MjA/?q=ehat%20miftaraj%20besart%20galica%20abelard%20tahiri&epa=SEARCH_BOX) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

duhet të jenë të vemendshëm dhe t'i shmangen takimeve të tilla, në mënyrë që ti shmangen ndikimit eventual si dhe ti shmangen krijimit të opinionin në publik se sistemi ekzekutiv ka ndikim në atë gjyqësor. Shembull tipik të kësaj kemi premtimin e Ministrit Tahiri se aktakuza ndaj veteranëve nuk do të mbetet në sirtarët e prokurorisë, për aq sa atij i'a lejojnë kompetencat. Minisitri i Drejtësisë duhet ta ketë parasysh se në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjeve të aplikueshme, ai nuk e ka as edhe një kompetencë të vetme në këtë aspekt. Për më tepër, një deklaratë të tillë IKD në publik lehtësisht mund të përceptohet si ndërhyrje në punën e gjyqësorit, përkundër faktit se Tahiri kishte thënë se ky nuk ishte qëllimi i tij.

7.2. Lufta e Këshillave për shfajësim në publik rreth dështimeve në luftimin e korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit vazhdon të mbetet prioriteti më i lartë shtetëror, përfshi këtu KGJK-në dhe KPK-në, të cilat kanë përgatitur strategji e plane veprimi⁵⁸ për trajtimin e lëndëve të korrupsionit me prioritet absolut. Pavarësisht kornizës ligjore të avancuar që ka Kosova si dhe miratimit të politikave në luftimin e korrupsionit, rezultatet në praktikë, dëshmojnë se profili i lartë i korrupsionit vazhdon të amnistohet, duke mos arritur ende të shpallet asnjë aktgjykim përfundimtar me dënim burgim efektiv. Në këtë drejtim, gjatë këtyre viteve, ka pasur procedura hetimore, aktakuza të ngritura dhe procedura gjyqësore që janë zhvilluar për raste të korrupsionit, përfshi edhe ndaj profilit të lartë. Ndaj këtij të fundit, të gjitha rastet deri më tash kanë dështuar. Për dështimin e këtyre rasteve, ka pasur akuza të ndërsjella të gjyqësorit dhe prokurorisë, se kush prej tyre bartin fajin për amnistinë që ju bëhet profilit të lartë të korrupsionit. Në vazhdim janë ngritur disa prej çështjeve problematike të luftës së dy Këshillave për ta hedhur topin për dështimet në luftimin e korrupsionit.

7.2.1. Konflikti KGJK-KPK lidhur me dështimet në luftimin e korrupsionit

Gjatë vitit 2018, të dy këshillat kanë hedhur akuza të ndërsjella lidhur me dështimin e sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit. Më konkretisht, në atë se kush është fajtor lidhur me dështimin e aktakuzave të profilit të lartë. Lidhur me këtë çështje, vetë Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, dhe Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu, kanë qenë subjekt i hetimit nga ZPD. Kjo e fundit, , i brenda një afati shumë të shkurtë kohor kishte mbyllur hetimet në këto raste.

Para se konflikti të fillonte sa i përket aktakuzave të dështuara të korrupsionit ndaj profilit të lartë, ishte kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, ai që në takimin e mbajtur më 1 mars 2018 deklaroi se prokurorët po na e lënë “pataten e nxehtë” në duar. Idrizi këtë deklaram e dha teksa po shqyrtoj raportin vjetor i punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë. Në këtë raport, figuronin se disa lëndë ishin parashkruar. Por, sipas nënkryetarit të kësaj Gjykate, Nikollë Komani, kjo ka ardhur për arsye se ishte vetë prokuroria ajo që i kishte ngritur aktakuzat e

⁵⁸ *Shënim:* IKD prej vitit 2013, si rezultat i monitorimit sistematik të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në trajtimin e rasteve të korrupsionit, ka ofruar gjetje, vlerësime dhe rekomandime konkrete si dhe ndihmuar të dy Këshillat në hartimin e Planeve të Veprimit për trajtimin me prioritet absolut të lëndëve të korrupsionit.

parashkruara, ndërsa Gjykata prej nga ai vjenë vetëm se kishte nxjerrë aktvendim për parashkrim relativ të lëndës, pasi të njëjtat ishin parashkruar në prokurori. Idrizi tutje tha se nëse gjykatat janë fajtores duhet ta pranojnë fajin, në të kundërtën ti thuhet prokurorisë se për këto raste faji është tek ju⁵⁹.

Por, konflikti u intensifikuar në takimin e mbajtur më 30 maj 2018 në KPK, në të cilin Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, i ka bërë fajtores gjykatat që nuk po kalojnë aktakuzat që përfshijnë njerëz të rëndësishëm, të cilët akuzohen për vepra penale të korrupsionit. Gjatë raportimit të tij, Kryeprokurori Lumezi, deklaroi se sa i përket rasteve të korrupsionit që nuk kalojnë në gjykata, kjo sipas tij, po ndodh vetëm kur bëhet fjalë për emra të rëndësishëm.

“Nuk është e vërtetë ajo që raportohet në media se shumica e aktakuzave tona hudhen në Gjykatë. Në 89.15 % të rasteve këto aktakuza kalojnë në Gjykatë dhe të njëjtat marrin aktgjykime dënuese. Mirëpo, kjo situatë nuk është kështu edhe në rastet e korrupsionit. Por, kjo është një pikëpyetje e madhe. Pse njerëzit të cilët nuk kanë emër dhe mbiemër dënohen nga Gjykata dhe aktakuzat konfirmohen. Ndërsa ato aktakuza ku janë të përfshirë njerëzit e rëndësishëm me emra dhe mbiemër, ato nuk kalojnë në Gjykatë. Mirëpo, ne nuk i komentojmë vendimet gjyqësore edhe atëherë kur nuk pajtohemi me to, pos në rastet kur ushtrojmë mjetet juridike”, ka thënë Kryeprokurori Lumezi⁶⁰.

Po ashtu, Koordinatori Kombëtarë për Luftimin e Krimit Ekonomik, Shqipdon Fazliu, në emisionin “Click” në RTV21, në të njëjtën ditë ka deklaruar se Prokurorit të Shtetit i hudhen aktakuzat vetëm kur bëhet fjalë për persona të cilët janë të profilit të lartë.

Lidhur me këto deklaratat, KGJK 5 ditë më vonë, më 4 qershor 2018, mbajti takim të jashtëzakonshëm, në të cilin deklaratat e Prokurorit të Shtetit i quajti ndërhyrje në sistemin gjyqësor. Kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, dhe Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, këto deklaratat i quajtën si ndërhyrje në punën e tyre, përderisa kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, tha se Prokurori i Shtetit dështimet e veta po mundohet të i’ a atribuojë gjyqësorit⁶¹.

ZPD me 4 qershor në një përgjigje për “Betimi për Drejtësi” kishte thënë se nuk është e informuar lidhur me këto akuza dhe kundëraakuza⁶². Por, 4 ditë më vonë, ZPD me anë të një

⁵⁹ “Kryesuesi i KGJK-së: Prokurorët po na e lënë në dorë “pataten e nxehtë”. Betimi për Drejtësi. 01 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryesuesi-i-kgjk-se-prokuroret-po-na-e-lene-ne-dore-pataten-e-nxehte/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁶⁰ “Kryeprokurori Lumezi thotë se gjykatat po i hedhin poshtë aktakuzat kur bëhet fjalë për njerëz të rëndësishëm”. Betimi për Drejtësi. 30 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-lumezi-thote-se-gjykatat-po-i-hedhin-poshte-aktakuzat-kur-behet-fjale-per-njerez-te-rendesishem/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁶¹ “Deklaratat e Prokurorit të Shtetit për hudhje të aktakuzave të korrupsionit, krerët e gjyqësorit i quajnë ndërhyrje në këtë sistem (Video)”. Betimi për Drejtësi. 04 qershor 2018. Betimi <https://betimiperdrejtesi.com/deklaratat-e-prokurorit-te-shtetit-per-hudhje-te-aktakuzave-te-korrupsionit-kreret-e-gjyqesorit-i-quajne-nderhyrje-ne-kete-sistem/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁶² “Prokuroria e Shtetit dhe KGJK në “luftë”, ZPD thotë se s’ka informacion se çfarë po ndodhë”. Betimi për Drejtësi. 04 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-e-shtetit-dhe-kgjk-ne-lufte-zpd-thote-se-ska-informacion-se-çfare-po-ndodhe/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

emaile kishte njoftuar IKD-në se hetimi disiplinor ndaj Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, dhe Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu, është mbyllur.

“Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD), sipas detyrës zyrtare i ka vlerësuar pretendimet e ngritura nga “Betimi për Drejtësi” ku pretendohet se, Kryeprokurori Aleksandër Lumezi, në mbledhjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), të mbajtur me datë 30 maj 2018, “i ka bërë fajtores gjykatat që nuk po kalojnë aktakuzat që përfshijnë njerëz të rëndësishëm, të cilët akuzohen për vepra penale të korrupsionit”. Po ashtu, ZPD i ka vlerësuar edhe pretendimet se, Koordinatori Kombëtarë për Luftimin e Krimet Ekonomik Shqipdon Fazliu, në Emisionin “Click”, ka deklaruar se: “Prokurorit të Shtetit i hudhen aktakuzat vetëm kur bëhet fjalë për persona të cilët janë të profilit të lartë”. Lidhur me pretendimet e lartcekura për Kryeprokurorin e Shtetit Aleksandër Lumezi, ZPD ka gjet se, diskutimi i tij në mbledhjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 30 maj 2018, ka qenë në cilësinë e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Meqenëse, diskutimi i tij ka qenë në cilësinë e anëtarit të Këshillit Prokurorial, ZPD nuk ka mandat ligjor të hetoj pretendimet e ngritura për sjellje të mundshme të pahijshme në rastit konkret. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të lartcekura për Koordinatorin Kombëtarë për Luftimin e Krimet Ekonomik Shqipdon Fazliu, ZPD ka gjetur se, Prokurori Fazliu në emision nuk ka përmendur emrat e gjykatësve të cilët kanë vendosur rastet, nuk ka përmendur hierarkinë dhe emrin e gjykatës por, thjeshtë ka shprehur mendim profesional në lidhje me një çështje të rëndësishme për sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë. Në mbështetje të nenit 35 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ZPD i ka vlerësuar pretendimet e ngritura në lidhje me këtë çështje por, tani për tani nuk ka gjet bazë ligjore dhe bazë të mjaftueshme për të hapur një rast disiplinor lidhur me këtë çështje”, thuhej në përgjigjen me shkrim të ZPD-së.

IKD nga monitorimi sistematik që i bënë ZPD-së tash e sa vite, vëren se ZPD këtë rast e ka favorizuar, duke bërë trajtim selektiv të rasteve të njëjta për persona të ndryshëm. Fillimisht, janë të rralla rastet kur ZPD fillon dhe mbyll hetimin për 4 ditë, si në rastin e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, dhe Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu. Në anën tjetër, për shkak të intervistave që kishte dhënë në një medium të caktuar ku kishte kritikuar pushtetin gjyqësor, ZPD e kishte dërguar në komisionin disiplinor të KPK-së Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Imer Beka. Ndaj Bekës, Komisioni Disiplinor i KPK-së kishte shqiptuar masën disiplinore “qortim”.

Në anën tjetër, IKD e sheh si shumë shqetësuese lojën “ping-pong” në mes të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor lidhur me dështimin e tyre për ta luftuar korrupsionin e profilit të lartë. Në këtë drejtim, duhet të kontribuojnë të dy sistemet. Por, është e njohur përgjithësisht, se në rastin kur një prokuror e dërgon në Gjykatë një aktakuzë e cila ka prova bindëse ndaj të akuzuarve, Gjykata e ka jashtëzakonisht të vështirë që ti shmanget vendimit të drejtë. Po ashtu, Prokurori i Shtetit ka në dispozicion mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike, në rast se nuk është i kënaqur me vendimin e Gjykatës. Po ashtu, është detyrë e Prokurorit të Shtetit, që në rast se vërteton se gjykatat po i hudhin aktakuzat në rastet kur, siq thotë Kryeprokurori i Shtetit Lumezi, bëhet fjalë për emra të mëdhenjë, të hetojë dhe dërgojë para drejtësisë gjyqtarë të caktuar, pasi “nxjerrja e kundërligjshme e

vendimeve gjyqësore” në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është vepër penale. Kështu duhet të funksionojë ky relacion, dhe Prokurorit të Shtetit në asnjë formë nuk i lejohej që të komentojë aktgjykimet e gjykatave, për shkak se kjo përbër shkelje të Kodit të Etikës.

7.2.2. Tendanca e Këshillave që me rekomandime ta luftojë korrupsionin

KGJK, KPK, Kryetarët e Gjykatave, Kryeprokurorët dhe Ministri i Drejtësisë me 22 mars 2018 kishin mbajtur një takim të përbashkët, ku në të njëjtin kishin diskutuar lidhur me hapat e mëtutjeshëm për luftën kundër korrupsionit, si kriter i fundit për liberalizimin e vizave.

Ky takim vinte një ditë pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte ratifikuar Marrëveshjen Ndërkombëtare për Përcaktimin e Vijës Kufitare me Malin e Zi, apo siç njihej në publik, Demarkacionin me Malin e Zi.

Gjatë kësaj mbledhjeje ishin dhënë gjashtë rekomandime për hapat e mëtutjeshëm në luftimin e korrupsionit. “1. Të mbahen takime të rregullta mujore në këtë përbërje, 2. Të ketë koordinim në mes Prokurorive dhe Gjykatave, 3. Të mos shtyhen seancat mbi 10 ditë, 4. Të rritet numri i gjyqtarëve në Gjykatën Themelore të Prishtinës, 5. Kufizimi i gjyqtarëve për pjesëmarrjen e tyre në trajnime dhe 6. Ngritja e transparencës në raport me mediat dhe shoqërinë civile” ishin këto rekomandime.

Gjatë këtij takimi, mediat dhe shoqëria civile ishin përjashtuar, me arsyetimin se në takim do të diskutohet për të dhëna të cilat nuk janë publike. Por, për dallim nga mediat dhe shoqëria civile, në takim kishte marrë pjesë edhe Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri.

Sidoqoftë, IKD ka monitoruar në vazhdimësi këto rekomandime, nëse të njëjtat janë zbatuar në praktikë. IKD ka gjetur se rekomandimi që seancat e korrupsionit të mos shtyhen më shumë se 10 ditë është shkelur nga Gjykatat e Republikës së Kosovës qysh në ditën e parë kur do të duhej të zbatoheshin këto rekomandime. Po ashtu, edhe rekomandimi për takime të rregullta të këtij formati nuk ishte zbatuar asnjëherë, pasi takim në këtë përbërje nuk ishte mbajtur më.

7.3. Keqadministrimi nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial

Gjatë vitit 2018, të dy Këshillat kanë vazhduar të përballen me problem serioze në administrimin e duhur për të zbatuar obligimet e tyre ligjore. IKD ka evidentuar disa prej çështjeve më problematike, me të cilat janë përballur Këshillat, duke marrë vendime të cilat cenojnë integritetin e tyre si institucione.

7.3.1. Anëtarët e KGJK-së vendosin të kompensohen retroaktivisht

KGJK më 12 shtator ka nxjerrë vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të KGJK-së për skemën e kompensimit, përkatësisht pagën e anëtarëve të KGJK-së.

Sipas këtij vendimi, anëtarët gjyqtarë të KGJK-së do të kompensohen me nga 262.75 euro në muaj, përderisa anëtarët jo gjyqtarë të KGJK-së do të marrin pagën ekuivalente të gjyqtarit të departamentit të përgjithshëm të Gjykatës Themelore.

Në bazë të pikës 3 këtij të vendimit të KGJK-së marrë me 12 shtator, “vendimi i datës 27 dhjetor 2017, nr. 368/2017, zbatohet në mënyrë retroaktive nga data 1 janar 2018 deri me

datë 31 gusht 2018”. Vendimi i datës 27 dhjetor 2017 kishte përcaktuar që paga e anëtarëve të KGJK-së do të jetë 25% e pagës bazë që ata kanë si Gjyqtarë, përderisa për anëtarët jo-gjyqtarë ishte pagë ekuivalente me gjyqtarin në departamentin e përgjithshëm të Gjykatës Themelore.

Përrjashtimisht Kryesuesit të KGJK-së i cili në bazë të Ligjit për KGJK pranon pagën ekuivalente të Kryetarit të Gjykatës Supreme, shuma që anëtarët e KGJK-së kanë marrë retroaktivisht na bazë të këtij vendimi ka qenë mjaftë e lartë.

Gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe anëtarët e KGJK-së, Muhamet Rexha, Manushe Karaqi dhe Cerim Fazliji të cilët në bazë të vendimit të Qeverisë Haradinaj për ngritje të pagave pranojnë 2655 euro, në bazë të këtij vendimi kanë pranuar edhe nga 5310 euro. Anëtarët Makifete Saliuka dhe Nenad Laziq, të cilët janë Gjyqtarë të Gjykatës së Apelit e që pranojnë pagë në lartësi prej 2389 euro, në bazë të këtij vendimi kanë pranuar edhe nga 4778 euro. Anëtari i KGJK-së Skender Çoçaj, i cili si gjyqtar në Departamentin e Krimeve të Rënda pranon pagë prej 2150 eurove, në bazë të këtij vendimi kanë pranuar edhe 4300 euro. Kurse, anëtarët e KGJK-së gjyqtarë në departamentin e përgjithshëm, Anita Prenaj-Krasniqi, Armend Berisha dhe Gjimshit Galushi, të cilët si pagë pranojnë nga 1672 euro, në bazë të këtij vendimi kanë pranuar edhe nga 3344 euro⁶³.

Këtë kompensim që anëtarët e KGJK-së e kanë marrë retroaktivisht nga janari deri në gusht 2018, është 25 % të pagës bazë të tyre, e që kjo periudhë prek kohën kur pagat kanë filluar të ekzekutohen në bazë të vendimit të Qeverisë Haradinaj për ngritje të pagave.

Ky vendim ishte miratuar në KGJK më 27 dhjetor 2017, përkatësisht një ditë para se Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, deklaroi se vendimi i Qeverisë Haradinaj për rritje të pagave do të zbatohet edhe në raport me Gjyqtarët dhe Prokurorët. Pas ngritjes së pagave konform vendimit të Qeverisë Haradinaj, KGJK-ja ka parë si të nevojshme që të ndryshohet ky vendim, pasi shuma 25% në rrethanat tanimë të ndryshuara kapë një vlerë shumë të madhe. Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së, Shkëlzen Maliqi, ka deklaruar se tanimë kanë ndryshuar rrethanat dhe 25% është një shumë tejet e madhe. Edhe anëtari i KGJK-së, Armend Berisha, ishte i të njëjtit mendim. Mirëpo, disa nga anëtarët të tjerë të KGJK-së nuk ishin pajtuar që të ndryshohet ky vendim. Më së paku 400 euro duhet të jetë shtesa mujore e anëtarëve të KGJK-së, ka kërkuar anëtarja e këtij këshilli, Manushe Karaqi, pavarësisht pagave mujore që marrin si gjykatës:

“Më së paku 400, ndryshe nuk bën”, ka deklaruar Karaqi, në mbledhjen e së premtes të KGJK-së.

Për shkak të këtyre mospajtimeve, KGJK kishte shtyrë marrjen e këtij vendimi deri në mbledhjen e radhës, por që si pikë e rendit të ditës nuk është shtruar deri në mbledhjen e 12

⁶³ *Sqarim:* Kalkulimi është bërë në bazë të vendimit të Qeverisë Haradinaj të datës 20 dhjetor 2017, Ligjit për Gjykatat, Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe vendimit të KGJK-së. Andaj, e kemi parasysh që në vlera minimale kjo llogaritje mund të mos jetë precize.

shtatorit, kur u vendos që kompensimin për 8 muaj, anëtarët e KGJK-së ta marrin retroaktivisht në bazë të vendimit të kundërligjshëm të Qeverisë Haradinaj. Më 12 shtator, lidhur me këtë çështje ishte zhvilluar debat me mospajtime ndërmjet anëtarëve të KGJK-së. Fillimisht, kishte një paqartësi mes anëtarëve, nëse për këto shtesa ishte votuar apo jo nga ana e KGJK-së, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor të vitit të kaluar. Kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, tha se në takimin e saj, KGJK vetëm kishte diskutuar për këtë çështje, por nuk kishte marrë ndonjë vendim, mirëpo, anëtarët e KGJK-së, Makifete Saliuka dhe Skënder Çoçaj, insistuan që për këtë çështje këshilli veç ka vendosur njëherë që meditet të jenë 25 % të pagës bazë.

“Mu personalisht më vjen keq që jemi në këtë situatë. Na e kemi marrë një vendim, mënyra qysh është mbajtur procesverbalin është një çështje tjetër. Le të përgjigjet personi që e ka mbajtur procesverbalin. Nuk mundemi na me thonë që nuk kemi marrë vendim”, deklaroi anëtarja e këshillit, Makifete Saliuka, e cila në mbledhjen e 199-të të 1 marsit të këtij viti, kishte votuar për miratimin e procesverbalit nga ky takim, duke mos dhënë asnjë vërejtje.

I të njëjtit mendim me Saliukën ishte edhe Skënder Çoçaj, i cili tha se këshilli ka vendosur njëherë për këtë çështje dhe ai vendim duhet të ekzekutohet, mirëpo sipas tij, nëse dëshirojnë të ndryshojnë atë vendim atëherë mund të diskutojnë përsëri. E përgjigje lidhur me këtë nëse kjo çështje është votuar apo jo, e dha drejtori i Sekretariatit të KGJK-s, Shkëlzen Maliqi, i cili tha se nga diskutimi i kaluar ka qenë që kërkesa për meditet me rritje të zbatohet mirëpo siç tha, ngritje të dorës nga anëtarët e KGJK-së nuk ka pasur. Kkundër vendimit që shtesat për anëtarët e KGJK-së të jenë 25 % të pagës bazë, kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi tha se ka pasur reagime të rënda nga ana e partnerëve ndërkombëtarë dhe për këtë arsye, Idrizi propozojë që të shkohet me praktikën e njëjtë sikurse Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), ku shtesat janë të caktuara në shumë prej 262 euro për anëtarët. Si shumë të lartë pagesën për anëtarët e KGJK-së e quajti edhe përfaqësuesi i USAID-it, John Ferry, i cili tha se në kohën kur ishte marrë vendimi për shtesat prej 25 % të pagës, pagat e gjyqtarëve kanë qenë më të vogla, pra, para rritjes që ishte bërë në dhjetor të vitit të kaluar. Përfaqësuesi i USAID, John Ferry, tha se KGJK duhet të ndjek praktikën e KPK-së me pagesa fikse për anëtarët e saj, e nëse vendoset që të vazhdohet me shtesat prej 25 % të pagës aktuale të gjyqtarëve, Ferry tha se reagimi i ndërkombëtarëve do të ishte negativ.

Zbatimin e vendimit dhe pagesën e shtesave prej 25 % të pagës, e kërkoi anëtarja e KGJK-së, Anita Prenaj-Krasniqi, e cila tha se edhe me rastin e rritjes së pagave nga ana e kryeministrit ka pasur reagime, mirëpo, e njëjta tha se nuk po e din cila është arsyeja që tashmë të hiqet dorë nga vendimi që kanë marrë. Prenaj-Krasniqi tha se ky vendim duhet të aplikohet ashtu siç është aplikuar në raport me kryesuesin e KGJK-së, Nehat Idrizi. Ky i fundit kërkoi që mos të personalizohet debati, duke shtuar se ai ka marrë pagë siç e përcakton edhe ligji, dhe jo kompensim. Duke diskutuar për çështjen e shtesave, anëtarja Saliuka tha se për të nuk është e rëndësishme se sa paguhet ajo, mirëpo siç tha, nuk po e kupton pse kredibiliteti i KGJK-së po e pësojka në këtë rast për shkak të këtyre shtesave, kur siç tha, pushtet janë të barabarta. Poashtu, Saliuka tha se asaj i “vie në kryë” korrupsioni dhe mafija saher që flitet për politikë dhe politikan:

“Pse kerkush nuk e kthen kryt ka ekzekutivi dhe legjislativi të cilët paguhen shumë me shumë se na. Sa marrin deputetët për seanca e komisione. Mu pom vjen keq pse po e ktheni kryt nga ne. Gjyqësori është me pak i prekur nga korrupsioni. Sa here folët për politikë dhe politikan mu më vjen në kry korrupsioni dhe mafia. Ne jemi bo një pushtet i shtypur dhe i ndrydhur sikurse tashme me ligjin për pagat. Ne kemi mbet fajtor kujdestar për krejt fenomenet negative në këtë shoqni. Na si pushtet jemi i plogëshët” – tha Saliuka në fjalën e saj.

Pas këtij diskutimi, ishte anëtari i KGJK-së, Muhamet Rexha, ai i cili propozojë që nga janari deri në muajin gusht të shkohet me mëditjet prej 25 % të pagës bazë, kurse nga shtatori e tutje të vazhdohet me pagesën fikse. Kështu me shtatë vota për, më një abstenim nga anëtarja Manushe Karaqi dhe me një votë kundër të Anita Prenajt-Krasniqit, u vendos që anëtarët e këshillit të marrin mëditjet prej 25 % të pagës bazë, retroaktivisht nga janari deri në gusht të këtij viti, kurse nga shtatori mëditjet do të jenë prej 262 euro.

Por, a kanë të drejtë në këtë kompensim anëtarët e KGJK-së, pas miratimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike.

Lidhur me këtë ligj, IKD në maj të vitit 2018 ka publikuar analizën e shkurtër ligjore “Ligji ndalon “fluturimin e supermenëve” me shumë pozita drejtuese dhe ndalon përfitimet e mëdha të zyrtarëve publikë nga shtesat”.⁶⁴

IKD vlerëson se një prej problemeve më të mëdha, rrjedhimisht përfitimeve më të mëdha për zyrtarët publikë janë shtesat për punën që ata bëjnë brenda orarit të rregullt të punës.

“Praktika e pagesës së shtesave për zyrtarët publikë është ndërprerë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funksionit Publik. Praktika e shtesave ndalohet në mënyrë eksplicite në nenin 13, paragrafin 2 të këtij ligji, i cili përcakton se “zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.” Për ta elaboruar këtë situatë, IKD sjellë shembullin e shtesave në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. IKD monitoron sistematikisht sistemin e drejtësisë dhe gjetjet dëshmojnë se shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, përveç pagës bazë që marrin si gjykatës apo prokuror të deleguar nga gjykata dhe prokuroria përkatëse sipas rregullave dhe procedurave ligjore, në bazë të rregullave të brendshme të miratuara nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, para hyrjes në fuqi të këtij ligji pranojnë kompensim shtesë për punën që e bëjnë si anëtarë të dy këshillave. Një praktikë e tillë, bie ndesh me frymën dhe qëllimin e ligjit për konfliktin e interesit. Në këtë drejtim është e domosdoshme që Këshillat, institucionet e tjera publike dhe Agjencia Kundër Korrupsion të ndërmarrin masa urgjente për sqarimin e këtyre situatave dhe të ndërmarrin veprime urgjente në parandalimin e veprimeve që potencialisht mund të hyn në sferën penale. Problematika e pagimit të shtesave për zyrtarët publikë tashmë është qartësuar përmes ligjit dhe Agjencia Kundër Korrupsion duhet të

⁶⁴ “Ligji ndalon “fluturimin e supermenëve” me shumë pozita drejtuese dhe ndalon përfitimet e mëdha të zyrtarëve publikë nga shtesat”. IKD. Maj 2018. (shih linkun <https://kli-ks.org/ligji-ndalon-fluturimin-e-supermeneve-me-shume-pozita-drejtuese-dhe-ndalon-perfitimet-e-medha-te-zyrtareve-publike-nga-shtesat-2/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

njoftojë institucionet për dispozitat e reja të këtij ligji dhe të kërkojë që zyrtarët publikë të zbatojnë ligjin sa i përket pagesës së shtesave” thuhet në analizën e IKD-së⁶⁵.

7.3.2. Parregullësitë në KGJK dhe KPK të evidentuara nga Auditori i Përgjithshëm

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit për KGJK-në për vitin 2017, ku janë gjetur parregullsi të ndryshme.

Sipas ZKA-së, në KGJK ka kontrolle të dobëta në menaxhimin e pasurisë dhe mosfunksionim të plotë të sistemin “E-pasuria”, fakt i cili vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, dhe rritë rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive. ZKA ka gjetur se në KGJK ka pasur kontrolle jo të duhura në kompensimin e anëtarëve në Këshill dhe Komisione.

“Neni 3 i U/A për kompensimin e anëtarëve të KGJK-së dhe Komisioneve, përcakton se pjesëmarrja brenda ditës në takime të Këshillit është 70 euro, ndërsa në Komision 50 euro. Në rastet kur nevojitet pjesëmarrja në dy takimet brenda ditës atëherë pagesa bëhet vetëm për takimin e Këshillit në vlerë prej 70 euro. Nga testimi i pagesave retroaktive të anëtarëve të komisioneve në panel të caktuar me vendim nga Këshilli, për të cilat evidentohet prezenca e tyre me rastin e mbajtjes së seancave, në një rast që nuk ishte i caktuar me vendim anëtar i komisionit, mirëpo ishte kompensuar në vlerë 250 euro, dhe për më tepër pagesa për muajin mars si anëtar i komisionit nuk ishte arsyetuar. Po ashtu, në një rast kemi vërejtur se anëtarët e KGJK-së dhe të komisioneve që kanë marrë pjesë brenda ditës në takime të ndryshme dhe se ishin paguar për të dy takimet. Anëtarët e KGJK-së dhe të komisioneve janë kompensuar me tepër në vlerë 250 euro (secili nga 50 euro). Për të dy raste KGJK kishte ndërmarr masa dhe mjetet për dy anëtarët e komisioneve ishin kthyer në buxhet në vitin 2018. Kontrollat jo të duhura në kompensimin e anëtarëve në këshill dhe komisione, rrisin rrezikun që pagesat e tilla përveç që nuk janë në përputhje me kërkesat rregullative, mund të dëmtojnë edhe buxhetin. Kryesuesi i KGJK dhe Drejtori i SKGJK, duhet të sigurojnë se të gjitha shpenzimet në lidhje me kompensimin e takimeve të anëtarëve në këshill dhe komisione të jenë të dokumentuara dhe në pajtim me UA në fuqi”, thuhet në raportin e ZKA-së.

ZKA-ja ka gjetur se praktika e mbulimit të pozitave të lira me ushtrues detyre mbi afatin e lejuar kohor ka ndodhur në tre raste: Zyrtari i lartë në njësinë për Evidencë Penale në SKGJK, Drejtori i Zyrës së Evidencës Qendrore, Zyrtarit Certifikues në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe Udhëheqës për Buxhet dhe Financa në Gjykatën. Sipas ZKA-së, praktika e mbulimit të pozitave kyçe me U.D për periudha të gjata kohore, përveç se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme në mungesë të konkurrencës së hapur. Kjo mund të ndikojë negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi. ZKA rekomandon që kryesuesi i KGJK, drejtori i SKGJK dhe kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të sigurojnë zhvillimin e procedurave të rekrutimit, që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta.

⁶⁵ “Ligji ndalon “fluturimin e supermenëve” me shumë pozita drejtuese dhe ndalon përfitimet e mëdha të zyrtarëve publikë nga shtesat”. IKD. Maj 2018. (shih linkun <https://kli-ks.org/ligji-ndalon-fluturimin-e-supermeneve-me-shume-pozita-drejtuese-dhe-ndalon-perfitimet-e-medha-te-zyrtareve-publike-nga-shtesat-2/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

Kohëzgjatja e funksionit si U.D, sipas ZKA-së, të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore. Kjo zyrë, ka gjetur se Gjykata e Apelit ka tejkalluar numrin e lejuar për gjyqtarë në Departamentin për Krime të Rënda. ZKA potencon se tejkallimi i numrit të gjyqtarëve rritë rrezikun që të përfitojnë më shumë gjyqtarë se sa që janë të caktuar me vendim si dhe ngarkim i buxhetit të KGJK-së. ZKA ka gjetur shkelje edhe sa i përket kontratave të quajtura “marrëveshje për shërbime të veçanta”.

“Sipas nenit 12 pika 4 e LShC nr.03L/149, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Ne kemi identifikuar se Gjykata Themelore në Prishtinë kishte lidhur marrëveshjen për shërbime të veçanta me një punonjës për pozitën „Roje Sigurimi” në kohëzgjatje gjashtë muaj, duke vazhduar edhe për gjashtë muaj të tjerë. PAGESA për këto shërbime ishte bërë nga kategoria mallra dhe shërbime (kodi 13420) në shumë 291€ në muaj. Kontrata për shërbime të veçanta është lidhur për pozitë të zakonshme e jo për ekspertë të fushave përkatëse dhe për të njëjtën nuk është zhvilluar procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Mbulimi i pozitave të zakonshme dhe me kohëzgjatje mbi afatin e përcaktuar përmes procedurave jo adekuate paraqet anashkallim të dispozitave të përcaktuara ligjore, kufizon konkurrencën dhe rritë rrezikun që shërbimet të mos jenë reale me nevojat e KGJK-së dhe se buxheti i planifikuar për këtë kategori të mos shpenzohet sipas qëllimit të caktuar. Kryesuesi i KGJK, Drejtori i SKGJK dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, planifikohen drejtë dhe bëhen në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi” thuhet në raportin e ZKA-së për KGJK-në.

Po ashtu, ZKA ka potencuar se niveli aktual i trajtimit të rekomandimeve nuk është i kënaqshëm për shkak se KGJK nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të rishikuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve dhe identifikimin e pengesave për veprim në adresimin e tyre të plotë.

“Mungesa e një monitorimi efektiv të zbatimit të rekomandimeve ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme lidhur në fushat pagave dhe shtesave, subvencioneve, si dhe menaxhim të pasurive. Kryesuesi i KGJK-së, Drejtori i SKGJK-së dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të sigurojë që plani i veprimit rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe mekanizma llogaridhënës ndaj të gjithë personave përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi”, thuhet në këtë raport.

Krejt në fund, ZKA potencon se në KGJK mungon Komiteti i Auditimit, e që mungesa e këtij komiteti rezulton me mos shqyrtim të raporteve të që rrit rrezikun që menaxhmenti të mos

jetë i informuar për të ndërmarrë masat adekuate për çështjet e ngritura. ZKA rekomandon që kryesuesi i KGJK-së dhe drejtori i SKGJK-së të sigurohen për themelimin e këtij komiteti⁶⁶.

ZKA ka gjetur parregullsi të ndryshme edhe në KPK. ZKA-ja ka gjetur se KPK-ja nuk kishte aplikuar kriteret për shpalljen e konkurseve, duke rritur rrezikun që në pozitë të caktuara të rekrutohen personat të cilët nuk i përmbushin kriteret e nevojshme.

“Rregullorja nr.21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civilë, përcakton që shpallja për avancim së pari të bëhet brenda njësisë së institucionit dhe nëse në pozitën e lirë aplikojnë më pak se tre kandidatë që plotësojnë kriteret, njësi e personelit shpall konkurs në nivel të institucionit. Gjatë auditimit ne kemi identifikuar se në tri shpalljet e brendshme për avancim të stafit për pozitë udhëheqëse, si: *Udhëheqës për buxhet, financa dhe shërbime të përgjithshme, Udhëheqës për burime njerëzore dhe Udhëheqës i prokurimit*, nuk është bërë shpallja së pari brenda njësisë përkatëse, por në tërë Sekretariatit e Këshillit Prokurorial. Drejtori i SKPK duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme që zhvillimi i procedurave për avancime dhe rekrutime të ju përmbahen kërkesave rregullative në fuqi”, thuhet në raportin e publikuar nga ZKA-ja.

Sa i përket investimeve kapitale, në raport thuhet se ky buxhet gjatë vitit 2017 është ekzekutuar vetëm 15%. Sipas ZKA-së, kjo ka ndodhur për shkak se nuk ishin analizuar në baza të rregullta ecuritë buxhetore në realizimin me kohë të projekteve kapitale si dhe për shkak të ngecjeve në iniciimin e kërkesave dhe procedurave të prokurimit që kanë të bëjnë me projektet si “Sistemi për menaxhimin informativ të lëndëve (SMIL) në bashkëfinancim me Qeverinë Norvegjeze dhe “Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Veturave SEMV”. Rreziku i kësaj, sipas ZKA-së, është se planifikimi jo i duhur i realizimit të projekteve, ka ndikuar në mos arritjen e objektivave të organizatës me ecuritë e shpenzimeve për projektet kapitale. ZKA-ja i rekomandon drejtorit të Sekretariatit të KPK-së që të sigurojë që me rastin e planifikimeve buxhetore të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i burimeve potenciale (mjeteve financiare) dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të buxhetit në investime kapitale. Neni 30 i LSHC nr.03L/149, përcakton se në rast të mbajtjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës (U.D) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj.

Gjatë auditimit, ZKA-ja ka identifikuar se tre pozita mbulohej me Ushtrues Detyre (UD) duke tejkaluar afatin e lejuar për mbajtjen e pozitës. Rastet janë: *Menaxhere e zyrës për komunikim publik* në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit mbulohet me UD nga dt. 03.02.2017(KPK një herë kishte shpallur konkursin), *Udhëheqës i departamentit për teknologji informative* në Sekretariatit të KPK-së mbulohet me UD nga dt. 04.04.2017 (KPK

⁶⁶ “Auditori thotë se KGJK-ja s’ka pasur kontroll në kompensimin e anëtarëve në Këshill dhe Komisione”. Betimi për Drejtësi. 05 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/auditori-thote-se-kgjk-ja-ska-pasur-kontroll-ne-kompensimin-e-anetareve-ne-keshill-dhe-komisione/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

kishte shpallur tri herë konkursin), si dhe *Udhëheqës i zyrës për transport* në Sekretariatit e KPK-së mbulohet me U.D. nga dt. 04.04.2017.

Sipas ZKA-së, praktika e mbulimit të pozitave kyçe me U.D për periudha të gjata kohore, përveç se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Kjo, sipas saj, mund të ndikojë negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi.

Përkritazi me këtë, drejtori i sekretariatit të KGJK-së është rekomanduar që të bëjë përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin e procedurave të rekrutimit që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta. Kohëzgjatja në pozitën si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.

Një tjetër gjetje e ZKA-së është se KPK-ja nuk kishte aplikuar kriteret për shpalljen e konkurseve, duke rritur rrezikun që në pozitat e caktuara të rekrutohen personat të cilët nuk i përmbushin kriteret e nevojshme.

“Rregullorja nr.21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civil, përcakton që shpallja për avancim së pari të bëhet brenda njësisë së institucionit, dhe nëse në pozitën e lirë aplikojnë më pak se tre kandidatë që plotësojnë kriteret, njësia e personelit shpall konkurs në nivel të institucionit. Gjatë auditimit ne kemi identifikuar se në tri shpalljet e brendshme për avancim të stafit për pozitat udhëheqëse, si: *Udhëheqës për buxhet, financa dhe shërbime të përgjithshme, Udhëheqës për burime njerëzore dhe Udhëheqës i prokurimit*, nuk është bërë shpallja së pari brenda njësisë përkatëse, por në tërë Sekretariatit e Këshillit Prokurorial. Drejtori i SKPK-së duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme që zhvillimi i procedurave për avancime dhe rekrutime të ju përmbahen kërkesave rregullative në fuqi”, thuhet në raportin e publikuar nga ZKA-ja. Në të, thuhet se KPK-ja po ashtu nuk kishte themeluar komisionin për vlerësimin e pasurisë si kërkesë rregullative. Sipas ZKA-së, kjo ndikon që pasuria e KPK-së të mbivlerësohet, dhe se kjo mund të rezultojë me prezantim jo të plotë dhe të saktë të pasurive.

Krejt në fund, në raport thuhet se KPK-ja ka bërë progres në zbatimin e rekomandimeve, megjithatë mos zbatimi i plotë i të gjitha rekomandimeve ka ndikuar që disa mangësi të përsëriten nga viti i kaluar. Kjo ishte e theksuar kryesisht te procedimi i pagesave për kujdestari dhe mbulimi i pozitave me ushtrues detyre.

“Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta, të cilat mund të ndikojnë në dobësi në menaxhimin financiar dhe të kontrolleve. Drejtori i SKPK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar për adresimin e rekomandimeve të mbetura. Ky plan duhet të përcaktoj afatet e arsyeshme kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar. Progresi

kundrejt planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e plotë të rekomandimeve”, përfundon raporti i ZKA-së për KPK-në⁶⁷.

IKD vlerëson se në mënyrë që të ketë një menaxhim sa më të mirë financiar në kuadër të KGJK-së, KPK-së, Gjykatave dhe Prokurorive, të dy këshillat duhet të trajtojnë me seriozitetin më të madhë raportet e auditimit. Është e pakuptueshme se si as KGJK as KPK nuk kanë diskutuar në asnjërin takim të tyre gjatë vitit 2018 lidhur me këto gjetje të ZKA-së. Për më tepër, të njëjtit nuk kanë sqaruar asgjë për publikun nëse rekomandimet e ZKA-së janë trajtuar dhe nëse është marrë ndonjë masë për evitimin e tyre.

7.3.3. Greva e punëtorëve të administratës së gjykatave dhe prokurorive

Vendimi i Qeverisë Haradinaj për ngritje të pagave dhe aplikimi i tij edhe në raport me gjyqtarët dhe prokurorët kishte ngritur pakënaqësi të mëdha tek punëtorët e administratës së gjykatave dhe prokurorive.

Punëtorët e administratës së gjykatave dhe prokurorive në vend, nga 4 deri më 11 korrik kanë hyrë në grevë të përgjithshme, duke kërkuar realizimin e tri kërkesave, e ato ishin rritja e pagave për 100%, që me Ligjin për Pagat të ketë vlerësime reale dhe të dinjitetshme për punëtorët e gjykatave dhe prokurorive dhe kërkesa e fundit ka qenë rregullimi i statusit së këtyre punëtorëve. Gjatë kohës së grevës, qindra seanca gjyqësore kishin dështuar të mbaheshin si pasojë e këtij veprimi sindikal. Vetëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për çdo ditë kanë dështuar të mbahen mbi 100 seanca gjyqësore, përfshirë edhe ato të korrupsionit. Kurse, dhjetëra seanca për çdo ditë, si pasojë e grevës ishin pamundësuar edhe në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës. Nga greva ishin përjashtuar vetëm rastet e paraburgimeve, të dhunës në familje si dhe rastet të shënjestruara për liberalizimin e vizave.

Më 11 korrik, ishte arritur marrëveshja për ndërprerjen e grevës. Një marrëveshje e tillë është arritur pas një takimi që përfaqësuesit e këshillit grevist kanë pasur me përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial, kryetarët e Gjykatave Themelore si dhe kryeprokurorët e Prokurorive Themelore, ku ka marr pjesë edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri.

Kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, ka thënë se me përfaqësuesit e Sindikatës së Judikaturës është arritur një marrëveshje që ta ndalin grevën, duke thënë se atyre do tu plotësohen vetëm kërkesat, sipas tij, të mundshme⁶⁸.

⁶⁷ “Zyra Kombëtare e Auditimit thotë se KPK-ja nuk aplikoi kriteret për shpalljen e konkurseve” Betimi për Drejtësi. 02 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/zyra-kombetare-e-auditimit-thote-se-kpk-ja-nuk-aplikoi-kriteret-per-shpalljen-e-konkurseve/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁶⁸ “Arrihet marrëveshja, punëtorët administrativë të gjykatave dhe prokurorive pezullojnë grevën (Video)”. Betimi për Drejtësi. 11 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arrihet-marreveshja-punetoret-administrative-te-gjykatave-dhe-prokurorive-e-pezullojne-greven/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

Por, disa ditë më vonë, është bërë e ditur se punëtorët e administratës së gjykatave dhe prokurorive nga kërkesë për rritje page 100%, janë mjaftuar me një shtesë në shumë prej 50 eurove⁶⁹.

7.3.4. Dështimi i KPK-së për zgjedhjen e anëtarit nga shoqëria civile

KPK gjatë këtij viti për të tretën herë radhazi, ka dështuar të zgjedhë anëtarin e saj nga radhët e shoqërisë civile.

Për dallim nga dy herët e tjera, që nga fillimi i vitit 2017, ku nuk kishin aplikuar të paktën tre persona për këtë pozitë, ashtu siç parashihet me ligj, në takimin e mbajtur më 31 tetor 2018 u bë e ditur se këtë herë kanë aplikuar tre (3) kandidatë.

Por, ky konkurs ka dështuar, për arsye se nga 3 kandidatët që kishin aplikuar për këtë pozitë, vetëm 2 prej tyre plotësonin kriteret formale për të vazhduar procedurën.

Pas kësaj, kryesuesi i KPK-së, Blerim Isufaj, ka bërë të ditur se konkursi në këtë formë nuk mund të vazhdojë më tutje, pasi nuk kemi 3 kandidatë të cilët plotësojnë kriteret formale. I njëjti ka shtuar se në një nga takimet e radhës do të rishpallet konkursi për anëtarë të KPK-së.

Por, përkundër këtij premtimi, KPK është dorëzuar nga 3 përpjekjet e kaluara, dhe nuk e ka bërë përpjekjen e katërt për të zgjedhur anëtarin e KPK-së nga radhët e shoqërisë civile. Kjo për arsye se në asnjë nga takimet e radhës, konkursi i radhës për anëtarë të KPK-së nga radhët e shoqërisë civile nuk është rishpallur. Lidhur me këtë fakt, KPK nuk ka dhënë asnjë arsyetim.

Që nga janari i vitit 2016 kur KPK ka filluar aktivitetet me përbërje të re, i njëjti nuk ka arritur që të ketë përbërjen e plotë me anëtarë.

KPK më 14 gusht 2017 kishte shpallur konkursin për pozitën e anëtarit nga radhët e shoqërisë civile, i cili konkurs ishte i hapur deri më 29 gusht 2017. Mirëpo në këtë konkurs nuk kishte aplikuar asnjë kandidat.

Andaj si rrjedhojë KPK kishte marrë vendim për rishpallje të konkursit në fjalë, ku sipas Komisionit për shqyrtimin e përshtatshmërisë së kandidatëve të nominuar, as herën e dytë, nuk kishte arritur të zgjedhet përfaqësuesi nga shoqëria civile, për shkak se nuk ishin nominuar tre kandidatë ashtu siç parashihet me ligj.

Prokurorja Jusaj, në takimin e mbajtur më 23 nëntor 2017, kishte bërë të ditur se gjatë periudhës sa konkursi i rishpallur ka qenë i hapur, është nominuar vetëm kandidati Naim Osmani⁷⁰.

⁶⁹ “Nga kërkesa për rritje page 100%, punëtorët administrativë të gjykatave dhe prokurorive mjaftohen me një shtesë prej 50 euro”. Betimi për Drejtësi. 26 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nga-kerkesa-per-rritje-page-100-punetoret-administrative-te-gjykatave-dhe-prokurorive-mjaftohen-me-nje-shtese-prej-50-euro/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

Kryesuesi i sapozgjedhur i KPK-së, Bahri Hyseni, ka thënë se KPK vazhdimisht ka inkurajuar shoqërinë civile që të dërgojë nominimet e tyre për anëtar të KPK-së nga radhët e shoqërisë civile, por se nominimet kanë munguar:

“Në bazë të nenit 3, paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshilli është përgjegjës për të shpallur konkursin publik për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit nga radhët e shoqërisë civile. Pas zhvillimit të procedurës së konkursit, Këshilli dërgon në Kuvendin e Kosovës listën prej së paku 3 kandidatëve që i kanë plotësuar kriteret ligjore. Që nga vitit 2016, Këshilli në vazhdimësi ka bërë shpallje publike për kandidatët e interesuar nga shoqëria civile për anëtar të Këshillit, mirëpo në vazhdimësi në shpalljet tona kanë aplikuar 2 ose 3 kandidatë dhe kjo e ka pamundësuar vazhdimin e procesit në Kuvendin e Kosovës. Në rastet kur kemi pasur 3 kandidatë, njëri nga ta nuk i ka plotësuar kushtet ligjore, andaj bazuar në Ligjin Nr.05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës lista duhet t’i ketë së paku 3 kandidatë. Vlen të përmendet se Këshilli në vazhdimësi ka inkurajuar shoqërinë civile të dërgojë nominimet e tyre për anëtar të Këshillit nga radhët e shoqërisë civile” ka thënë Hyseni⁷¹.

7.3.5. Rezistenca e Gjyqtarit Veli Kryeziu që ta zbatojë vendimin e KGJK-së

KGJK më 2 maj 2018 kishte nxjerrë vendim me anë të së cilit kishte transferuar përkohësisht pesë gjyqtarë në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Në mesin e tyre ishte edhe gjyqtari i Gjykatës Themelore në Gjiilan, Veli Kryeziu. Por përkundër këtij vendimi të KGJK-së, që e obligonte gjyqtarin Kryeziu që për 6 muajt e ardhshëm të punonte si gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës, i njëjti nuk ka pranuar që të punojë aty.

Në mbledhjen e mbajtur më 20 korrik 2018, si pikë e rendit të ditës ishte edhe revokimi i vendimit për transferimin e gjyqtarit Veli Kryeziu. Kjo kërkesë kishte ardhur nga kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi, me arsyetimin se gjyqtari Kryeziu nuk ishte paraqitur në punë në gjykatën që ajo e drejton. Gjatë mbledhjes në fjalë, kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi deklaroi se gjyqtari Kryeziu e ka arsyetuar këtë çështje me faktin se ka pasur probleme shëndetësore.

Por, nga një hulumtim që kishte bërë “Betimi për Drejtësi”, del se problemet shëndetësore nuk kanë qenë arsyeja pse gjyqtari Kryeziu nuk e ka zbatuar vendimin e KGJK-së.

Kryetarja Bytyçi kishte thënë për “Betimi për Drejtësi” se gjyqtarin Kryeziu e kishte akomoduar në zyrë dhe i’ka kishte ndarë lëndët, por i njëjti kishte pranuar të jetë vetëm anëtar i trupit gjykues, jo edhe kryetar i trupit gjykues. Por, ndonëse ligji nuk e parasheh një

⁷⁰ “Përsëri dështon zgjedhja e anëtarit të KPK-së nga shoqëria civile, shpallet konkursi për herë të katërt”. Betimi për Drejtësi. 31 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perseri-deshton-zgjedhja-e-anetarit-te-kpk-se-nga-shoqeria-civile-shpallet-konkursi-per-here-te-katert/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁷¹ IKD intervistë përmes postës elektronike me z. Bahri Hyseni, Kryesues i KPK-së. 24 janar 2019.

mundësi të tillë, kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi thotë se paraprakisht ka pasur një marrëveshje që gjyqtari Kryeziu të jetë vetëm anëtar i trupeve gjykuese, dhe jo edhe të ngarkohet me lëndë.

“Gjyqtari Veli Kryeziu ka punuar në kundërvajtje. Ai profesionalisht nuk ka qenë në gjendje që të punojë lëndë në krime të rënda. Ne jemi marrë vesh ndryshe me gojë. Ne jemi marrë vesh që ai të punojë vetëm si anëtarë i trupeve gjykuese, por kur ka shkuar në Prishtinë, i kanë dhënë lëndë me zgjidhë, dhe ky është tërheqë mbrapa në Gjilan. Por, që nga ajo kohë e deri sot, ai punën si gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan nuk e ka ndalur” ka deklaruar kryetari Azizi për “Betimi për Drejtësi”.

Ndërkaq, vetë gjyqtari Veli Kryeziu përmend dy versione se pse nuk është paraqitur në Gjykatën Themelore të Prishtinës, dhe asnjëri nuk ka të bëjë me versionin e dhënë në KGJK se ai nuk ishte paraqitur në punë për arsye shëndetësore. Kryeziu fillimisht përmend si arsye se i janë dhënë lëndët e vitit 2000, ndërsa më pas thotë se marrëveshja ka qenë që i njëjti të jem vetëm anëtar, dhe jo kryetar i trupit gjykues.

“Nuk kam shkuar të punojë në Prishtinë për arsye se nuk jemi marrë vesh me kryetaren. Ne jemi shkuar për lëndët “LV” ndërsa ajo më ka ndarë lëndë të vitit 2000. Marrëveshja në fillim ka qenë që unë të jem vetëm anëtar i trupit gjykues. Këshilli ka prurë vendim që unë me shku vetëm si anëtar i trupit gjykues. Kur kam shkuar atje më kanë dhënë lëndë dhe unë kam refuzuar ti marrë ato. Kryetarja më ka thënë se “unë vendosi në këtë gjykatë”. Pasi ka thënë kështu, e kam bërë kërkesën me u tërheq” kishte thënë gjyqtari Veli Kryeziu për “Betimi për Drejtësi”.

Por, ndryshe nga ajo që deklaroi gjyqtari Veli Kryeziu, vendimi i KGJK-së numër 130/2018, nuk përmend se gjyqtari Kryeziu transferohet të punojë vetëm si anëtar i trupeve gjykuese.

“Z. Veli Kryeziu, gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjilan, transferohet përkohësisht nga Gjykata Themelore Gjilan në Gjykatën Themelore Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda. Kohëzgjatja transferimit për gjyqtarin Kryeziu nga Gjykata Themelore Gjilan në Gjykatën Themelore Prishtinë, është gjashtë (6) muaj me mundësi vazhdimi. Vendimi hyn në fuqi më datë 2 maj 2018” thuhet në dispozitivin e këtij vendimi. Madje as në arsyetimin e këtij vendimi nuk përmendet një fakt i tillë.

Për më tepër, në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se edhe kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi e edhe vetë gjyqtari Veli Kryeziu kanë dhënë pajtimin për këtë transferim. “Si rezultat i kësaj, kryetari i Gjykatës Themelore Gjilan është konsultuar së bashku me gjyqtarët e kësaj gjykate, dhe pas konsultimit të tyre, me pajtimin e gjyqtarit ka dërguar në KGJK propozimin për transferim të përkohshëm të gjyqtarit z. Veli Kryeziu, nga gjykata Themelore Gjilan në Gjykatën Themelore Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda” thuhet në arsyetimin e këtij vendimi.

Në anën tjetër, Rregullorja e KGJK-së nr.15/2016 për transferimin dhe caktimin e gjyqtarëve nuk parasheh mundësinë që një gjyqtar të transferohet dhe i njëjti mos të zgjidhë lëndë, por vetëm të marrë pjesë si anëtar i trupeve gjykuese.

Neni 4.1 i kësaj rregulloreje përcakton se me transfer të përkohshëm nënkuptojmë atë transfer të bërë nga KGJK me miratimin e kryetarit të gjykatës përkatëse, për periudha të arsyeshme kohore, me qëllim për të ndihmuar gjykatën në rastet kur gjykata tjetër ka numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve për shqyrtimin e rasteve gjyqësore.

Ndërsa, neni 5 i kësaj rregullore përcakton: “në rastet kur KGJK-ja përcakton se një gjykatë ka numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve për menaxhimin dhe zgjidhjen efikase të lëndëve, mund të transferoj një gjyqtarë nga një gjykatë në tjetrën, për një periudhë të arsyeshme kohore me pëlqimin e gjyqtarit dhe miratimin e kryetarit të gjykatës. Transferi i përkohshëm deri në dymbëdhjetë muaj konsiderohet i arsyeshëm. Transferimi i përkohshëm, duhet të behet në bazë të ngarkesës së gjykatës me qëllimin e përgjithshëm të përmirësimit të efikasitetit, shpërndarjes së barabartë të vëllimit të punës ndërmjet gjykatave, dhe krijimin e mundësive për të siguruar zgjidhjen e rasteve në kohë”.

I kontaktuar nga “Betimi për Drejtësi”, kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi ka vazhduar të mbrojë qëndrimin se gjyqtari Veli Kryeziu nuk ka shkuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës për arsye shëndetësore, duke mos u deklaruar nëse ndaj këtij gjyqtari do të iniciohet ndonjë procedurë disiplinore për moszbatim të vendimit të KGJK-së.

“Përpos atyre arsyeve, ai ka përmendur edhe arsye shëndetësore. Sa i përket masave të mëtuqjeshme do shohim. Nuk mund të deklarojmë tash. Jam në pushim” ka qenë prononcimi i Idrizit për “Betimi për Drejtësi”⁷².

Në po të njëjtën ditë kur ishte transferuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës Gjyqtari Veli Kryeziu, në këtë Gjykatë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës ishte transferuar edhe Gjyqtari Tomislav Petković. Po në të njëjtën ditë kur ishte revokuar Gjyqtarit Kryeziu vendimi për transfer, vendimi ishte revokuar edhe ndaj Tomislav Petković, për arsye se as ky i fundit nuk ishte paraqitur në Gjykatë. KGJK dhe Gjyqtari Petković asnjëherë nuk kanë dhënë sqarime se pse ka ardhur deri tek mos zbatimi i vendimit të KGJK-së⁷³.

⁷² “Marrëveshja që të mos zgjidh lëndë, arsyeja pse gjyqtari Veli Kryeziu nuk zbatoi vendimin e KGJK-së”. Betimi për Drejtësi. 24 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/marreveshja-qe-te-mos-zgjidh-lende-arsyeja-pse-gjyqtari-veli-kryeziu-nuk-zbatoi-vendimin-e-kgjk-se/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁷³ “Gjyqtarët e transferuar në Prishtinë nuk paraqiten në punë, revokohet vendimi për transferimin e tyre”. Betimi për Drejtësi. 20 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjyqtaret-e-transferuar-ne-prishtine-nuk-paraqiten-ne-pune-revokohet-vendimi-per-transferimin-e-tyre/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

7.3.6. 16 muaj përpjekje për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan

Në takimin e mbajtur më 17 prill 2018, KGJK e ka zgjedhur Ramiz Azizin, kryetar të Gjykatës Themelore në Gjilan. KGJK e ka zhvilluar këtë proces pa praninë e mediave dhe të shoqërisë civile, për arsye se këta të fundit nuk ishin ftuar nga KGJK. Sipas komunikatës për media të KGJK-së, Azizi ka marrë shumicën afirmative të votave të anëtarëve të këtij këshilli, duke mos treguar se cili ishte numri i saktë i votave që kishte marrë Azizi. Në garë për këtë pozitë kanë qenë edhe gjykatësit e tjerë të kësaj gjykate, Zyhdi Haziri, Agim Ademi, Aziz Shaqiri, Veli Kryeziu dhe Naser Maliqi⁷⁴.

Zgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan i ka paraprirë një sfidë 16 mujore në KGJK⁷⁵. Zgjedhja e kryetarit ka dështuar dy herë në KGJK, për shkak se asnjëri nga kandidatët nuk kishte marrë shumicën afirmative të votave për tu zgjedhur në këtë pozitë, ku kishte bërë që konkursi të shpallej për herë të tretë. Në mbledhjen e 13 janarit të vitit 2017, si pikë e rendit të ditës kishte qenë edhe përzgjedhja e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan. Në garë për këtë pozitë kishin qenë katër kandidatë, ku KGJK-ja kishte votuar për secilin veç e veç, pasi ende nuk ishte ndryshuar Rregullorja për Përzgjedhjen e Kryetarëve të Gjykatave. Kandidati Zyhdi Haziri, kishte marrë 4 vota për, dhe 5 abstenime, Naser Maliqi 2 vota për, 4 kundër dhe 3 abstenime, Aziz Shaqiri 2 vota për, 4 kundër dhe 3 abstenime, ndërsa 1 votë për, 3 kundër dhe 6 abstenim kishte marrë kandidati Veli Kryeziu. Kësisoj, meqenëse asnjëri nga kandidatët nuk kishte fituar shumicën afirmative të votave për pozitën e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, ishte e domosdoshme që konkursi të rishpallej. Për shkak të kësaj gjendje të krijuar, KGJK-ja kishte zgjedhur gjykatësin Afrim Shala për u.d. të kryetarit të kësaj Themelore në Gjilan.

Procedura për herën e dytë, që nga shpallja e konkursit e deri në votim në KGJK, kishte zgjatur mbi nëntë muaj. Në mbledhjen e 18 tetorit të vitit të kaluar, KGJK-ja si pikë të rendit të ditës kishte përsëri përzgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan. Në garë për këtë pozitë, ishin gjithsej tetë kandidatë, ku procesi i votimit ishte zhvilluar në tri runde. Në rundin e parë, nga gjithsej tetë kandidatë, Ramiz Azizi dhe Zyhdi Haziri kishin marrë numër të barabartë të votave, përkatësisht secili prej tyre nga pesë vota. Mes këtyre dy kandidatëve, ishte zhvilluar edhe rundi i dytë, i cili përsëri rezultoi me numër të barabartë të votave të anëtarëve të KGJK-së. Edhe rundi i tretë nuk solli ndryshime, dhe si rrjedhojë ky proces dështojë edhe herën e dytë⁷⁶.

Deri më 20 shkurt 2018, pozitën e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan e kishte ushtruar gjykatësi Afrim Shala. Mirëpo, me dekret të Presidentit Hashim Thaçi, Shala ishte avancuar

⁷⁴ “*Ramiz Azizi zgjidhet kryetar i Gjykatës Themelore në Gjilan*”. Betimi për Drejtësi. 17 prill 2018. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ramiz-azizi-zgjidhet-kryetar-i-gjykates-themelore-ne-gjilan/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁷⁵ “*Gjykata Themelore në Gjilan për 15 muaj pa kryetar, KGJK-ja shpall konkurs për herë të tretë*”. Betimi për Drejtësi. 13 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-themelore-ne-gjilan-per-15-muaj-pa-kryetar-kgjk-ja-shpall-konkurs-per-here-te-trete/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁷⁶ “*Dështon zgjedhja e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, rishpallet konkursi*”. Betimi për Drejtësi. 18 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-zgjedhja-e-kryetarit-te-gjykates-themelore-ne-gjilan-rishpallet-konkursi/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

si gjykatës në Gjykatën e Apelit. Për këtë arsye, Gjykata Themelore në Gjilan kishte mbetur edhe pa u.d. të kryetarit, pasi në momentin kur KGJK-ja kishte propozuar Shalën për avancim, nuk kishte caktuar një u.d. tjetër të kryetarit të kësaj gjykate. Nga 20 shkurti e deri më 1 mars, Gjykata Themelore në Gjilan kishte mbetur vetëm me zëvendës ushtrues detyre të kryetarit të gjykatës, pozitë të cilën e ushtroi gjykatësi, Agim Ademi⁷⁷. Më 1 mars, KGJK-ja caktoi për u.d. të kryetarit të kësaj gjykate, gjykatësen Mevlude Shabani.

7.3.7. Tensionet në KGJK lidhur me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

Në takimin e mbajtur më 30 nëntor 2018, në KGJK është shqyrtuar kërkesa e kryetarit të Gjykatës Supreme, Enver Peci, për funksionalizimin e punës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Që nga qershori i vitit 2018 kur Misionit Evropian për Sundit të Ligjit në Kosovë (EULEX) i ka përfunduar mandati, Dhoma e Posaçme ka qenë pasive, ndonëse të pazgjidhura janë rreth 22.000 lëndë.

Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci ka kërkuar një mendim apo përkrahje nga KGJK për të formuar kolegjet gjyquese në Dhomës e Posaçme të Gjykatës Supreme, si dhe për të autorizuar kryetarin e Dhomës së Posaçme që të themelojë komisionin për ankesa. Por, shqyrtimi i kësaj kërkesë është përshkuar me polemika mes anëtarëve të KGJK-së. Fillimisht, anëtarët Makifete Saliuka dhe Muhamet Rexha kanë përkrahur funksionalizimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, duke thënë puna e saj është e një rëndësie të veçantë, për shkak se janë rreth 22.000 lëndë të pa kryera. Rexha ka shtuar se për funksionalizimin e këtyre kolegjeve, nuk ka kurrfarë pengese ligjore.

Pas kësaj, anëtarja e KGJK-së, njëherit edhe gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ka pyetur nëse KGJK ka mandat për të marrë këtë vendim, nëse nuk miratohet ligji.

“Pa dashtë me kundërshtu askënd, po më intereson se a kemi ne mundësi me marrë këtë vendim pa hy ligji në fuqi, kështu “krye në veti”, ka thënë Karaqi.

Karaqi i është përgjigjur anëtarja Makifete Saliuka, duke thënë se çfarë është e logjikshme është edhe e ligjshme, dhe se nuk ka asnjë pengesë ligjore për tu formuar kolegjet. Funksionalizimin e kolegjeve gjyquese në Dhomës e Posaçme të Gjykatës Supreme e ka kundërshtuar edhe anëtari tjetër i KGJK-së, Cerim Fazliji, i cili është po ashtu gjyqtarë i Dhomës së Posaçme. Por, i menjëhershëm ka qenë reagimi i anëtarit Muhamet Rexha:

“Ne jemi msu me prit. Por ju nuk jeni fajtorë. Fajtorë jemi ne si KGJK, pasi ju nuk kishit guxu me nejt deri tash pa punu, duke pasur parasysh se keni 22.000 lëndë pa kryer. KGJK nuk formon kolegje kolegë i nderuar, por ligji është ai që i bënë këto. Ne vetëm do ti sygjeronim kryetarit tuaj me vepru. Por me gjasë ju paskit qef me vazhdu hala qishtu. Vazhdoni pra. Ajo është tjetër punë. Po keni qef me nejt hala, vazhdoni. Veç sikur tisha pyet unë personalisht, ju sot ishit shku në shpi” ka thënë Rexha.

⁷⁷ “Gjykata Themelore në Gjilan mbetet vetëm me zëvendës ushtrues të detyrës së Kryetarit”. Betimi për Drejtësi. 25 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-themelore-ne-gjilan-mbetet-vetem-me-zevendes-ushtrues-te-detyres-se-kryetarit/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

“Po qysh jo. Po pse spo merrni vesh, 13 gjyqtar janë krejt” ishte përgjigja e shkurtë e anëtares Karaqi.

Mospajtimin të anëtarit Cerim Fazliji se nuk pajtohet me këtë qëndrim, Rexha u përgjigj me fjalët “munësh mos mu pajtu o zotni, amo drejt nuk hi hiq. Vazhdoni ju po sjeni kerkah hiq”.

Pas tensioneve të ngritura, Kryesuesi Nehat Idrizi pyeti partnerët ndërkombëtarë që ishin në takim, nëse të njëjtit kanë ndonjë këshilli rreth kësaj çështje. John Ferry nga USAID ka thënë se kjo është një çështje e thjeshtë administrative.

Polemika mes Rexhës dhe Karaqit vazhdoi edhe gjatë votimit të kësaj pike. “Qaq shumë na shajtët sa ma gërrditët edhe votimin. As kundër as abstenim” ishte shprehja e anëtares Manushe Karaqi, e cila gjatë votimit nuk ngriti fare doren, madje as për të abstenuar.

Ndërsa Muhamet Rexha i tha Karaqit që të ketë kujdes se çfarë po flet, pasi nuk i kishte sharë askush.

Përfundimisht, KGJK me 6 vota pro dhe 4 kundër vendosi që ta miratojë kërkesën e kryetarit të Gjykatës Supreme, Enver Peci, që të formojë kolegjet gjykuese në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme si dhe të kërkojë nga kryetari i kësaj dhome që të formojë kolegjin për ankesa.

Sidoqoftë, IKD e vlerëson tejte shqetësuese faktin se pas përfundimit të mandatit të EULEX-it, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka qenë pasive. Kjo për faktin se në formimin e kolegjeve gjykuese, siç është vërtetuar se nuk ka problem tash, të njëjtat ligje kanë qenë edhe në qershor të vitit 2018. Një neglizhencë e tillë ka dërguar deri në paralizim të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, shkelje të afateve ligjore dhe veçanërisht, shkelje të të drejtave të qytetarëve.

7.3.8. Sfidat e KGJK-së me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë

KGJK më 31 tetor 2017, kishte zgjedhur Nikolla Kabashiq për Kryetar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Zgjidhja e Kabashiq në krye të Gjykatës Themelore në Mitrovicë ishte një hap tjetër drejt zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit për Drejtësi, e arritur më 10 shkurt 2017. Në nenin 13 të kësaj marrëveshje përcaktohet se kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës do të jetë nga komuniteti serb nga Mitrovica⁷⁸.

Por, ende pa u bërë 3 muaj, KGJK ishte ballafaqur me dorëheqjen e Kryetarit Kabashiq. Në letër dorëheqjen e tij të 14 shkurtit 2018, Kabashiq kishte përmendur se këtë e bënte vetëm për arsye personale.

Dy ditë më vonë, KGJK kishte njoftuar me anë të një komunikate për media se nuk e kishte pranuar dorëheqjen e Kryetarit Kabashiq.

⁷⁸ “Nikolla Kabashiq zgjidhet kryetar i Gjykatës Themelore të Mitrovicës”. Betimi për Drejtësi. 31 tetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nikolla-kabashiq-zgjidhet-kryetar-i-gjykates-themelore-te-mitrovices/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

“Kryesuesi dhe KGJK, që nga data 14 shkurt 2018 kanë mbajtur kontakte të vazhdueshme me kryetarin Kabašić, gjyqtarët dhe stafin mbështetës të Gjykatës Themelore të Mitrovicës me qëllim të gjetjes së një zgjidhje sa më të përshtatshme dhe që është në interes për funksionimin e Gjykatës në Mitrovicë. Po të njëjtën ditë dhe në vazhdimësi, KGJK ka pranuar me shkrim dhe në forma tjera kërkesa nga gjyqtarët, stafi mbështetës dhe partnerët e sistemit gjyqësor që theksojnë, se kërkesa për dorëheqje e kryetarit Kabašić, duhet të trajtohet me kujdes dhe e njëjta të mos pranohet si e tillë”, thuhej në njoftimin e KGJK-së⁷⁹.

Por, KGJK-së u ballafaqua përsëri me Kryetarin Nikolla Kabashiq. Në nënton 2018, Kabashiq dërgoj një letër përfaqësuesve institucional dhe ndërkombëtar, e cila përmbante mesazhe dhe kërkesa politike, duke i’ a shtuar këtu edhe vizitën që bëri Kabashiq tek Presidenti i Republikës së Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Me anë të një reagimi, IKD ka kërkuar nga KGJK që të ndërmerr veprimet ligjore në raport me Kryetarin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës. IKD ka shprehur shqetësim në lidhje me veprimet e bartësve të funksioneve gjyqësore në Gjykatën Themelore të Mitrovicës në Republikën e Kosovës. IKD vlerëson se Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ka ndërmarr veprime që bien në kundërshtim me parimet dhe vlerat që i promovon Kushtetuta dhe ligjet pozitive të Republikës së Kosovës.

“Ndër të tjera, letra e Kryetarit të Gjykatës dërguar përfaqësuesve institucional dhe ndërkombëtar, përmban mesazhe dhe kërkesa politike, të cilat shkelin rëndë pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit në Republikën e Kosovës. Fatkeqësisht, këto veprime së bashku edhe me vizitën e Kryetarit të Gjykatës tek Presidenti i një shteti tjetër, kanë prodhuar pasoja, të cilat mund të rikuperohen vetëm përmes ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësiive nga ana e KGJK-së, përfshirë ndërmarrjen e të gjitha masave ligjore në këtë rast” thuhet në reagimin e IKD-së.

Në këtë drejtim, IKD ka kërkuar nga KGJK që të ushtrojë kompetencat dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore në mënyrë që të ruhet pavarësia e gjyqësorit në Republikën e Kosovës⁸⁰.

Në takimin e mbajtur më 30 nëntor 2018, KGJK i ka dërguar letër Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Nikolla Kabashiq, Gjyqtarëve të kësaj Gjykate dhe stafit administrativ të Gjykatës që të largohen nga sjelljet që mund të rezultojnë me shkelje të Kodit të Etikës⁸¹.

⁷⁹ “KGJK-ja nuk e pranon dorëheqjen e kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë”. Betimi për Drejtësi. 16 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kgjk-ja-nuk-e-pranon-doreheqjen-e-kryetarit-te-gjykatës-themelore-ne-mitrovicë/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁸⁰ “IKD kërkon nga KGJK ndërmarrjen e veprimeve ligjore për Kryetarin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës”. IKD. 30 nëntor 2018. (Shih linkun <https://kli-ks.org/ikd-kerkon-nga-kgjk-ndermarrjen-e-veprimeve-ligjore-per-kryetar-in-e-gjykatës-themelore-te-mitrovicës/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁸¹ “KGJK kërkon nga kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë që të mos ndikohet nga veprimet politike”. Betimi për Drejtësi. 30 nëntor 2018. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kgjk-kerkon-nga-kryetari-i->

7.3.9. KGJK voton pro raportit inekzistent të Gjykatës Themelore në Mitrovicë

Në takimin e KGJK-së të mbajtur me 20 korrik 2018, si pikë e rendit të ditës kishte qenë edhe raportimi i kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë për tremujorin e parë të vitit 2018. Në vend të kryetarit Nikolla Kabashiq, në KGJK ishte paraqitur nënkryetari i kësaj Gjykate, Ali Kutllovci. Kutllovci kishte thënë se kishte marrë disa të dhëna, por se Gjykata ku ai është nënkryetar, nuk ka përpiluar raportin për tremujorin e parë të vitit 2018, për çfarë edhe ishte ftuar nga KGJK që të raportojë.

“Kryetari i gjykatës dhe unë nuk e kemi ditur se do të raportojmë. Nuk e kemi ditur për afatin e përpilimit të raportit. Unë u thashë disa punëtorëve të mi nxjerrin disa të dhëna dhe erdha këtu të paraqes raportin, pasi kryetari Nikolla Kabashiq është në pushim. Mirëpo po e dini gjendjen në gjykatën tonë” ka deklaruar Kutllovci.

Përkundër kësaj, ai ka përmendur në përgjithësi sfidat me të cilat ballafaqohet Gjykata nga ai vjen. Por, ndonëse në KGJK nuk kishte sjellë raportin e përpiluar, KGJK kishte nxjerrë vendim me anë të së cilit e kishte miratuar këtë “raport”.

“1: Miratohet Raporti i Punës së tremujorit të I-rë të Gjykatës Themelore Mitrovicë për vitin 2018. 2: Autorizohet Sekretariati i KGJK-së që të publikoj raportin në Eëb faqe te KGJK-së. 3: Vendimi hyn në fuqi me datë 20 korrik 2018”, thuhet në vendimin KGJK.nr. 157/2018 të KGJK-së⁸².

gjykates-themelore-ne-mitrovice-qe-te-mos-ndikohet-nga-veprimet-politike/) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

⁸² “KGJK, Nr. 157/2018”. KGJK. 20 korrik 2018. (Shih linkun <http://gjyqesori-rks.org/GetDocument/11438>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

8. Rekomandime

Rekomandim për Ministrin e Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë duhet që bashkëpunimin me KGJK dhe KPK ta zhvillojë deri në atë fushë sa kompetencat e tij kërkojnë bashkëpunim me këta dy këshilla. Ministri i Drejtësisë, pavarësisht qëllimeve që mund të ketë, duhet ta kuptojë që KGJK dhe KPK janë institucione të pavarura dhe të ndjeshme sidomos në raport me pushtetin ekzekutiv, prandaj si të tilla duhet t'i trajtojë dhe respektojë në mënyrë që mos të krijohen situata kur paraqitjet e përbashkëta në publik krijojnë opinion se politika po ndërhyt në pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Rekomandim për KGJK dhe KPK:

1. KGJK dhe KPK, veçanërisht kryesuesit e tyre, duhet t'i shmangen takimeve pa shkas me Ministrin e Drejtësisë dhe secilin zyrtarë të lartë të pushteteve tjera, në mënyrë që ta ruajnë kredibilitetin dhe pavarësinë e tyre, si dhe të mos zbehin edhe më tutje besimin e publikut në këto dy institucione.
2. KGJK dhe KPK të ndalin akuzat dhe kundërakuzat për dështimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në luftën kundër korrupsionit, por të kryejnë obligimet e tyre kushtetuese dhe ligjore në kuptim të kontrollit dhe mbikqyrjes së gjykatave dhe prokurorive përmes mekanizmave të brendshëm.
3. KGJK dhe KPK, të ndërmarrin masa të evitimit të konfliktit të interesit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Rekomandimet për KGJK:

1. KGJK të tregojë efikasitet të shtuar në përmbushjen e obligimeve ligjore, sidomos miratimin e legjislacionit sekondar. Po ashtu, IKD rekomandon që pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për KGJK-në dhe Ligjit të ri për Gjykatat, KGJK të miratojë plan të veprimit dhe të përcaktojë afate për miratimin e legjislacionit sekondar. .
2. IKD i rekomandon KGJK-së që me një përkushtim maksimal të adresojë rekomandimet e dala nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit.
3. IKD i rekomandon KGJK-së që me rastin e nxjerrjes së akteve nënligjore, është e mjaftueshme që t'i referohet vetëm bazës ligjore dhe vetëm në ato raste kur me ligj i është bartur një autoritet i tillë dhe jo të referohet në dispozita Kushtetuese nëse për një gjë të tillë nuk ka bazë ligjore.
4. KGJK ta rishqyrtojë Rregulloren për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës në kuptimin e përputhjes së tij me KPRK dhe fushës për qasje në statistikat e Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Republikës së Kosovës.
5. KGJK të publikojë Rregulloren për Shfrytëzimin e Teknologjisë Informative në Sistemin Gjyqësor.
6. KGJK të publikojë të gjitha vendimet e nxjerra nga KGJK. Po ashtu, KGJK duhet ta respektojë dy gjuhësinë, dhe të gjitha vendimet të publikohen edhe në Gjuhën Serbe.
7. KGJK të rrisë transparencën në përgjithësi, përkatësisht të respektojë Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, të ftojë mediat dhe shoqërinë civile në çdo takim publik. IKD i

rekomandon KGJK-së që gjatë miratimit të raportit të punës së gjykatave dhe raportit të punës së KGJK-së për vitin 2018, të marrë për bazë çështjet si në vijim:

- a. Cilat ishin sfidat e sistemit gjatë vitit raportues dhe si u trajtuan nga ana e Këshillit?
 - b. Të bëjë një analizë të gjera përkitazi me faktorët dhe indikatorët që patën ndikim (Pozitiv/Negativ) në punën e KGJK-së gjatë vitit 2018.
 - c. Cilat ishin kufizimet (psh. buxhetore) dhe çfarë ndikimi patën në punën e këshillit?
 - d. Si u tejkaluan pengesat dhe çfarë synohet që në të ardhmen të mos përsëriten?
 - e. Si u tejkaluan pengesat dhe çfarë synohet që në të ardhmen të mos përsëriten?
8. KGJK, përkatësisht Komisioni për Vlerësimin e Performancës së KGJK-së, t'i kushtoj rëndësi të veçantë procesit të vlerësimit të performancës, në atë mënyrë që me anë të këtij procesi të arrihet qëllimi i tij, dhe jo që ky proces të kryhet vetëm formalisht.
 9. Pas miratimit të Ligjit të ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, KGJK të kujdeset që të gjitha masat disiplinore që kërkon me ligj të bëhen publike.
 10. IKD i rekomandon KGJK-së që të përmbush obligimin ligjor dhe të ftoj Kryetarët e Gjykatave për të raportuar para KGJK-së lidhur me administrimin dhe menaxhimin e gjykatave respektive.
 11. KGJK ta bëjë të qartë dallimin në mes transferimit dhe avancimit, dhe mos të avancojë gjyqtarë të ndryshëm në emër të transferimit.
 12. IKD i rekomandon KGJK-së që në afatin e përcaktuar ligjor të themelojë degët e reja që parashihen me Ligjin e ri për Gjykatat, dhe jo të ndjek praktikën e deritanishme ku tanimë është shfuqizuar Ligji për Gjykatat, por që asnjëherë nuk janë themeluar degët e reja të gjykatave në Fushë Kosovë dhe Obiliq.
 13. IKD i rekomandon anëtarëve të KGJK-së që të luajnë rol aktiv në takime të Këshillit gjatë procesit të politik bërjes dhe vendim marrjes në Këshill.

Rekomandime për KPK:

1. IKD i rekomandon KPK-së që të tregojë efikasitet të shtuar në përmbushjen e obligimeve ligjore, përfshirë edhe miratimin e legjislacionit sekondar.
2. IKD i rekomandon KPK-së dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që raportin vjetor të Prokurorit të Shtetit ta shqyrtojë dhe miratojë brenda afatit ligjor.
3. IKD i rekomandon KPK-së që me një përkushtim maksimal të adresoj rekomandimet e dala nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit.
4. IKD i rekomandon KPK-së zbatimin në praktikë të Rregullores për Komunikim Publik dhe të mbajë përgjegjës të gjithë zyrtarët që nuk e zbatojnë.
5. KPK të publikojë të gjitha aktet nënligjore të KPK-së, duke respektuar edhe dygjuhësinë.
6. IKD i rekomandon KPK-së që me rastin e hartimit të raportit vjetor të KPK-së për vitin 2018, mos ta bëjë një raport ekskluzivisht përrshkrues, por ai të jetë një raport analitik i cili i adreson problemet dhe sfidat që ka pasur KPK gjatë vitit 2018.
7. KPK, përkatësisht Komisioni për Vlerësimin e Performancës në KPK, që këtë proces ta kryej me një kujdes, profesionalizëm dhe përkushtim maksimal, në mënyrë që ky rproces ta arrijë qëllimin e tij, dhe jo që ky proces të përfundohet vetëm formalisht.

8. IKD i rekomandon KPK-së të raportoj para publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikator të matshëm çdo gjashtë (6) muaj.
9. IKD i rekomandon KPK-së të thëras Kryeprokurorët e të gjitha prokurorive për të raportuar lidhur me menaxhimin dhe administrimin e prokurorive përkatëse.
10. IKD i rekomandon anëtarëve të KPK-së që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre të kenë rol aktiv, përmes pjesëmarrjes në diskutim dhe debat gjatë procesit të politikbërjes dhe vendimmarrjes në KPK.
11. KPK ta bëjë të qartë dallimin në mes të avancimit dhe transferimit, dhe mos të bëjë avancime të kundërligjshme në emër të transferimit.